www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 111

Tiranë – E enjte, 26 qershor 2025

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 26/2025, datë 5.6.2025	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 3, datë 29.4.2025, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2024 'Për buxhetin e vitit 2025'"	15203
Dekret i Presidentit nr. 201, datë 24.6.2025	Për shpallje ligji	15203
Ligj nr. 34/2025, datë 5.6.2025	Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për programin operacional shumëvjeçar për punësimin e të rinjve, në favor të Republikës së Shqipërisë, për periudhën 2024–2027, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA III)	15203
Dekret i Presidentit nr. 186, datë 19.6.2025	Për shpallje ligji	15451
Dekret i Presidentit nr. 192, datë 23.6.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	15451
Dekret i Presidentit nr. 193, datë 23.6.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	15451
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 351, datë 25.6.2025	Për miratimin e tarifës së regjistrimit të organeve të vlerësimit të konformitetit për sigurinë kibernetike	15451
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 352, datë 25.6.2025	Për caktimin e anëtarit të ekipit përzgjedhës për zgjedhjen e kandidatëve, anëtarë të Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura	15452

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 353, datë 25.6.2025	Për miratimin e rregullave për sigurimin e ndërveprueshmërisë së pajisjeve radio të automjeteve dhe marrësve digjitalë të konsumatorit	15452
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 354, datë 25.6.2025	Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në fshatin Taç Lartë, Bashkia Kolonjë, qarku Korçë, nga shoqëria "*Fortis Energy and Construction*" sh.p.k.....	15454
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 355, datë 25.6.2025	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksioni i rrugës 'Engjëll Agalliu', në lagjen '18 Tetori', Bashkia Dimal".....	15456
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 356, datë 25.6.2025	Për një shtesë në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit", të ndryshuar.....	15459
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 357, datë 25.6.2025	Për miratimin e listës së ish-ndërmarrjeve bujqësore, sipas vitit të krijimit të tyre dhe territorit të ushtrimit të aktivitetit.....	15459
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 266, datë 20.6.2025	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 20, datë 1.9.2023, "Për përcaktimin e mënyrës dhe procedurës së punësimit me prioritet të mjekëve që përfitojnë trajtim të veçantë në institucionet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë".....	15462
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 608, datë 19.6.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe dhive të shfaqur në shtetin e Turqisë.....	15462
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 609, datë 19.6.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe dhive të shfaqur në shtetin e Rumanisë.....	15463
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 611, datë 20.6.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së aftës epizootike të shfaqur në shtetin e Turqisë.....	15463
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 8847, datë 23.6.2025	Për hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje ndërkombëtare.....	15464
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 107/20, datë 26.6.2025	Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Restaurimi dhe rikualifikimi urban i zonës perspektive TID, me vendndodhje në parkun arkeologjik Durrës, me zhvillues Bashkia Durrës".....	15464

LIGJ
Nr. 26/2025

PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 3, DATË 29.4.2025, "PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 115/2024 'PËR BUXHETIN E VITIT 2025'"

Në mbështetje të neneve 78, 101 dhe 160 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 3, datë 29.4.2025, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2024 'Për buxhetin e vitit 2025'".

Miratuar në datën 5.6.2025.

Shpallur me dekretin 201, datë 24.6.2025, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 201, datë 24.6.2025

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 26/2025, "Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 3, datë 29.4.2025, 'Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2024, 'Për buxhetin e vitit 2025'"".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ
Nr. 34/2025

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, DHE KOMISIONIT EVROPIAN PËR PROGRAMIN OPERACIONAL SHUMËVJEÇAR PËR PUNËSIMIN E TË RINJVE, NË FAVOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËR PERIUDHËN 2024–2027, NË KUADËR TË INSTRUMENTIT TË ASISTENCËS SË PARAANËTARËSIMIT (IPA III)

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për programin operacional shumëvjeçar për punësimin e të rinjve, në favor të Republikës së Shqipërisë, për periudhën 2024–2027, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA III), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 5.6.2025.

Shpallur me dekretin nr. 186, datë 19.6.2025, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj

MARRËVESHJE FINANCIMI
KUSHTE TË VEÇANTA

Komisioni Evropian, në vijim i referuar si "Komisioni"), duke vepruar në emër të Bashkimit Evropian, në vijim i referuar si "Bashkimi",

nga njëra anë, dhe
Republika e Shqipërisë, në vijim e referuar si "Përfitues i IPA III", e përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave,
nga ana tjetër,
kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Programi

1. Bashkimi pranon të financojë dhe përfituesi i IPA III bie dakord të pranojë financimin e Programit të mëposhtëm:
Programi Operacional Shumëvjeçar për Punësimin e të Rinjve në favor të Republikës së Shqipërisë për periudhën 2024-2027 që përfshin projektin e mëposhtëm:
Programi Operacional Shumëvjeçar për Punësimin e të Rinjve në favor të Republikës së Shqipërisë për periudhën 2024-2027
Numri global i angazhimit: JAD.1421652
Ky Program financohet nga buxheti i Bashkimit sipas aktit bazë të mëposhtëm: Instrumenti i Ndihmës para Aderimit (IPA III).[1]
2. Kostoja totale e llogaritur e këtij Programi është 63 480 000 Euro dhe kontributi maksimal i Bashkimit për këtë Program është vendosur në shumën 50 000 000 Euro.
Kontributi i Bashkimit do të ndahet në angazhime vjetore për periudhën 2024 – 2027 në përputhje me Aneksin I. Asnjë parashikim i kësaj Marrëveshjeje Financimi nuk mund të interpretohet se nënkupton një angazhim financiar të Bashkimit në lidhje me kreditë që nuk janë miratuar ende me miratimin e buxhetin të BE-së. Komisioni do të informojë me shkrim përfituesin e IPA III për miratimin e angazhimeve financiare të mëvonshme të specifikuara në Aneksin I.
Ky Program kërkon kontribut financiar si nga përfituesi i IPA III, edhe nga Bashkimi. Ndarja e kontributeve financiare përkatëse është paraqitur në Aneksin I.
3. Programi do të zbatohet në përputhje me programin operacional shumëvjeçar të specifikuar në Aneksin I.

Neni 2
Periudha e ekzekutimit, periudha e pranueshmërisë dhe çlirimi i angazhimit

1. Periudha e ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje Financiare do të fillojë me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financiare dhe do të përfundojë 12 vjet pas kësaj date.
2. Periudha e pranueshmërisë, siç përcaktohet në nenin 12(1) të Aneksit II (Kushtet e Përgjithshme) do të fillojë në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi dhe do të përfundojë më 31 dhjetor 2033.
3. Komisioni do të çlirojë automatikisht çdo pjesë të një angazhimi buxhetor për programin e treguar në Aneksin I e cila, deri më 31 dhjetor të vitit të pestë pas atij të angazhimit buxhetor, nuk është përdorur për qëllime të para-financimit ose kryerjes së pagesave të ndërmjetme, ose për të cilën nuk është paraqitur asnjë pasqyrë shpenzimi e vërtetuar ose ndonjë kërkesë për pagesë.
4. Pa cenuar afatin automatik të çlirimit nga angazhimi i përmendur në paragrafin 3, Komisioni do të informojë përfituesin e IPA III 9 muaj përpara afatit automatik të çlirimit nga angazhimi për rrezikun e çlirimit nga angazhimi.

[1] Rregullorja (BE) 2021/1529 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 shtator 2021 për krijimin e Instrumentit të Ndihmës Para-Aderimit (IPA III), OJ L 330, 20.9.2021, f. 1.

5. Shuma e prekur nga çlirimi nga angazhimi do të reduktohet me shumat ekuivalente për atë pjesë të angazhimit buxhetor për të cilën:

a) operacionet janë pezulluar me një proces ligjor ose me një ankim administrativ me efekt pezullues; ose

b) nuk ka qenë e mundur të bëhet një kërkesë pagese për arsye të forcës madhore që ndikon ndjeshëm në zbatimin e të gjithë ose të një pjese të programit.

Përfituesi i IPA III që pretendon forcën madhore, duhet të tregojë pasojat e drejtpërdrejta të forcës madhore mbi zbatimin e të gjithë ose një pjese të programit.

Neni 3
Adresat dhe komunikimi

Të gjitha komunikimet në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financiare do të bëhen me shkrim, do t'i referohen shprehimisht Programit siç është identifikuar në nenin 1(1) dhe do të dërgohen në adresat e mëposhtme:

a) për Komisionin
Valentina Superti
Drejtore D, Ballkani Perëndimor
Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit (DG NEAR)
Komisioni Evropian
Rue de la Loi 15
B-1049 Brussels, Belgium
E-mail: NEAR-D@ec.europa.eu

b) për Përfituesin e IPA III
Eridana Çano
Koordinatore Kombëtare për IPA-n
Drejtore e Përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës
Rruga "Kuvajt"
Tiranë, Shqipëri
E-mail: eridana.cano@saspac.gov.al

Neni 4
Pika e Kontaktit në OLAF

Pika e kontaktit e përfituesit të IPA III që ka kompetencat e duhura për të bashkëpunuar drejtpërdrejt me Zyrën Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF) për të lehtësuar aktivitetet operacionale të OLAF-it, është:

Blerina Naska
Drejtore e Njësisë së Inspektimit Financiar pranë Drejtorisë së Inspektimit të Financave Publike në Ministrinë e Financave
Ministria e Financave
Bulevardi Dëshmorët e Kombit Nr.3
Tiranë, Shqipëri
E-mail: blerina.naska@financa.gov.al

Neni 5
Marrëveshje kuadër e partneritetit financiar

Programi do të zbatohet në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes Kuadër të Partneritetit Financiar (FFPA) ndërmjet Komisionit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë mbi rregullimet për realizimin e ndihmës financiare të Bashkimit për Republikën e Shqipërisë sipas Instrumentit të Ndihmës Para-Aderimit (IPA III) i cili hyri në fuqi më 14 tetor 2022 (në vijim i referuar si "FFPA"). Kjo Marrëveshje

Financimi plotëson dispozitat e FFPA-së. Në rast konflikti ndërmjet dispozitave të kësaj Marrëveshjeje Financimi dhe dispozitave të FFPA, kjo e fundit do të ketë përparësi.

Neni 6
Anekset

1. Kjo Marrëveshje Financimi përbëhet nga:
a) këto Kushte të Veçanta
b) Aneksi I: Programi Operacional Shumëvjeçar
c) Aneksi II: Kushte të Përgjithshme
d) Aneksi III: Model Raporti Vjetor për zbatimin e ndihmës IPA III sipas nenit 59 të FFPA-së
e) Aneksi IV: Model Raporti Financiar sipas nenit 61(2)(a) dhe 61(3) të FFPA-së, duke përfshirë modelin e parashikimeve për kërkesat e mundshme të pagesave sipas nenit 33(3) të FFPA-së
f) Aneksi V: Specifikimet Minimale të Sistemit të Kontabilitetit me Bazë Rritëse
g) Aneksi VI: Model Aplikimi për Projekte Madhore
2. Aneksi VII: Model për Dokumentet e Identifikimit të Veprimeve
3. Në rast konflikti ndërmjet dispozitave të Anekseve dhe dispozitave të këtyre Kushteve të Veçanta, këto të fundit do të kenë përparësi. Në rast konflikti ndërmjet dispozitave të Aneksit I dhe dispozitave të Aneksit II, këto të fundit do të kenë përparësi.

Neni 7
Dispozita që shmangin ose plotësojnë Aneksin II

Sa më poshtë plotësojnë Aneksin II:
1. Pas vlerësimit pozitiv të misionit verifikues për dhënien e detyrave të zbatimit të buxhetit, të kryer nga DG NEAR në qershor 2024, një mision pasues do të kryhet nga DG NEAR në vitin 2025 për të verifikuar që linjat e komunikimit ndërmjet Zyrtarit Kombëtar Autorizues (NAO), Zyrës Mbështetëse të Zyrtarit Kombëtar Autorizues (NAOSO) dhe Organit Kontabël (AB) të mbeten të formalizuara dhe të drejtpërdrejta siç kërkohet nga IPA III FFPA. Kjo do të jetë një shtesë për gjetjet e raportit përfundimtar të auditit, të cilat kërkojnë një ndjekje në përputhje me afatet kohore të përcaktuara për çdo gjetje.
2. Komisioni ka prezantuar një sistem shkëmbimi elektronik për raportimin e kontratave nën menaxhim indirekt nga përfituesi IPA III ("IPA-APP"). Përfituesit të IPA III i kërkohet të regjistrohet dhe të përdorë IPA-APP për të lejuar menaxhimin elektronik të Marrëveshjeve të Financimit.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje Financimi hyn në fuqi në datën kur Komisioni merr njoftim nga përfituesi i IPA III që konfirmon përfundimin e procedurave të brendshme të përfituesit të IPA III, të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi. Komisioni do të informojë përfituesin e IPA III për datën e marrjes së këtij njoftimi.
Kjo Marrëveshje Financimi është hartuar në dy kopje në gjuhën angleze, njëra i dorëzohet Komisionit dhe tjetra përfituesit të IPA III.

Për Përfituesin e IPA III:
Eridana Çano
Koordinatore Kombëtare për IPA-n dhe Drejtore e Përgjithshme
Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës
Tiranë,

Data:
Nënshkrimi:

Për Komisionin

Valentina Superti
Drejtore D, Ballkani Perëndimor
Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat për Zgjerimin
Komisioni Evropian
Bruksel

Data:
Nënshkrimi:

EN
KY PROJEKT FINANCOHET NGA BASHKIMI EVROPIAN
ANEKS

i Vendimit Zbatues të Komisionit për financimin e Programit Operacional shumëvjeçar të BE-së për Punësimin e të Rinjve në favor të Republikës së Shqipërisë për periudhën 2024-2027

PROGRAMI OPERACIONAL SHUMËVJEÇAR

Ky dokument përbën programin shumëvjeçar të punës në kuptim të nenit 110(2) të Rregullores Financiare dhe planin shumëvjeçar të veprimit në kuptim të nenit 9 të Rregullores IPA III dhe nenit 23 të NDICI-t-Rregullorja e Evropës Globale.

1 Programi i përmbledhur
1.1 Tabela Përmbledhëse e Programit
1.2 Përmbledhja e Programit
2 Analiza e sektorit
2.1 Konteksti dhe politikat sektoriale kombëtare
2.2 Kuadri ligjor
2.3 Mjedisi institucional, drejtimi dhe kapaciteti
2.4 Sektori (sektorët) dhe koordinimi i donatorëve
2.5 Perspektivat buxhetore afatmesme
2.6 Kuadri i vlerësimit të performancës
2.7 Analiza socio-ekonomike (përfshirë analizën SWOT)
3 Objektivi i Përgjithshëm dhe Objektivat Specifike të Programit Operacional
3.1 Koherenca me Kuadrin e Programimit IPA III dhe me instrumentet specifike të politikave të procesit të zgjerimit
4 Karakteristikat operacionale të programit
4.1 Ndërveprimi i programit me planet vjetore të veprimit të IPA III ose masat dhe ndërhyrjet nga donatorë të tjerë/Institucione Financiare Ndërkombëtare
4.2 Përshkrimi i programit
4.2.1 Logjika e ndërhyrjes
4.2.2 Përshkrimi i detajuar i çdo fushe të mbështetjes
4.2.3 Lista indikative e projekteve madhore për çdo fushë të mbështetjes
4.3 Konsiderata të vlerësuara
4.3.1 Mbrojtja e Mjedisit, Ndryshimet Klimatike dhe Biodiversiteti
4.3.2 Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave dhe vajzave
4.3.3 Të drejtat e njeriut
4.3.4 Aftësia e kufizuar
4.3.5 Demokracia
4.3.6 Sensitiviteti ndaj konfliktit, paqja dhe aftësia për t'u përshtatur
4.3.7 Reduktimi i Riskut nga Katastrofat
4.4 Risqe dhe supozime
5 Pasqyra e procesit të konsultimit për përgatitjen e Programit Operacional
6 Rregullimet e zbatimit
6.1 Marrëveshja e Financimit
6.2 Metodat e zbatimit
6.3 Objekti i pranueshmërise gjeografike për prokurime dhe grante

7 Tabelat financiare sipas fushave të mbështetjes dhe sipas vitit (përfshirë normat e bashkëfinancimit, nëse ka)
8 Matja e performancës
8.1 Monitorimi dhe raportimi
8.2 Vlerësimi
8.3 Auditimi dhe verifikimet
9 Komunikimi strategjik dhe diplomacia publike
10 Qëndrueshmëria
Aneksi 1: Lista e partnerëve të konsultuar
Aneksi 2: Lista e akronimeve
1 Programi i përmbledhur
1.1 Tabela Përmbledhëse e Programit

Titulli	**Programi Operacional Shumëvjeçar për BE-në për Punësimin e të Rinjve në favor të Republikës së Shqipërisë për 2024-2027**			
OPSYS	ACT- 62470 2024-2027: JAD.1421652			
ABAC	Niveli 1 i angazhimit numër: JAD.1421652			
Akti bazë	Financuar sipas Instrumentit të Ndihmës para Aderimit (IPA III)			
Team Evrope	Jo			
Përfituesit e IPA III	Republika e Shqipërisë			
Dokumenti i programit	Kuadri i Programimit IPA III			
INFORMACION PËR FUSHAT PRIORITARE DHE SEKTORËT				
Dritare dhe përparësi tematike	Dritare 4: Konkurrueshmëria dhe rritja përfshirëse Përparësia tematike: 1: Edukimi, punësimi, politikat e mbrojtjes sociale dhe përfshirjes dhe shëndeti (100%)			
Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ)	OZHQ kryesor: OZHQ 8 Puna e Denjë dhe Rritja Ekonomike OZHQ të tjera: OZHQ 1: Pa varfëri OZHQ 5: Barazia gjinore OZHQ 8: Arsimi cilësor OZHQ 10: Zvogëlimi i pabarazive OZHQ 14: Veprimi për klimën			
Kodi (kodet) DAC	Kodet kryesore DAC: 16020 - Krijimi i punësimit (48%) Nën-kodi 1: 11330 -Formim profesional (40%) Nën-kodi 2: 11110 – Politika e arsimit dhe menaxhimit administrativ (12%)			
Rruga kryesore e ofrimit	Qeverisja qendrore - 12000			
Synimet	**X Klima** **X Gjinia** ☐ Biodiversiteti			
Markuesit (nga formulari DAC)	**Objekti i përgjithshëm i politikave**	**Nuk synohet**	**Objektivi domethënës**	**Objektivi parësor**
	Pjesëmarrje në zhvillim/qeverisja e mirë	☐	X	☐
	Ndihma për mjedisin	X	☐	☐
	Barazia gjinore, fuqizimi i grave dhe vajzave	☐	X	☐
	Shëndeti riprodhues, i nënës, të porsalindurit dhe fëmijës	X	☐	☐
	Reduktimi i Riskut nga Katastrofat	X	☐	☐
	Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara	☐	X	☐
	Ushqyerja	X	☐	☐
	Markuesit e Konventës RIO	**Nuk synohet**	**Objektivi domethënës**	**Objektivi parësor**
	Diversiteti biologjik	X	☐	☐
	Lufta kundër shkretëtirëzimit	X	☐	☐
	Zbutja e ndryshimit të klimës	X	☐	☐
	Përshtatja me ndryshimin e klimës	☐	X	☐

Markuesit e brendshëm dhe etiketimet	**Objektivat e politikave**	**Nuk synohet**	**Objektivi domethënës**	**Objektivi parësor**
	Dixhitalizimi	☐	X	☐
	Etiketimet Konektiviteti Dixhital Qeverisja Dixhitale Sipërmarrja Dixhitale Aftësitë/Njohuritë Dixhitale Shërbimet Dixhitale	PO ☐ ☐ X X X		JO ☐ ☐ ☐ ☐ ☐
	Konjektiviteti	X	☐	☐
	Etiketimet Konektiviteti Dixhital Energjia Transporti Shëndeti Arsimi dhe kërkimi	PO ☐ ☐ ☐ ☐ ☐		JO X X X X X
	Migracioni	☐	X	☐
	Ulja e pabarazive	☐	X	☐
	COVID-19	X	☐	☐
INFORMACION PËR BUXHETIN				
Shumat e përfshira	Linja e buxhetit: 15 02 02 01 Kostoja totale e llogaritur për 2024-2027: 63 480 000 Euro Shuma totale e kontributit të buxhetit të BE-së për 2024-2027: 50 000 000 Euro Kontributi nga buxheti i përgjithshëm i Bashkimit Evropian ndahet sipas viteve si më poshtë: - Për 2024 - 2 500 000 Euro - Për 2025 - 16 500 000 Euro - Për 2026 - 14 000 000 Euro - Për 2027 - 17 000 000 Euro Kontributi nga buxheti i përgjithshëm i Bashkimit Evropian për vitet në vijim i nënshtrohet disponueshmërisë së fondeve për vitet përkatëse financiare pas miratimit të buxhetit vjetor përkatës, ose siç parashikohet në sistemin e të dymbëdhjetëve të përkohshëm.			
MENAXHIMI DHE ZBATIMI				
Modalitetet e zbatimit (mënyra e menaxhimit dhe metodat e zbatimit)	Menaxhimi indirekt me Republikën e Shqipërisë			
Prioritetet përkatëse dhe arritjet kryesore nga Plani Ekonomik dhe i Investimit për Ballkanin Perëndimor	Prioritetet: Zhvillimi i Kapitalit Njerëzor Programi i arritjes kryesore nr.10 Garancia Rinore			
Data përfundimtare e lidhjes së Marrëveshjes së Financimit	Të paktën deri më 31 dhjetor 2025			
Afati i likuidimit për çdo angazhim buxhetor	Angazhimi buxhetor 2024: deri më 31/12/2029 Angazhimi buxhetor 2025: deri më 31/12/2029 Angazhimi buxhetor 2026: deri më 31/12/2029 Angazhimi buxhetor 2027: deri më 31/12/2029			
Periudha indikative e pranueshmërisë	31/12/2033			
Data përfundimtare për zbatimin e Marrëveshjes së Financimit	12 vjet pas lidhjes së Marrëveshjes së Financimit			

1.2 Përmbledhja e Programit

Raporti i Komisionit Evropian[1] për Shqipërinë për vitin 2023 njeh angazhimin e qeverisë për krijimin e një skeme garancie për të rinjtë, të reflektuar në miratimin e Deklaratës së Brdo-s për garantimin e

[1] Albania Report 2023 - European Commission (europa.eu)

integrimit të qëndrueshëm të tregut të punës për të rinjtë më 8 korrik 2021. Në përputhje me këtë angazhim, Shqipëria synon që gradualisht të zbatojë skemën e Garancisë Rinore, siç përshkruhet në Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023-2030 (SKPA). Kjo strategji synon në mënyrë specifike të rinjtë që nuk janë në arsim, punësim ose trajnim (NEET) dhe është në përputhje me objektivat e Garancisë Rinore të Ballkanit Perëndimor, si pjesë e Planit Ekonomik dhe Investimeve (PEI), Programi kryesor nr. 10.

Objektivi kryesor i Programit Operacional të BE-së për Punësimin e të Rinjve është që t'u garantojë të rinjve të papunë dhe joaktivë, të regjistruar në zyrat e punësimit, mundësi cilësore punësimi, trajnimi ose arsimimi brenda një periudhe katërmujore nga data e regjistrimit. Programi do të fokusohet kryesisht në popullatën NEET të moshës 15-29 vjeç, duke pasur parasysh shkallën e tyre të lartë të papunësisë dhe inaktivitetit. Duke adresuar sfidat me të cilat përballen të rinjtë në aksesin në punë të përshtatshme dhe përvetësimin e aftësive përkatëse për tregun e punës, Garancia Rinore synon të zbusë mungesën e perspektivave të së ardhmes që shpesh çon në nevojë në rritje për të emigruar. Për të lehtësuar zbatimin me sukses të Garancisë Rinore, Shqipëria ka miratuar Planin e Zbatimit të Garancisë Rinore 2023-2024 (PZGR). Ky plan do të drejtojë fazën fillestare pilot, e cila u prezantua më 27 tetor 2023.

Programi Operacional i BE-së për Punësimin e të Rinjve 2024-2027 synon *të garantojë integrimin gjithëpërfshirës dhe të përgjegjshëm në tregun e punës të një fuqie punëtore të re të aftë dhe të adaptueshme.* Fushat e mbështetjes në kuadër të programit janë përshkruar si më poshtë:

Fusha e mbështetjes 1: Punësimi i të rinjve

Kjo fushë e mbështetjes fokusohet në rritjen e punësimit dhe aftësinë e të rinjve për të punuar, me theks të veçantë në grupet vulnerabil. Përfshin zbatimin e një modeli të përforcuar të ofrimit të Garancisë Rinore (GR), duke u mbështetur në mësimet e nxjerra nga faza pilot dhe duke përmirësuar kapacitetet e Agjencisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (AKPA), si dhe të gjithë partnerëve të tjerë në nivel lokal dhe kombëtar në Shqipëri. Faza e shtrirjes në PZGR në Shqipëri parashikon, ndër aktivitete të tjera, edhe përdorimin e mjeteve dixhitale si një komponent thelbësor i strategjive moderne të angazhimit dhe përfshirjes së NEET të rinj në ideimin e fushatave të komunikimit. Në këtë kontekst, AKPA është e vendosur të prezantojë një portal të dedikuar "Garancia Rinore", që të shërbejë si një platformë gjithëpërfshirëse për shkëmbimin e informacionit rreth Garancisë Rinore dhe të mundësojë regjistrimin paraprakisht të NEET. Aktivitetet e pranueshme përfshijnë iniciativa të ndryshme, të tilla si aktivitete informuese në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare për Rininë (AKR) dhe organizatat rinore, përgatitjen e të rinjve përpara se të regjistrohen në Garancinë Rinore, krijimin e kapaciteteve të organizatave rinore dhe fushatave informuese mbi të drejtat e të rinjve në vendin e punës. Për më tepër, programi synon të forcojë politikat dhe kapacitetin e AKPA-s duke përmirësuar platformën e tyre të Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit (TIK) dhe duke rritur burimet njerëzore për përpunimin e të dhënave. Për të rritur shtrirjen dhe cilësinë e shërbimeve të punësimit, do të rekrutohet staf shtesë, do të krijohen zyra pune miqësore për të rinjtë dhe do të forcohet mbështetja për këshilltarët që të kontaktojnë të rinjtë në zona të largëta. Përveç kësaj, programi fokusohet në përmirësimin e punësueshmërisë së të rinjve vulnerabil përmes Programeve Aktive të Tregut të Punës (PATP), aftësive të vetëpunësimit dhe sipërmarrjes dhe përmirësimit të shërbimeve të punësimit. Kjo fushë e mbështetjes varet nga një përpjekje bashkëpunuese, duke ftuar të rinjtë dhe përfaqësuesit e të rinjve që të drejtojnë qasje të reja, të përshtatura dhe miqësore me të rinjtë për ofrimin e shërbimeve të integruara në nivelin bazë, në bashkëpunim me punëdhënësit, organizatat e punëdhënësve, shërbimet sociale komunale, arsimin dhe ofruesit e trajnimit, këshillat rinorë vendore dhe partnerë të tjerë socialë.

Fusha e mbështetjes 2: Arsimi dhe formimi profesional

Kjo fushë e mbështetjes fokusohet në përmirësimin e cilësisë, fleksibilitetit dhe diversitetit të ofertës së arsimit dhe trajnimit profesional për të rritur perspektivat e karrierës së të rinjve dhe rriturve të rinj nën 30 vjeç. Ajo thekson nevojën për të përditësuar programet e Arsimit dhe Formimit Profesional fillestar dhe të vazhdueshëm (AFP) të ofruara nga ofruesit publikë të AFP-së, për t'u përshtatur me nevojat e industrisë. Programet e reja të arsimit pas arsimit të mesëm do të zhvillohen dhe do të ofrohen përmes shkollave të AFP-së dhe përmes modeleve të praktikës. Për të mbështetur zbatimin e këtyre programeve të përditësuara, shkollave të AFP-së do t'u jepen grante për të përmirësuar kapacitetet e stafit pedagogjik dhe drejtues, për të zhvilluar materiale mësimore dhe për të përmirësuar drejtimin, ambientet dhe burimet. Përpjekjet për të përmirësuar mjedisin e të mësuarit në shkollat e AFP-së do të lehtësohen

duke investuar në infrastrukturën dhe laboratorët e rinovuar të shkollave, sidomos me ndërveprimin e shtuar midis aktorëve të tregut të punës dhe shkollave të AFP-së, konkurse për aftësitë dhe aftësitë e nevojshme për të përfituar nga mundësitë e reja në tranzicionin e gjelbër dhe atë dixhital. Programe dhe burime të specializuara do të zhvillohen për të mbështetur studentët që përballen me vështirësi në të nxënë, ndërkohë që do të ofrohen bursa për studentët vulnerabil, duke siguruar aksesin e tyre në arsimin profesional cilësor. Për më tepër, kjo fushë e mbështetjes do të ofrojë mundësi për përmirësim dhe rikualifikim në bashkëpunim me ofruesit privatë dhe publikë.

Fusha e mbështetjes 3: Mbështetje tjetër

Një objektiv tjetër i programit është të mbështesë Autoritetin Menaxhues, Organet e Ndërmjetme dhe strukturat dhe autoritetet e tjera, përfshirë partnerët e Programit Operacional, në zbatimin e Programit Operacional duke forcuar kapacitetet e tyre për të zbatuar dhe monitoruar në mënyrë efektive Programin Operacional dhe për të disbursuar me sukses fondet e alokuara nëpërmjet një game të gjerë trajnimesh dhe aktivitetesh të tjera për forcimin e kapaciteteve, si dhe duke dhënë kompensime shtesë, për të adresuar ngarkesën e punës që rrjedh nga zbatimi i këtij PO (Programi Operacional), për pagat e personave të caktuar, me qëllim parandalimin e qarkullimit të stafit dhe krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm pune. Qëllimi është të garantohet zbatimi, monitorimi dhe komunikimi efikas dhe efektiv. Do të ofrohet një sistem gjithëpërfshirës mbështetjeje, duke përfshirë asistencën për zhvillimin e projektit, kryerjen e studimeve dhe krijimin e një sistemi të brendshëm monitorimi. Programi do të shërbejë gjithashtu si një projekt pilot për krijimin e kapaciteteve administrative dhe përafrimin me planet e Ministrisë së Financave për të përgatitur institucionet për të aksesuar fondet e Politikës së Kohezionit.

2. Analiza e sektorit

2.1 Konteksti dhe politikat sektoriale kombëtare

Programi Operacional "BE për Punësimin e të Rinjve" fokusohet në një objektiv specifik: popullsia e të rinjve në grupmoshën 15-29 vjeç, veçanërisht NEET, është objektivi specifik i këtij Programi shumëvjeçar. Kjo pjesë e popullatës së të rinjve është më e rrezikuar për t'u përjashtuar nga tregu i punës. Shkalla e NEET është llogaritur si përqindje e popullsisë së përgjithshme të së njëjtës grupmoshë dhe gjinie dhe ka arritur nivelin 26.1% në vitin 2021. Brenda këtij grupi, 37.3% janë të papunë, 15.4% janë të shkurajuar, 17.5% kujdesen për anëtarët e familjes dhe rreth 29.8% janë joaktivë për arsye të tjera. Meshkujt NEET priren të kenë një përqindje më të lartë të papunësisë (46.8%) dhe femrat NEET priren të kenë një përqindje më të lartë të pasivitetit për shkak të përgjegjësive familjare (31.6%) (INSTAT, AFP 2021).

Dy fusha sektoriale të ndërlidhura të mbështetjes të krijuara në kuadër të këtij Programi Operacional synojnë të forcojnë lidhjet e politikave të tregut të punës, arsimit dhe për rininë duke promovuar politika aktive të tregut të punës të bazuara në aftësi, që synojnë zhbllokimin e mundësive të punësimit për të rinjtë shqiptarë.

Fusha e mbështetjes 1: Punësimi i të rinjve.

Fusha e mbështetjes 2: Arsimi dhe formimi profesional i të rinjve

Disa dokumente strategjike kanë parashikuar reforma të politikave dhe ndërhyrje të planifikuara në këto dy fusha të mbështetjes.

Fusha e mbështetjes 1: Punësimi i të rinjve.

Prioritetet sektoriale janë një pjesë e rëndësishme e kuadrit strategjik afatgjatë të vendit të përcaktuar në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2030 (SKZHIE 2030). Ky kuadër strategjik gjithëpërfshirës përcakton drejtimin dhe prioritetet e zhvillimit të qëndrueshëm socio-ekonomik të vendit në rrugën e tij drejt integrimit në BE, duke përgatitur Shqipërinë për një tranzicion të drejtë të gjelbër dhe dixhital, përfshirë lidhjet me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) për të arritur qëllimet e Axhendës 2030 duke përcaktuar vizionin për zhvillimin demokratik socio-ekonomik të vendit në periudhën 2022-2030. Punësimi dhe përfshirja sociale trajtohen në shtyllën e tretë të SKZHIE 2030, Kohezioni Social, e cila fokusohet në zhvillimin e burimeve njerëzore si aseti më i çmuar i vendit dhe synon ofrimin e shërbimeve publike bazë për të gjithë, luftën kundër varfërisë dhe nxitjen e punësimit, forcimin e sistemin e mbrojtjes sociale dhe mbështetjen e personave në nevojë.

Strategjia e re Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023-2030 (SKPA 2023-2030)[1] është plotësisht në përputhje me objektivat e kuadrit të programimit IPA III dhe vazhdon këto vizione me objektiva më ambicioze në drejtim të promovimit të axhendës së aftësive dhe politikave të tregut të punës. Ajo synon Vende Pune Cilësore dhe Aftësi gjatë gjithë jetës për të gjithë dhe merr parasysh reformat dhe ndërhyrjet që lidhen me zhvillimin e aftësive dhe përputhjen më të mirë të aftësive për të rritur mundësitë e punësimit të denjë dhe gjithëpërfshirës për të gjithë gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë. SKPA 2023-2030 është funksionalizuar përmes një plani veprimi që mbulon periudhën 2023-2030. SKPA 2023 – 2030 ka një kosto të llogaritur prej 75.5 miliardë lekësh (afërsisht 650 milionë Euro), nga të cilat 67% financohet nga buxheti i shtetit dhe 10% nga programet ndërkombëtare të zhvillimit. Hendeku financiar i SKPA 2023-2030 është në nivelin 23%.

Një nga masat kryesore të SKPA 2023-2030, sipas Qëllimit të Politikës 2, është një "tranzicion i mbështetur dhe gjithëpërfshirës në punë për të rinjtë (NEET) nëpërmjet zbatimit të skemës së Garancisë Rinore". Reformat dhe ndërhyrjet do të kontribuojnë në zbatimin me sukses të Garancisë Rinore, por edhe në përparimin e mëtejshëm në politikat e përgjithshme të punësimit dhe zhvillimit të aftësive, të tilla si promovimi i mundësive gjithëpërfshirëse të të mësuarit gjatë gjithë jetës, njohja e edukimit të mëparshëm joformal dhe informal, transformimi dixhital i shërbimeve dhe programeve të punësimit, krijimi i një sistemi hartëzimi të aftësive për të mbështetur zhvillimin e mëtejshëm të shërbimeve të orientimit dhe këshillimit, zgjerimi dhe konsolidimi i shërbimeve për punëdhënësit dhe punëkërkuesit të përshtatur me nevojat e tyre dhe zbatimi i programeve të trajnimit dhe punësimit në partneritet me aktorë të tjerë të tregut të punës. Krijimi i pikave hyrëse fleksibël dhe të larmishëm do të mundësojë një mjedis më produktiv për arsimin e vazhdueshëm në mënyrë që NEET të rihyjnë në arsim për t'u ritrajnuar dhe përmirësuar aftësitë e tyre të punësimit.

Megjithëse orientimi dhe këshillimi nuk janë objekt i një veprimi strategjik specifik në SKPA 2023-2030, Strategjia ka krijuar mundësi të reja për konsolidimin dhe zgjerimin e shërbimeve të orientimit dhe këshillimit brenda shërbimeve të punësimit dhe ofrimit të shërbimeve të AFP-së. Në përputhje me politikën 'dixhitali i pari', SKPA 2023-2030 parashikon dixhitalizimin e plotë të shërbimeve dhe proceseve të punësimit dhe konsolidimin e Observatorit të Informacionit të Tregut të Punës si një mjet për t'u përdorur për ofrimin e sinjaleve të tregut të punës dhe përditësimin e informacione për tregun e punës për këshilltarët e karrierës dhe punëtorët në nivel lokal, të cilët kontaktojnë të rinjtë.

Qasjet orientuese dhe këshilluese për menaxhimin e rasteve të punëkërkuesve të papunë janë planifikuar të optimizohen. Strategjia synon të përmirësojë efikasitetin e modelit të shërbimeve të punësimit me tre nivele[2]. Institucionet do të zhvillojnë qasje dhe modele të specializuara për menaxhimin e rasteve në nivelin e tretë dhe do të ofrojnë shërbime këshillimi për punëkërkuesit në partneritet me aktorë të tjerë të tregut të punës, gjë që do të ndihmojë gjithashtu në adresimin e pengesave të tregut të punës në mënyrë të specializuar. Këto partneritete do të bëjnë të mundur shfrytëzimin e përvojës dhe kapaciteteve të aktorëve të ndryshëm në nivel qendror dhe vendor, si organizatat joqeveritare, organizatat ndërkombëtare, ofruesit e trajnimeve publike dhe private, ofruesit e shërbimeve mbështetëse, arsimit bazë dhe të mesëm profesional për të rritur, dhomat e tregtisë, industrisë dhe tregtisë, organizatat e punëdhënësve, partnerët socialë, agjencitë private të punësimit dhe grupe të tjera formale dhe joformale.

Strategjia Kombëtare për Rininë 2022-2029 (SKR 2022-2029)[3], në përputhje me Strategjinë Evropiane për Rininë 2019 – 2027, synon të sigurojë të drejta dhe mundësi të barabarta, mbështetje dhe angazhim për të rinjtë vulnerabil, inferiorë dhe të rinjtë më të prekur nga

[1] Fletore zyrtare, VKM nr. 173, 24.03.2023; për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësim, planin e saj të zbatimit 2023-2030 dhe Planin e Zbatimit të Garancisë Rinore 2023-2024.

[2] Niveli i parë i punësueshmërisë: Punëkërkuesi është gati për punë dhe nuk ka probleme të dukshme dytësore dhe personale dhe paraqet rrezik të ulët për t'u kthyer në një të papunë afatgjatë. Niveli i dytë i punësueshmërisë: Punëkërkuesi është afër tregut të punës, por profilizimi ekonometrik tregon se ka një risk rrezik që ai/ajo të shndërrohet në një të papunë afatgjatë. Niveli i tretë i punësueshmërisë: Punëkërkuesi është në disavantazh dhe më shumë në rrezik për t'u kthyer në një të papunë afatgjatë. Punëkërkuesit e nivelit të tretë të punësueshmërisë përbëjnë kategorinë me prioritetin më të lartë për t'u angazhuar në një ndërveprim intensiv me këshilltarin e AKPA-s dhe ky grup do të ketë në dispozicion të menjëhershëm një gamë gjithëpërfshirëse ndërhyrjesh.

[3] Fletore Zyrtare, VKM nr. 692, 26.10.2022; për Miratimin e Strategjisë Kombëtare për të Rinjtë dhe planin e saj të zbatimit 2022-2029.

varfëria, dhuna, abuzimi, aftësia e kufizuar dhe përjashtimi social. Janë planifikuar reforma dhe ndërhyrje që kontribuojnë në zbatimin me sukses të skemës së Garancisë Rinore, por edhe në përmirësimin e mëtejshëm të pozitës së përgjithshme të të rinjve në shoqëri, si: krijimi i aftësive të punësimit të të rinjve, mbështetur nga shërbimet e këshillimit për karrierë dhe punësimit të orientuar drejt të rinjve, rritja dhe përmirësimi i mundësive për të hyrë në tregun e punës, inovacioni dhe arsimi cilësor për të ndihmuar të rinjtë të arrijnë potencialin e tyre të plotë, siguria, siguria dhe përfshirja e të rinjve, duke marrë parasysh nevojat e tyre të larmishme dhe të veçanta. Vëmendje e veçantë i kushtohet të rinjve që rrezikojnë marzhinalizimin bazuar në burimet e mundshme të diskriminimit, si origjina e tyre etnike, seksi, orientimi seksual, paaftësia, feja, besimi ose opinioni politik. Përjashtimi socio-ekonomik dhe përjashtimi demokratik shkojnë krah për krah njëri-tjetrit. Të rinjtë që luftojnë me disavantazhet janë përgjithësisht qytetarë më pak aktivë dhe kanë më pak besim tek institucionet.

Fusha e mbështetjes 2: Arsimi dhe formimi profesional i të rinjve

SKPA 2023-2030 vendos njohuritë dhe aftësitë në qendër të modelit ekonomik dhe pret të ketë ndikim pozitiv në rritjen afatgjatë duke promovuar mundësi punësimi të denjë përmes politikave më efektive të tregut të punës dhe duke siguruar Arsim dhe Formim Profesional (AFP) cilësor për të rinjtë, të rriturit, gratë dhe burrat, veçanërisht si një kontribut në transformimin dixhital dhe axhendën e rritjes së gjelbër të vendit; duke ulur në të njëjtën kohë shkallën e punësimit informal në sektorët jobujqësorë. Strategjia thekson zhvillimin e ofrimit të AFP-së që është më i përshtatshëm dhe fleksibël, duke përfshirë mekanizmat e duhur të sigurimit të cilësisë, promovimin e mundësive gjithëpërfshirëse të të mësuarit gjatë gjithë jetës, përfshirë arsimin e të rriturve, dhe masat mundësuese të tilla si njohja e përvojave të mëparshme të të mësuarit dhe përmirësimi i menaxhimit të të dhënave- dhe mundësia në format dixhital – të shërbimeve të trajnimit dhe punësimit.

Në të njëjtën kohë, SKPA 2023-2030 parashikon që institucionet të zhvillojnë dhe të menaxhojnë platforma interaktive të AFP-së në internet dhe të ofrojnë mbështetje të synuar për ofruesit e AFP-së për të përmirësuar dhe forcuar ofrimin e ofrimit arsimit ose trajnimit në mësimdhënie të kombinuar, klasa në internet, dhe e-praktika, si një modalitet i ri dhe plotësues i trajnimeve brenda kompanisë. Këto produkte dixhitale do të vlerësohen dhe do të zgjerohen gradualisht për t'u përdorur nga të gjithë ofruesit deri në vitin 2030. SKPA 2023-2030 parashikon forcimin e rolit të Njësive të Zhvillimit brenda ofruesve të AFP-së për të përmirësuar bashkëpunimin me punëdhënësit dhe sektorin privat dhe krijimin e kanaleve të reja të komunikimit me sektorin privat për të mbështetur promovimin dhe angazhimin e sistemit të AFP-së. Ajo parashikon krijimin e grupeve të specializuara në nivel rajonal për të lehtësuar bashkëpunimin ndërmjet shërbimeve të punësimit, institucioneve dhe bizneseve të AFP-së, partnerëve socialë që sigurojnë që programet e trajnimit të përmbushin kërkesat e industrisë në mënyrë efektive. Gjithashtu, ndërgjegjësimi dhe informacioni mbi njohjen e edukimit të mëparshëm joformal dhe informal do të jetë pjesë e promovimit të të mësuarit gjatë gjithë jetës që do të kryhet edhe përmes fushatave *ad hoc* të komunikimit dhe informimit.

Më konkretisht, për reformën e politikave të AFP-së, Ministria e mëparshme e Financave dhe Ekonomisë (MFE), tani Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI)[1], ka zhvilluar gjithashtu **Planin Kombëtar të Zbatimit të Deklaratës së Osnabrück-ut (2022-2025)**[2] i cili është e përfshirë në SKPA 2023-2030. Ky plan u përgatit si përgjigje dhe kontribut për Programin e Reformës Ekonomike (PRE) 2022-2024[3] dhe, si kontribut në përpjekjet e Qeverisë së Shqipërisë (QSH) për krijimin e Skemës Kombëtare të Garancisë Rinore. Plani i zhvilluar bazohet në katër fusha kryesore të politikave: (1) Përfshirja në mënyrë sistematike dhe sistemike e sektorit privat në zhvillimin e aftësive (AFP dhe Punësimi); (2) Sigurimi i qeverisjes së shëndoshë të bazuar në të dhëna të tregut të punës dhe politika të AFP-së; (3) Mbështetja dhe promovimi i të mësuarit cilësor dhe gjithëpërfshirës gjatë gjithë jetës për të përmirësuar punësueshmërinë; (4) Transformimi dixhital i ofrimit të AFP-së dhe ofrimit të shërbimeve të punësimit për tranzicionin e gjelbër.

[1]Që nga themelimi i saj në janar 2024, Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) iu caktua përgjegjësia për çështjet e punësimit dhe punës, duke i marrë përsipër nga ish-Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE).

[2]Plani Kombëtar për Zbatimin e Deklaratës së Osnabrück 2022-2025 u përgatit me mbështetjen e ETF, nga MFE dhe e gjeni në:https://arkiva.financa.gov.al/wp-content/uploads/2022/11/Osnabruck-Declaration_National-Implementation-Plan_Albania51.docx

[3] Në kohën e përgatitjes së tij kontribuoi në PRE 2022-2024. Megjithatë mbetet i rëndësishëm edhe në kontekstin e PRE 2023-2025.

Gjithashtu, Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026[1] (SKA 2021-2026) synon të garantojë një sistem arsimor cilësor bazuar në parimet e përfshirjes dhe të të mësuarit gjatë gjithë jetës, duke mundësuar zhvillimin e potencialit të individit, i cili kontribuon në mirëqenien personale të individëve, si dhe në forcimin e demokracisë dhe integrimin e vendit në Bashkimin Evropian. Është një strategji gjithëpërfshirëse që mbulon të gjithë sektorin e arsimit (me përjashtim të AFP-së) dhe përfshin tre synime kryesore të politikave që lidhen me arsimin parauniversitar, menaxhimin dhe sigurimin e cilësisë dhe arsimin e lartë. Ajo përcakton 14 objektiva specifike që janë në funksion me planin shoqërues të veprimit për periudhën 2021-2026.

Në fushën e arsimit parauniversitar, politika fokusohet në rritjen e pjesëmarrjes në arsimin parauniversitar dhe krijimin e një sistemi për parandalimin dhe reagimin ndaj mosregjistrimit në shkollë dhe rrezikut të braktisjes; zvogëlimin e numrit të studentëve që studiojnë në klasa të përbashkëta; ofrimin e mbështetjes financiare për nxënësit vulnerabil si romë dhe egjiptianë dhe pajisjen e shkollave me softuer dhe mjete teknologjike për të ndihmuar fëmijët me aftësi të kufizuara. Për më tepër, strategjia parashikon pilotimin e SELFIE (një aplikacion i krijuar për të ndihmuar shkollat të përfshijnë teknologjitë dixhitale në mësimdhënie, nxënie dhe vlerësim); ndërgjegjësimin e nxënësve për sigurinë në internet; përfshirjen e nxënësve të shkollave të mesme të ulëta dhe të larta në programin kombëtar të kodimit; dhe integrimin e kompetencës dixhitale përmes teknologjisë së informacionit dhe komunikimit nga klasa e parë e arsimit fillor. Gjithashtu, SKA 2021-2026 parashikon funksionalizimin e plotë të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP), ngritjen e Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Arsimit të Lartë (SMIAL) dhe përfshirjen e elementeve të vlerësimit të rrezikut të braktisjes. Për sa i përket arsimit të lartë, SKA 2021-2026 parashikon krijimin e qendrave të karrierës në të gjithë universitetet publike.

Shqipërisë i mungon aktualisht një kuadër ligjor dhe rregullator gjithëpërfshirës që mbulon mjediset e ndryshme që ndikojnë në një gamë të gjerë aktivitetesh në lidhje me Kujdesin dhe Zhvillimin në Fëmijërinë e Hershme (ECCD), nga arsimi dhe kujdesi për fëmijët te ushqyerja dhe edukimi prindëror. Mungesa e një sistemi rregullator kombëtar ndikon në mjedise të tilla si shtëpitë, qendrat e kujdesit ditor, kopshtet, shkollat dhe institucionet shëndetësore ku ofrohen shërbimet ECCD. Për më tepër, shtrihet në agjencitë publike, private dhe joqeveritare që ofrojnë shërbime ECCD. Është e rëndësishme të theksohet se kujdesi institucional në fëmijërinë e hershme në Shqipëri ndahet në dy struktura të dallueshme: çerdhe, kryesisht për fëmijët e moshës 6 muaj deri në 3 vjeç, dhe kopshti, me fokus zhvillimin holistik të fëmijëve të moshës 3 -6 vjeç. Për të kuptuar më të qartë boshllëqet në kuadrin ligjor, ky dokument do të ruajë këtë dallim dhe do të eksplorojë sfidat rregullatore me të cilat përballen të dy llojet e strukturave.

<u>Politikat horizontale/strategjitë lidhur me arsimin dhe përfshirjen në tregun e punës</u>

Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2015–2023 (SKMS) synon reformimin e politikave të mbrojtjes sociale nëpërmjet transformimit të skemës së ndihmës sociale në një skemë aktive që mundëson riintegrimin social; rishikimin e sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar; ndërhyrjen dhe sigurimin e riintegrimit të fëmijëve në familje dhe komunitet, duke i kushtuar vëmendje të veçantë jetimëve socialë dhe biologjikë, si dhe sigurimin e ofrimit të shërbimeve të integruara të mirëqenies sociale dhe komunitare. Një nga prioritetet është sigurimi i financimit të nevojshëm për grupet e prekura nëpërmjet Fondit Social. SKMS gjithashtu thekson nevojën për të krijuar lidhje dhe një integrim më të mirë ndërmjet politikave aktive të punësimit dhe politikave të përfshirjes sociale dhe mbrojtjes sociale. Tre objektivat kryesore strategjike të SKMS-së janë: A) Reduktimi dhe zbutja e varfërisë, duke u fokusuar në modernizimin e sistemit të ndihmës ekonomike, duke përfshirë menaxhimin e regjistrit elektronik kombëtar dhe sistemin e pikëzimit; fuqizimin e kapaciteteve menaxhuese në nivel kombëtar dhe lokal; përmirësimin e shënjestrimit si dhe transformimin e tij në një program riintegrimi social nëpërmjet masave për aktivizimin e tregut të punës; B) Përmirësimi i cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara, duke u fokusuar në reformimin dhe shënjestrimin më të mirë të skemës së përfitimit në para për personat me aftësi të kufizuara bazuar në sistemin e vlerësimit bio-psiko-social; rritjen e transparencës me anë të krijimit të sistemeve të menaxhimit të informacionit; forcimin e sistemeve të monitorimit dhe kontrollit dhe krijimin e një sistemi të integruar të shërbimeve të kujdesit social për të plotësuar përfitimet në para; dhe C) Ofrimi i shërbimeve të kujdesit social bazuar

[1] Fletore zyrtare, VKM nr. 621, 22.10.2021; për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin dhe planin e saj të zbatimit 2021-2026.

në parimet e decentralizimit dhe deinstitucionalizimit, për përfshirjen e grupeve vulnerabil në programet e Mbrojtjes Sociale. Gjithashtu, këto objektiva janë në përputhje me objektivat e IPA III për përmirësimin e qeverisjes, financimin e sistemit arsimor dhe përfshirjen e grupeve më të pafavorizuara, përfshirë fëmijët dhe komunitetet e marzhinalizuara.

Për sa i përket ofrimit të shërbimeve të integruara, SKZHIE 2030 ka përfshirë objektivin e mëposhtëm: "Çdo individ dhe familje shqiptare, si kategoritë në nevojë, do të kenë akses të barabartë dhe do të përfitojnë nga një sistem funksional dhe i integruar i shërbimeve të kujdesit social, bazuar në parimet e decentralizimit, deinstitucionalizimit dhe diversifikimit të shërbimeve të kujdesit social" (SKZHIE 2030 miratuar në 2023, faqe 133). Në kapitullin e mbrojtjes sociale, SKZHIE thekson gjithashtu veprimet prioritare në lidhje me adresimin e pabarazive dhe luftën kundër diskriminimit ndaj pakicave etnike, lezbikeve, biseksualëve homoseksualë, transgjinorë, interseks dhe queer (LGBTIQ) dhe njerëzve të tjerë të cenueshëm ndaj diskriminimit. Ajo gjithashtu thekson rëndësinë e respektimit të parimeve të barazisë gjinore dhe adresimit të dhunës me bazë gjinore përmes forcimit të mekanizmave të referimit për dhunën në familje dhe ofrimit të duhur të shërbimeve. Këto standarde politikash janë përcaktuar gjithashtu në një numër dokumentesh politikash që miratojnë një qasje ndërsektoriale drejt përfshirjes sociale, siç është Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve (2020-2030) i cili fokusohet në garantimin e aksesit dhe mundësive të riintegrimit për këto komunitete në fushat e: punësimit dhe aftësive, mbrojtjes sociale dhe arsimit gjithëpërfshirës; Axhenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021 – 2026; Plani i Veprimit për Lezbiket, Gej Biseksualët dhe Transgjinorët 2021 – 2027; Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 – 2030 dhe Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025.

Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030[1] synon të krijojë një shoqëri që vlerëson barazinë gjinore dhe drejtësinë gjinore si kushte themelore për zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik dhe politik të vendit, fuqizon të gjithë njerëzit që të gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta dhe bazohet në parimin e tolerancës zero ndaj të gjitha formave të dhunës. Ajo përbëhet nga katër qëllime kryesore strategjike, përfshirë: 1. Përmbushja e të drejtave ekonomike dhe sociale për gratë, të rejat, vajzat dhe burrat, të rinjtë, djemtë në shoqëri dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave nga të gjithë grupet, duke synuar një rritje dhe qëndrueshmëri të ekonomisë mjedisore (së gjelbër), si dhe pjesëmarrjen e tyre të barabartë në dixhitalizim; 2. Përmbushja e të drejtave të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve nga të gjitha grupet, për pjesëmarrje, përfaqësim dhe udhëheqje të barabartë në vendimmarrjen politike e publike në nivel vendor; 3. Zvogëlimi i të gjitha formave të praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.; dhe 4. Aplikimi i integrimit gjinor si mjeti kryesor për arritjen e barazisë dhe drejtësisë gjinore në shoqëri.

Axhenda Dixhitale e Shqipërisë 2022-2026[2] përshkruan vizionin e vendit për transformimin dixhital dhe rritjen ekonomike gjatë pesë viteve të ardhshme, në përputhje me prioritetet politike të KE-së për tranzicionin dixhital. Prioritetet kryesore strategjike të Axhendës Dixhitale të Shqipërisë në lidhje me këtë Program Operacional (OP), janë: promovimi i dixhitalizimit të sektorit publik dhe shërbimeve, të tilla si e-qeverisja, e-shëndeti dhe e-edukimi, për të rritur efikasitetin, transparencën dhe pjesëmarrjen e qytetarëve; nxitja e një ekosistemi të sipërmarrjes dixhitale që mbështet start-ups, inovacionin dhe zhvillimin e aftësive dixhitale; dhe sigurimi i përfshirjes dhe aksesit dixhital për të gjithë qytetarët, veçanërisht grupet vulnerabil dhe ata që jetojnë në zonat rurale. Ajo synon të promovojë investimet në fushat kryesore të informatikës së avancuar dhe përpunimit të të dhënave, inteligjencës artificiale, sigurisë kibernetike dhe aftësive të avancuara dixhitale të nevojshme për t'i zhvilluar ato.

Gjithashtu, dixhitalizimi i arsimit dhe aftësive dixhitale dhe zhvillimi i kompetencave dixhitale nëpërmjet përdorimit më të mirë të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për mësuesit dhe nxënësit janë pjesë e **Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021 – 2026**[3] dhe Planit të Veprimit për

[1] Fletore zyrtare, VKM nr. 400, 30.06.2021; për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe planin e saj të zbatimit 2021-2030.

[2] Fletore zyrtare, VKM nr. 370, 1.6.2022; për miratimin e Strategjisë ndërsektoriale "Agjenda Digjitale e Shqipërisë" dhe planin e saj të zbatimit 2022-2026

[3] Fletore zyrtare, VKM nr. 621, 22.10.2021; për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin dhe planin e saj të zbatimit 2021-2026.

zbatimin e saj, të cilat mbulojnë arsimin e lartë dhe parauniversitar. PO do të mbështesë arritjen e rezultateve të pritshme dhe masat që do të merren për arritjen e objektivave:

-Ngritja e infrastrukturës së përshtatshme për përdorimin e TIK-ut në shkolla dhe mirëmbajtja e saj.

- Zhvillimi i kompetencës dixhitale përmes rritjes së përdorimit të TIK-ut në të gjitha lëndët.

- Ofrimi i shërbimeve cilësore TIK për sistemin arsimor parauniversitar.

Plani i Zbatimit të Garancisë Rinore u miratua si një aneks i SKPA 2023-2030, duke u angazhuar për të ofruar një ofertë të denjë punësimi, trajnimi ose arsimi për çdo të ri NEET (15-29 vjeç) brenda katër muajve nga identifikimi i tyre, siç parashikohet në **Rekomandimin e Këshillit Një urë drejt vendeve të punës – Përforcimi i garancisë rinore (2020),**[1] duke marrë parasysh rrethanat e rajonit. Garancia Rinore do të mundësojë përafrim të mëtejshëm me acquis dhe politikat sociale të BE-së si pjesë e procesit të vazhdueshëm të integrimit Evropian përfshirë Shtyllën e të Drejtave Sociale. Ai përfshin një angazhim për të ofruar punë të denjë dhe arsim cilësor për të rinjtë, në përputhje me Objektivat e OKB-së për Zhvillimin e Qëndrueshëm OZHQ 8 Punë e Denjë dhe Rritje Ekonomike dhe OZHQ 4: Arsimi cilësor.

PZGR 2023-2024[2] i miratuar është në përputhje me kuadrin strategjik të përshkruara më sipër dhe parashikon ndërhyrje të politikave në fushat e mëposhtme: (1) Promovimi i strategjive të informimit dhe aktivizimit për të rinjtë NEET që mbështeten nga konstituimi i partneriteteve vendore të hapura ndaj diversitetit institucional dhe që vlerësojnë afërsinë me të rinjtë; (2) Forcimi i rolit të shkollës dhe udhëzuesve profesional në procesin e ndërmjetësimit për futjen në programin e punësimit dhe AFP, si edhe përputhja e punëkërkuesve me mundësitë për punë.; (3) Konsolidimi i portofolit të programeve ekzistuese të punësimit, dhe shqyrtimi i mundësive për reforma në fushën politike (4) Forcimi i lidhjes midis arsimit dhe trajnimit nga njëra anë dhe dinamikës së tregut të punës nga ana tjetër dhe (5) Krijimi i iniciativave dhe përforcimin e ofertave të formimit profesional të vazhdueshëm, që u mundëson të rinjve mundësi të dytë kualifikimi.

PZGR përfshin tre hapa të ndërlidhur që do të zbatohen paralelisht. Hapi i parë parashikon ndryshimet në kuadrin ligjor dhe miratimin e reformave të politikave të nevojshme për zbatimin e përforcuar të Garancisë Rinore, i cili është një angazhim për të siguruar që të gjithë të rinjtë nën moshën 30 vjeç të marrin një ofertë cilësore punësimi ose arsimi apo trajnimi të vazhdueshëm. Hapi i dytë përfshin reformat e politikave të nevojshme për të futur sistemin e ofrimit të shërbimeve GR (ofrimi i shërbimeve përgatitore dhe cilësore) dhe një projekt pilot, si dhe krijimin e mekanizmave monitorues të udhëhequr nga kuadri i treguesve të Komitetit të Punësimit (EMCO)[3]. Hapi i tretë është përshkallëzimi i sistemit të ofrimit të shërbimeve GR, me monitorim dhe vlerësim të ngushtë në bashkitë pilot. Hapi i tretë do të mbështetet nga PO.

AKPA ka kryer një analizë të plotë të treguesve të rekomanduar për të vlerësuar statusin e NEET të regjistruar në Zyrat e Punësimit. Kjo analizë dha njohuri mbi burimet në dispozicion dhe dinamikat rajonale të tregut të punës. Ajo udhëhoqi AKPA-n në identifikimin e zonave pilot fillestare për sistemin e ofrimit të shërbimit të Garancisë Rinore, duke përfshirë regjistrimin, shërbimet e përgatitjes, ofertat cilësore dhe monitorimin. Programi pilot do të fillojë në bashki të përzgjedhura përpara se të zgjerohet në mbarë vendin. Këto bashki u zgjodhën në bazë të kapacitetit të tyre për ofrim efikas të shërbimeve dhe faktorëve socio-ekonomikë. Bashkitë pilot janë: Shkodra (Veri), Tirana (Qendrore), Vlora (Jug). Projekti pilot i Garancisë Rinore është planifikuar të zgjasë nga fundi i tetorit 2023 deri në shkurt 2024. Qëllimi i këtyre projekteve pilot është mbledhja e përvojave praktike që mund të informojnë nisjen dhe

[1] Rekomandimi i Këshillit i 30 tetorit 2020 Një urë drejt vendeve të punës – Përforcimi i Garancisë Rinore dhe që zëvendëson Rekomandimin e Këshillit të 22 prillitl 2013 për krijimin e Garancisë Rinore 2020/C 372/01, e gjeni në: https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=uriserv%3AOJ.C_.2020.372.01.0001.01.ENG

[2] Fletore zyrtare, VKM nr. 173, 24.03.2023; për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, planin e saj të zbatimit 2023-2030 dhe Planin e Zbatimit të Garancisë Rinore 2023-2024.

[3] Komiteti i Punësimit (EMCO) është komiteti këshillues për Ministrat e Punësimit dhe Çështjeve Sociale në Këshillin e Punësimit dhe Çështjeve Sociale (EPCO) për të promovuar koordinimin e politikave të punësimit dhe tregut të punës si në nivel europian ashtu edhe në nivel kombëtar. Grupi i Treguesve EMCO u mandatua të zhvillonte një propozim të plotë për një metodologji dhe tregues për monitorimin në nivel të BE-së të zbatimit dhe rezultateve të Garancisë Rinore (GR). Kuadri aktual i Treguesve për Monitorimin e Garancisë Rinore u miratua nga EMCO më 28 maj 2015. Ai përfshin tregues në tre nivele: Monitorimi i përgjithshëm: Treguesit makroekonomikë; Monitorimi i drejtpërdrejtë: Monitorimi i ofrimit të GR; Monitorimi vijues: Ndjekja e individëve që kanë dalë nga faza përgatitore e GR.

zbatimin e skemave kombëtare të Garancisë Rinore dhe masat përkatëse nga APKA dhe institucione të tjera. Grupet e synuara përfshijnë persona me nivele të ndryshme aftësish, si të diplomuar, të rinj me kualifikime të kufizuara dhe të rinj të papunë. Qëllimi është të garantohet një ofertë cilësore për të paktën 200 të rinj, duke përdorur një qasje "kush vjen i pari, shërbehet i pari ". Kjo do të përfshijë të regjistruarit e rinj dhe punëkërkuesit e papunë të regjistruar aktualisht, të cilët dëshirojnë të marrin pjesë në programin Garanci Rinore.

2.2 Kuadri ligjor

Ligji për Rininë (Nr. 75/2019) [1] **është kuadri ligjor që mbron dhe promovon të drejtat e të rinjve, njeh rëndësinë e zhvillimit të të rinjve dhe synon të krijojë një mjedis të favorshëm për të rinjtë që të marrin pjesë në aktivitetet sociale, kulturore dhe ekonomike.** Ligji i përkufizon të rinjtë si persona nga mosha 15 deri në 29 vjeç dhe përshkruan të drejtat dhe detyrimet e të rinjve në Shqipëri. Ai parashikon ngritjen e Këshillit Kombëtar Rinor dhe Këshillave Lokale Rinore, të cilat shërbejnë kryesisht si organe këshillimore për institucionet kombëtare dhe bashkitë për çështjet që lidhen me rininë, si edhe dispozita për organizatat rinore në nivel kombëtar dhe vendor.

Fusha e mbështetjes 1: Punësimi i të rinjve.

Ligji për Nxitjen e Punësimit (Nr. 15/2019) [2] **përcakton rregullat dhe funksionet e sistemit të shërbimeve publike të punësimit, programet aktive dhe pasive të tregut të punës, si dhe institucionet përgjegjëse për menaxhimin e tyre**. Ligji synon të promovojë punësueshmërinë e fuqisë punëtore shqiptare, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve dhe programeve publike të punësimit, vetëpunësimit dhe kualifikimeve profesionale. Në përputhje me udhëzimet e BE-së për politikën e punësimit, disa nga dispozitat kryesore të ligjit përfshijnë masa të veçanta për të nxitur punësimin e grupeve si të rinjtë, gratë, personat me aftësi të kufizuara dhe të papunët afatgjatë; programet e nxitjes së punësimit, të tilla si subvencionimi i pagave, praktikat, trajnimet në punë, programet e punësimit në komunitet, vetëpunësimi, skemat e kuponave për ofrimin e trajnimit nga ofruesit jopublikë, praktikat etj. Ligji parashikon gjithashtu stimuj /subvencione për punëdhënësit për të inkurajuar krijimin e vendeve të punës, mundësitë e trajnimit dhe vetëpunësimin.

Ligji për nxitjen e punësimit rregullon edhe shërbimet e punësimit, të cilat përfshijnë shërbime informuese për punëkërkuesit, punëdhënësit dhe të tjerë; vendosjen në punë dhe ndërmjetësimin; dhe orientimin dhe këshillimin për punë. Ligji detyron strukturat rajonale dhe vendore të punësimit të ofrojnë informacion mbi ofertën dhe kërkesën në tregun e punës, informacion mbi shërbimet dhe programet, mundësitë e punësimit, trajnimin dhe aftësitë e ofruara nga institucionet e arsimimit dhe formimit profesional, si dhe orientimin profesional e në karrierë. Shërbimet e specializuara të këshillimit ofrojnë shërbime të thelluara këshillimi në baza individuale për ata klientë që mund të jenë në disavantazh ose të përballen me pengesa për aksesin në mundësitë e punësimit dhe profili i të cilëve tregon se kërkohet një nivel më intensiv i ndërhyrjes. Ofrohet orientim dhe këshillim për karrierë, punësim dhe formim profesional: (1) orientim në karrierë i cili synon të ndihmojë punëkërkuesit në zgjedhjen e një profesioni të përshtatshëm që përputhet me karakteristikat e tyre individuale dhe që kërkohet në tregun e punës; (2) këshillim për punë i cili synon të ndihmojë punëkërkuesit në identifikimin e boshllëqeve në aftësi dhe opsionet e duhura për plotësimin e tyre; (3) këshillim për punësim i cili synon të ndihmojë punëkërkuesit në qartësimin e qëllimeve të tyre të punësimit, qasjen ndaj punësimit dhe mundësive të kualifikimit si dhe ndërgjegjësimin për aftësitë e nevojshme për të gjetur dhe mbajtur një punë.

Ligji për Nxitjen e Punësimit përcakton tipologjinë e shërbimeve të formimit profesional si për punëkërkuesit ashtu edhe për punëdhënësit. Ky ligj ngarkon AKPA-n me ofrimin e programeve të formimit profesional për punëkërkuesit e papunë, si dhe ofrimin e ambienteve.

Ligji për Punëkërkuesit e Papunë (Nr. 146/2015) përcakton përkufizimet administrative të punëkërkuesve të papunë, të drejtat dhe detyrimet e tyre dhe institucionet përgjegjëse për ofrimin e mbështetjes për integrimin në tregun e punës, për sa i përket shërbimeve dhe programeve. AKPA është ngarkuar si institucioni përgjegjës për krijimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave të punëkërkuesve dhe lehtësimin e shërbimeve të përputhjes së punës.

Një gamë e gjerë Masash Aktive të Tregut të Punës (MATP) (të përcaktuara në Ligjin për Nxitjen e Punësimit si fushë e Programeve të Nxitjes së Punësimit në dispozicion të

[1] Fletore zyrtare, Ligji nr. 75, 4.11.2019, Ligji për rininë.
[2] Fletore zyrtare, Ligji nr. 15, 13.3.2019, Ligji për nxitjen e punësimit.

punëkërkuesve. Këto u rishikuan në vitin 2020 për t'i përditësuar me nevojat e ofertës dhe kërkesës në tregun e punës:

- Trajnimi në punë, i cili synon punëkërkuesit pa kualifikime dhe i trajnon ata në punë: i jep punëdhënësit një grant për 4 muaj, bazuar në një plan trajnimi të miratuar të mbikëqyrur nga trajneri i caktuar nga punëdhënësi - *(Vendimi i Këshillit të Ministrat (**VKM) Nr. 17, datë 15.01.2020**)[1] (i ndryshuar)*

- Subvencionimi i pagës, që është një kontratë pune e subvencionuar njëvjeçare, ku nevoja e punëkërkuesit përputhet me profilin e punëdhënësit: paga caktohet në bazë të pagës së tregut dhe kohëzgjatja e subvencionit përcaktohet në bazë të vulnerabilitetit të punëkërkuesit - ***(VKM Nr. 17, datë 15.01.2020)**[2] (i ndryshuar)*

- Programi i punësimit në praktikë, i cili siguron kalimin e shpejtë në tregun e punës për të sapodiplomuarit e kualifikuar, në të njëjtën fushë ose të ngjashme me studimet e tyre, për një periudhë 6-mujore - ***(VKM Nr. 17, datë 15.01.2020)**[3] (i ndryshuar)*

- Programi i Vetëpunësimit, i cili është një program për fillimin e biznesit tuaj që ofron grante financiare dhe mbështetje për punëkërkuesit e papunë, të cilët kanë një biznes dhe plane të provuara, të qëndrueshme dhe të tregtueshme. - ***(VKM Nr. 348, datë 29.04.2020)**[4]*

- Programi i Punësimit dhe Trajnimit në Komunitet, i cili adreson nevojat e punëkërkuesve të papunë afatgjatë, është një program me fokus të qartë në trajnimin e fuqisë punëtore dhe është krijuar për të riintegruar punëkërkuesit në tregun e punës, në përputhje me mundësitë lokale të punësimit. Zbatohet në partneritet me komunitetet dhe organizatat me bazë komunitare - ***(VKM Nr. 535, datë 08.07.2020)**[5]*

- Ofrimi i trajnimit të jashtëm, i cili është një skemë subvencionimi për punëkërkuesit e punësuar dhe të papunë, ku trajnimi ofrohet nga ofruesit privatë të trajnimit - (***VKM Nr. 646, datë 5.10.2022**)[6]

Një PNP i miratuar së fundmi parashikon zbatimin e programit të Trajnimit në Shqipëri për të rinjtë e moshës 15-29 vjeç. Programi ende nuk është vënë në zbatim dhe AKPA po punon për të zhvilluar procedurat e plota të punës për zbatimin e tij. (VKM Nr. 264, datë 27.04.2023)[7]. Ai përfshin elemente të një sistemi trajnimi të dyfishtë, që përfaqëson një qasje më gjithëpërfshirëse për trajnimin dhe punësimin. Vlen të theksohet se, pavarësisht nga këto përparime të rëndësishme, ka ende boshllëqe ligjore që duhen adresuar përpara se një program i plotë i praktikës të mund të zbatohet me sukses.

- Një program i veçantë për personat me aftësi të kufizuara, duke ofruar një grant për përshtatjen e vendit të punës, i cili siguron financim deri në 1600 Euro për të mundësuar përshtatjen e një vendi pune me nevojat e një personi me aftësi të kufizuara.

- Subvencionet për transportin dhe kujdesin ndaj fëmijëve janë në dispozicion për të mbështetur integrimin e punëkërkuesve vulnerabil në tregun e punës.

- Çdo VKM përcakton kriteret, procedurat dhe nivelet e subvencioneve që u ofrohen punëdhënësve partnerë. AKPA ka miratuar udhëzime të brendshme për të përcaktuar rolet dhe përgjegjësitë e stafit të përfshirë në zbatim në nivel qendror, rajonal dhe lokal.

I njëjti ligj prezanton gjithashtu një skemë kuotash/takse për punëdhënësit publikë dhe privatë dhe krijon një Fond Social të Punësimit për financimin e programeve që synojnë integrimin e personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës. Kjo skemë kuote/takse e sapo futur parashikon që çdo punëdhënës me më shumë se 25 punonjës të punësojë një person me aftësi të kufizuara dhe më pas një person me aftësi të kufizuara shtesë për çdo 50 punonjës. Nëse punëdhënësi nuk përmbush këtë detyrim, punëdhënësi duhet të kontribuojë në Fondin Social të Punësimit një shumë të barabartë me 100% të pagës minimale në muaj për çdo detyrim të paplotësuar. Fondi nuk është ende plotësisht funksional.

---

[1] Fletore zyrtare, VKM nr. 17, 15.1.2020 për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit përmes punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale. Rishikimi i fundit më 6.5.2022.

[2] Ibid.

[3] Ibid.

[4] Fletore zyrtare, VKM nr. 348, 29.04.2020 për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit përmes vetëpunësimit. Rishikimi i fundit më 16.08.2022.

[5] Fletore zyrtare, VKM nr. 535, 8.7.2020 për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të punëve publike në komunitet dhe të trajnimit. Rishikimi i fundit më 05.05.2022.

[6] Fletore zyrtare, VKM nr. 646, 5.10.2022, Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të formimit profesional nëpërmjet mbështetjes financiare të ofruar, sipas procedurave të konkurrimit, për kurset e formimit profesional të organizuara nga institucionet e formimit profesional, publike apo private."

[7] Fletore zyrtare, VKM nr. 264, 27.04.2023 për miratimin e procedurave, kritereve dhe rregullave për zbatimin e programit të nxitjes së punësimit, sipas skemës së garancisë rinore nëpërmjet të nxënit në vendin e punës.

Ligji për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Start-up-eve (Nr. 25/2022)[1] synon të plotësojë boshllëkun ekzistues ligjor duke ofruar një kuadër rregullator dhe institucional për krijimin dhe zhvillimin e start-up-eve dhe mbështetjen për ekosistemin, për të promovuar kërkimin, realizimin dhe përdorimin e ideve, modeleve, produkteve dhe proceseve të reja. Disa nga dispozitat kryesore të ligjit përfshijnë ofrimin e mekanizmave mbështetës për zhvillimin e start-up-eve, të tilla si start-up one-stop-shop, dhënien e granteve dhe masa mbështetëse nga buxheti i shtetit, dhe forma të tjera mbështetjeje të zhvilluara në bashkëpunim me palë të treta.

Ligji për Ndërmarrjet Sociale (Nr. 65/2016)[2] rregullon përkufizimin e ndërmarrjeve sociale, veprimtarinë e tyre ekonomike dhe strukturat qeverisëse. Ndërmarrjet sociale mund të kenë akses në financime nga grantet dhe subvencionet e qeverisë, si dhe nga bankat dhe institucionet e tjera financiare, dhe ato duhet të sigurojnë transparencën e aktiviteteve të tyre.

Fusha e mbështetjes 2: Arsimi dhe formimi profesional i të rinjve

Ligji për Arsimin dhe Formimin Profesional (Nr. 15/2017)[3] dhe aktet e tij nënligjore vendosin parimet themelore për ofrimin, qeverisjen, financimin dhe menaxhimin e AFP-së në Shqipëri dhe rregullojnë aspektet e sistemit të AFP-së në përputhje me sistemin arsimor parauniversitar dhe tregun e punës. Ky ligj synon krijimin e një sistemi të AFP-së që plotëson nevojat e tregut të punës dhe u siguron individëve aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për të pasur sukses në fuqinë punëtore, duke parashikuar kualifikime në nivelin 2-5 të Kuadrit Shqiptar të Kualifikimeve (KSHK). Ligji parashikon ngritjen e shkollave profesionale dhe qendrave të trajnimit, njohjen e edukimit paraprak dhe akreditimin e edukimit joformal dhe informal. Edhe pse legjislacioni i AFP-së parashikon formën e dyfishtë që kombinon procesin e punës me arsimin dhe kualifikimin në një institucion ofrues të AFP-së, rregulloret aktuale për këtë formë të marrjes së kualifikimeve të pjesshme ose të plota nuk janë të mjaftueshme. **Ligji për Zejtarinë (Nr. 70.2016)[4]**, i cili parashikon mundësi dhe modalitete kualifikimi për praktikantët në sektorin e zejtarisë, përfshin një skemë praktike. Kjo skemë praktike nuk është plotësisht e rregulluar dhe SKPA 2030 nuk përmban asnjë ndërhyrje për ta përmirësuar atë.

Ligji thekson rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet sistemit arsimor dhe sektorit privat për të siguruar që përmbajtja e programeve të AFP-së të jetë relevante për tregun e punës dhe për të nxitur përfshirjen e partnerëve socialë në zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe programeve të AFP-së. Përveç kësaj, ligji prezanton një sistem të sigurimit dhe zhvillimit të cilësisë, i cili përfshin dispozita në fushën e akreditimit të ofruesve dhe programeve, vetëvlerësimit, inspektimit dhe monitorimit. Ligji njeh rëndësinë e shërbimeve të orientimit dhe këshillimit për t'i ndihmuar studentët të marrin vendime të informuara në lidhje me arsimin dhe rrugën e tyre të karrierës. Ai përcakton që institucionet e AFP-së duhet t'u ofrojnë studentëve shërbime të individualizuara orientuese dhe këshillimi për t'i ndihmuar ata të hyjnë në tregun e punës ose të zgjedhin rrugë të tjera arsimimi, duke përfshirë vlerësimin e interesave dhe aftësive të tyre, sidomos angazhimin e tyre për zhvillimin e qëndrueshëm dhe ndryshimet klimatike, të cilat mund të ofrojnë një faktor të rëndësishëm motivues për të përfituar aftësitë e nevojshme për tranzicionin e gjelbër dhe zhvillimin e qëndrueshëm në përgjithësi, duke ofruar informacion rreth mundësive të punësimit, programeve të AFP-së dhe mundësive të tjera të zhvillimit të karrierës. Ligji parashikon që çdo ofrues i AFP-së ka struktura të dedikuara, përkatësisht Njësitë e Zhvillimit, për të ofruar këto shërbime. VKM-ja e miratuar për Njohjen e të nxënit të mëparshëm[5] parashikon gjithashtu krijimin e rolit të ri të këshilltarëve të karrierës në institucionet e akredituara si ofrues të Njohjes së të Nxënit të mëparshëm (RPL).

KSHK, e cila së fundi i është referuar Kornizës Evropiane të Kualifikimeve[6], rregullohet me Ligjin Nr. 10247/2010, i ndryshuar në vitin 2018[7]. KSHK është e ndarë në tetë nivele, secili me rezultate specifike të të nxënit, dmth, njohuri, aftësi dhe kompetenca më të gjera, me synimin për të përmirësuar transparencën dhe rëndësinë e kualifikimeve në tregun e punës dhe për të përmirësuar

[1] Fletore zyrtare, Ligji nr. 25, 10.3.2022, Për mbështetjen dhe zhvillimin e. startup-eve.
[2] Fletore zyrtare, Ligji nr. 65-2016, 9.6.2016, Ligji për ndërmarrjes sociale në Republikën e Shqipërisë.
[3] Fletore zyrtare, Ligji nr. 15-2017, 16.2.2017, Ligji për Arsimi dhe formimi profesional në Republikën e Shqipërisë.
[4] Fletore zyrtare, Ligji nr. 70-2016, 30.6.2016, Ligji për zejtarinë në Republikën e Shqipërisë.
[5] Fletore zyrtare, VKM nr. 756, 9.12.2021, për sistemin e njohjes së të nxënit të mëparshëm jofomal dhe informal.
[6] Fletore zyrtare, Ligji nr. 10247, 4.3.2010, Ligji për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve. Rishikimi i fundit më 14.06.2018.
[7] Raporti referencë KEK, Shqipëri, e gjeni në: https://europa.eu/europass/en/document-library/eqf-referencing-report-albania

cilësinë e trajnimit, lëvizshmërinë dhe progresin brenda arsimit të ndryshëm. Ligji fillimisht mbulonte vetëm kualifikimet formale të fituara përmes programeve të arsimit fillestar, p.sh., arsimin e përgjithshëm ose parauniversitar, arsimin e përgjithshëm dhe AFP-në. Më vonë, u hartuan dispozita për të promovuar të mësuarit gjatë gjithë jetës, duke i lejuar individët të marrin kredite për aftësitë dhe njohuritë e fituara përmes nxënies joformale dhe informale. Ligji krijon gjithashtu një sistem të sigurimit të cilësisë për kualifikimet dhe përcakton rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve përkatëse përgjegjëse për zbatimin e tij. Për të siguruar një lidhje të ngushtë midis kualifikimeve të KSHK dhe nevojave të tregut të punës, ligji i ndryshuar i KSHK, parashikon krijimin e komiteteve sektoriale të aftësive (KSA), të cilat janë organe këshillimore që identifikojnë nevojat e ardhshme sektoriale për kualifikimet e kërkuara, propozojnë kualifikime të reja dhe ndihmojnë në hartimin dhe vërtetimin e standardeve profesionale dhe të kualifikimeve. Ligji parashikon gjithashtu mundësinë e bashkëpunimit me ekspertë të jashtëm për të arritur sigurimin e cilësisë së kualifikimeve dhe dispozitave që lidhen me të.

Ligji për Arsimin Parauniversitar (Nr. 69/2012, i ndryshuar)[1] përcakton objektivat e arsimit parauniversitar, të cilat përfshijnë zhvillimin e të menduarit kritik, kreativitetin dhe aftësitë për zgjidhjen e problemeve, si dhe promovimin e vlerave sociale dhe qytetare. Ai gjithashtu parashikon krijimin e një kurrikule kuadër kombëtare, që përcakton përmbajtjen, standardet dhe kriteret e vlerësimit për çdo lëndë në çdo nivel të arsimit parauniversitar. Ai përmban dispozita për forma të ndryshme të arsimit të bazuar në shkollë, si mësimi me kohë të plotë, me kohë të pjesshme dhe në distancë. Ky ligj përcakton kufirin e moshës 18 vjeç për hyrjen në arsimin e mesëm të lartë dhe 22 vjet për përfundimin e arsimit të mesëm të lartë. Ky është një faktor kufizues për të mësuarit gjatë gjithë jetës, pasi mundësitë për të marrë Maturën Shtetërore[2] në një fazë të mëvonshme të jetës janë shumë të rralla dhe jo realisht të realizueshme. Mundësitë në dispozicion për arsimin e të rriturve, të quajtura 'Shansi i Dytë' kanë një kohëzgjatje prej 4 vitesh dhe janë të vështira për t'u aksesuar nga personat joaktivë ose të papunë. Një sistem arsimor i depërtueshëm është thelbësor për ofrimin e mundësive të barabarta për individët nga të gjitha shtresat. Duke reduktuar barrierat për hyrjen, ky sistem siguron që arsimi të jetë i aksesueshëm nga një gamë më e gjerë njerëzish, pavarësisht nga statusi i tyre socio-ekonomik ose faktorë të tjerë.

Ligji për arsimin parauniversitar nuk përmban dispozita specifike për orientimin dhe këshillimin në karrierë. Megjithatë, në kuadrin e kurrikulës për të gjitha kualifikimet, veçanërisht arsimin parauniversitar, orientimi në karrierë nuk shihet thjesht si dhënie informacioni dhe as si detyrë e një lënde apo fushe të vetme studimi. Orientimi për karrierë shihet si një përpjekje komplekse nga të gjitha lëndët dhe fushat e studimit për të ofruar një bazë për ndryshime graduale në procesin e të mësuarit. Ka hapësira dhe mundësi për çdo lëndë për të ofruar orientim në karrierë përmes detyrave, aktiviteteve dhe veçanërisht projekteve kurrikulare, për të zhvilluar iniciativën, vetëdrejtimin dhe vetëbesimin, aftësitë individuale të punës dhe punën në grup, për të zhvilluar ide dhe për të marrë iniciativa për zbatimin e tyre duke marrë parasysh mundësitë dhe rreziqet për realizimin e tyre.

Legjislacioni horizontal lidhur me përfshirjen në arsim dhe tregun e punës

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Nr. 10221/2010 (i ndryshuar në vitin 2020)[3] ndalon diskriminimin për arsye të ndryshme, duke përfshirë gjininë, moshën, racën, përkatësinë etnike, fenë, aftësinë e kufizuar, orientimin seksual dhe statusin social. Ai krijon zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi si një autoritet të pavarur përgjegjës për trajtimin e ankesave dhe promovimin e trajtimit të barabartë.

---

[1] Fletore zyrtare, Ligji nr. 69, 21.06.2012, Ligji për Sistemin e Arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë. Rishikimi i fundit më 18.08.2018.

[2] Matura Shtetërore, është një provim gjithëpërfshirës që administrohet në përfundim të arsimit të mesëm në Shqipëri. Përfundimi me sukses i provimit të maturës shtetërore është parakusht për ndjekjen e arsimit të lartë brenda vendit. Pas dhënies së provimit, nxënësve u jepet një "Diplomë Mature", e cila shërben si një vërtetim zyrtar i përmbushjes së kërkesave të tyre për arsimin e mesëm. I prezantuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në vitin 2006, provimi i Maturës Shtetërore ka pësuar modifikime të rëndësishme që nga fillimi i tij. Në vitin 2016, u miratua një ligj i rishikuar për arsimin e lartë për t'u dhënë universiteteve më shumë fleksibilitet në përdorimin e Provimit të Maturës Shtetërore si bazë për pranimin në programet e tyre përkatëse. Megjithëse nxënësit janë ende të detyruar të arrijnë një rezultat minimal të llogaritur sipas një formule të paracaktuar të hartuar nga Këshilli i Ministrave, universitetet tani kanë autonominë për të vendosur kriteret e tyre, për t'i publikuar këto kritere, për të vendosur kuotat e pranimit dhe për të kryer vlerësime të pavarura të aplikantëve të mundshëm.

[3] Fletore zyrtare, Ligji nr. 102, 4.2.2010, Ligji për Mbrojtjen nga diskriminimi. Rishikimi i fundit më 11.11.2020.

Ligji për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar, nr. 93/2014[1]**,** synon mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Ai siguron mundësi të barabarta për pjesëmarrje në shoqëri, arsim, punësim, kujdes shëndetësor dhe akses në shërbimet publike. Ligji urdhëron vendosjen e standardeve të aksesueshmërisë dhe ofrimin e akomodimit të arsyeshëm për personat me aftësi të kufizuara. Një **ligj i fundit për ndihmën sociale, Nr. 57/2019**[2], hoqi një dispozitë të mëparshme sipas së cilës pas 48 muajve të punësimit, personat me aftësi të kufizuara do të humbnin përfitimet e paaftësisë në të holla. Kjo do të jetë një stimul shtesë për të nxitur punësimin e tyre.

Ligji për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Nr. 96/2017[3]**,** njeh dhe mbron të drejtat e pakicave kombëtare. Ai promovon ruajtjen e identitetit kulturor, të të drejtave gjuhësore dhe pjesëmarrjen në jetën publike dhe politike të pakicave komunitare. Ligji gjithashtu krijon Këshillin për Pakicat Kombëtare si një organ konsultativ. Ky ligj njeh komunitetet rome dhe egjiptiane si minoritete etnike në Shqipëri.

Ligji për Barazinë Gjinore Nr. 9970/2008[4] rregullon çështjet themelore të barazisë gjinore në jetën publike, të mbrojtjes dhe trajtimit të barabartë të grave dhe burrave, të mundësive të barabarta në gëzimin e të drejtave, si dhe pjesëmarrjen dhe mbështetjen e grave në zhvillimin e të gjitha fushave të jetës. Ky ligj parashikon masa të posaçme të përkohshme/kalimtare për të garantuar të paktën 30% pjesëmarrje të gjinisë së nënpërfaqësuar në pozitat vendimmarrëse politike dhe publike, si dhe mbrojtje nga diskriminimi në arsim, punësim, media e të tjera. Ai parashikon gjithashtu mbledhjen e detyrueshme të statistikave gjinore nga të gjitha organet shtetërore si agjencitë, si dhe ngritjen e strukturave dhe mekanizmave institucionale për promovimin e barazisë gjinore.

2.3 Mjedisi institucional, drejtimi dhe kapaciteti

Fusha e mbështetjes 1: Punësimi i të rinjve.

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) është institucioni kryesor për zhvillimin e politikave dhe monitorimin e politikave të punës, punësimit dhe zhvillimit të aftësive në Shqipëri. Drejtoria përgjegjëse për këtë politikë është Drejtoria e Përgjithshme e Punësimit, Zhvillimit të Aftësive dhe Policave të Sigurimeve Shoqërore. Struktura e Drejtorisë së Përgjithshme (ish MFE deri në janar 2024, tani MEKI), u rishikua gjatë tremujorit të parë të 2023 duke shtuar më shumë burime. Që nga qershori 2024, ajo përbëhet nga katër drejtori.

MEKI është përgjegjëse për zhvillimin e politikës së punësimit, analizimin e rregullt të tendencave të tregut të punës, parashikimin e zhvillimit të mundshëm dhe zhvillimin e politikave të reja për rritjen e punësimit dhe uljen e papunësisë përmes programeve dhe masave të nxitjes së punësimit dhe vetëpunësimit. Përveç kësaj, MEKI është përgjegjëse për planifikimin dhe shpërndarjen e burimeve për zbatimin e politikave të punësimit dhe zhvillimit të aftësive, duke përfshirë shërbimet e punësimit, MATP dhe AFP. Në kuadër të MEKI, Drejtoria e Përgjithshme për Punësimin, Zhvillimin e Aftësive dhe Politikat e Sigurimeve Shoqërore është përgjegjëse për hartimin e politikave për të siguruar zbatimin e duhur të shërbimeve të punësimit, programeve aktive dhe pasive dhe ka përgjegjësi për dialogun social, negociatat kolektive dhe pagat; ligjin për punën; politikat e punësimit; dhe legjislacionin e punësimit dhe migracionit për motive punësimi. Në kuadër të kësaj drejtorie të përgjithshme, Drejtoria e Punësimit dhe Politikave të Migracionit është përgjegjëse për hartimin e legjislacionit parësor dhe dytësor për punësimin. Në këtë drejtori, e cila së fundmi është ristrukturuar, katër persona janë përgjegjës për politikat e punësimit. Ky numër mund të jetë i mjaftueshëm për të përmbushur në mënyrë kuptimplotë detyrat e politikave që i janë caktuar, por nevojitet mbështetje thelbësore për të menaxhuar kompleksitetin e GR.

Koordinimi global i GR është përgjegjësi e MEKI, dhe Koordinatori Kombëtar është Zëvendësministri përgjegjës për Punësimin dhe Aftësitë. Ky i fundit do të jetë përgjegjës për monitorimin dhe raportimin pranë Kryeministrit dhe Komisionit Evropian për ecurinë e reformave dhe ndërhyrjeve për GR-në, mbledhjen dhe menaxhimin e të dhënave, sistemin e monitorimit dhe vlerësimit, organizimin e takimeve të grupit ndërinstitucional dhe grupit teknik të punës dhe trajtimin e çdo problemi që mund të lindë gjatë përgatitjeve për skemën GR.

[1] Fletore zyrtare, Ligji nr. 93, 24.7.2014, Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara.
[2] Fletore zyrtare, Ligji nr. 57, 18.07.2019, Ligji për asistencën sociale.
[3] Fletore zyrtare, Ligji nr. 96-2017, 13.10.2017, Ligji për Mbrojtjen e Pakicave kombëtare.
[4] Fletore zyrtare, Ligji nr. 9970, 24.7.2008, Ligji për barazinë gjinore në shoqëri.

MEKI mbikëqyr dhe siguron që agjencia zbatuese në Shqipëri, përkatësisht Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, të menaxhojë dhe zbatojë programet e nxitjes së punësimit dhe të menaxhojë strukturat rajonale/lokale të punësimit. AKPA është përgjegjës për zbatimin e politikave publike dhe sigurimin e politikave të punësimit, si dhe për menaxhimin e ofruesve të arsimit dhe formimit profesional. Në ndjekje të vizionit të tij ambicioz për t'u bërë partneri i zgjedhur për studentët e formimit profesional, praktikantët e rritur, punëkërkuesit, personat që ndryshojnë vendin e punës dhe punëdhënësit, AKPA i është nënshtruar një procesi modernizimi dhe reformimi. AKPA e reformuar u krijua në vitin 2019 nëpërmjet një akti nënligjor që përcakton strukturën e saj organizative, e cila përfshin organet administrative dhe ofruesit e shërbimeve për punësim dhe vetëpunësim dhe kjo e hapi institucionin ndaj partneriteteve të mundshme në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar. Këshilli Konsultativ për Punësimin, i krijuar në vitin 2019, është një organ këshillimor për të mbështetur AKPA-n dhe përfshin përfaqësues nga organizatat e punëdhënësve, sindikatat, partnerët socialë dhe institucionet qeveritare.

AKPA ofron një gamë të gjerë shërbimesh orientimi dhe këshillimi për punëkërkuesit, për t'i ndihmuar ata në kërkimin e tyre për punë dhe zhvillim e karrierës. Këto shërbime përfshijnë ofrimin e informacionit dhe këshillimit për zgjedhjet e karrierës, programet e trajnimit dhe studimit, ndryshimin e karrierës dhe lëvizshmërinë, vendosjen dhe vetëpunësimin, si dhe çështje të tjera që lidhen me tregun e punës, si programet e tregut të punës dhe ndihmës financiare. Këshilltarët e punësimit janë kryesisht përgjegjës për ofrimin e shërbimeve të punësimit dhe vlerësimin e profilit, aftësive, kompetencave dhe përshtatshmërisë së punëkërkuesit për vendet e punës në dispozicion. Bazuar në këtë vlerësim, këshilltari përgatit një plan veprimi individual i cili përcakton hapat dhe përgjegjësitë e ardhshme të punëkërkuesve të papunë të regjistruar zyrtarisht dhe zyrtarin e vendosjes në punësim.

Struktura organizative qendrore (selia në Tiranë) e AKPA-s përbëhet nga 90 anëtarë stafi, krahasuar me 36 përpara ristrukturimit në 2019 dhe përbëhet nga 9 drejtori, duke përfshirë Drejtoritë e Programeve Aktive dhe Pasive të Tregut të Punës, Planifikimit dhe Performancës dhe Marrëdhëniet me Punëdhënësin. AKPA është përgjegjëse për zbatimin e politikave kombëtare të punësimit në të gjithë vendin dhe ka 12 zyra rajonale të AKPA-s dhe 40 zyra punësimi, me një total prej 298 punonjësish. Këto zyra u shërbejnë rreth 80,000 punëkërkuesve të regjistruar çdo vit, por për fat të keq, raporti klient-staf i Shërbimit Publik të Punësimit (SHPP) është i lartë, duke filluar nga 600 - 150':1. Ky raport është shumë më i lartë se në shërbimet publike Evropiane të punësimit që janë 'të maturuara', ku raporti mesatar është 150:1. Aktualisht, 115 punonjës punojnë drejtpërdrejt me punëkërkuesit, ndërsa 93 punonjës punojnë me punëdhënësit. AKPA është aktualisht në proces të riorganizimit të shpërndarjes së këshilltarëve të punës për të rregulluar raportin mesatar klient/staf në të gjithë vendin. Megjithëse numri i përgjithshëm i këshilltarëve në Shqipëri ka të ngjarë të mbetet i njëjtë, AKPA planifikon të rrisë numrin total të këshilltarëve në Tiranë. Gjithashtu, janë ngritur dy zyra të lëvizshme në Tiranë dhe Durrës, ku këshilltarët vendosen në bashkitë ku ata kanë më shumë nevojë, duke lëvizur nga bashkia në bashki me rotacion. Ka shumë më tepër mundësi për të zgjeruar idenë e SHPP të lëvizshëm dhe për të sjellë shërbimet tek klientët. Kjo kërkon, ndër të tjera, buxhet udhëtimi të financuar plotësisht për punonjësit e SHPP-së (në përputhje me praktikat më të mira të BE-së).

AKPA është përgjegjëse për koordinimin ekzekutiv të PZGR dhe Koordinatori Ekzekutiv i Planit është drejtori i AKPA-s. Koordinatori Ekzekutiv është përgjegjës për menaxhimin e planit dhe koordinimin e zbatimit të instrumenteve të përfshira në të. Zbatimi do të përfshijë gjithashtu pjesëmarrjen e palëve të interesuara në nivele të shumta, si komunat, dhe kontributet e rëndësishme nga OJQ-të, veçanërisht ato që mbështesin të rinjtë (veçanërisht ata në një situatë të cenueshme). Përveç kësaj, rregullimet institucionale të PZGR parashikojnë një platformë koordinimi dhe monitorimi (Komiteti Monitorues) për të integruar sektorët e ndryshëm të politikave përkatëse.

Përveç institucioneve përgjegjëse në nivel qendror dhe institucioneve zbatuese, koordinimi dhe harmonizimi ndërsektorial me ministritë përgjegjëse për arsimin dhe mbrojtjen sociale, agjencitë e tyre zbatuese, si dhe me komunat luajnë një rol kyç në zbatimin e politikave të punësimit dhe zhvillimit të aftësive. Ofrimi i shërbimeve të integruara në nivel lokal mbetet një sfidë. Autoritetet vendore pritet të luajnë një rol qendror në zbatimin e suksesshëm të Garancisë Rinore.

Sipas strukturës qeverisëse të miratuar të GR, AKPA në bashkëpunim me autoritetet vendore, është përgjegjëse për miratimin e një qasjeje të lokalizuar për identifikimin dhe regjistrimin e NEET-ve joaktive.

Kjo është thelbësore për qëndrueshmërinë dhe suksesin afatgjatë të programit. AKPA mbikëqyr krijimin e Rrjeteve të Bashkëpunimit Vendor dhe përfshin partnerë të rinj në zbatimin e politikave të punësimit dhe trajnimit, duke siguruar një përpjekje gjithëpërfshirëse dhe bashkëpunuese, me bashkitë, organizatat rinore, ofruesit e arsimit dhe partnerët socialë. Autoritetet vendore duhet të mobilizohen për të ofruar strategjinë e shtrirjes, e cila kombinon regjistrimin paraprak të NEET-ve të rinj, informacionin mbi programet dhe mundësitë e tregut të punës, rritjen e ndërgjegjësimit dhe zhvillimin e aftësive bazë të punësimit. Lidhja e këtyre katër fushave të ndërhyrjes do të jetë me vlerë të madhe në përmirësimin e efektivitetit të shërbimeve të ofruara në fazat vijuese.

Këshillat Vendorë Rinorë janë organe këshillimore për kryetarin e çdo bashkie dhe janë struktura relativisht të reja. Ato ende kanë nevojë për kohë dhe burime për të forcuar kapacitetin e tyre operacional dhe njerëzor që të kryejnë në mënyrë efektive funksionet e tyre. Ky proces përfshin identifikimin e dobësive, zbatimin e politikave dhe procedurave të përshtatshme, rekrutimin, trajnimin e stafit të kualifikuar dhe krijimin e kanaleve dhe rrugëve efektive të komunikimit. Këto struktura do të mbështeten nga IPA 2022 BE për Veprimin Rinor. Këshillat Vendore Rinore janë një platformë përkatëse mbi të cilën bazohet qasja e kontaktit krahas punëtorëve të rinj që ekzistojnë tashmë në secilën bashki.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) është ngarkuar me hartimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave të mbrojtjes sociale, me fokus në promovimin e kujdesit social, përfshirjes sociale dhe mundësive të barabarta. Detyrat kryesore të MSHMS përfshijnë zhvillimin e politikave që synojnë mbrojtjen, integrimin dhe përmirësimin e mirëqenies sociale të individëve, familjeve dhe komuniteteve vulnerabil. Përveç kësaj, MSHMS është përgjegjëse për zhvillimin e ndërhyrjeve kundër formave të ndryshme të abuzimit, duke përfshirë dhunën me bazë gjinore, abuzimin e fëmijëve dhe diskriminimin në bazë të gjinisë, orientimit seksual, aftësisë së kufizuar, përkatësisë etnike dhe statusit të pakicës. Kjo përfshin politikat për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, promovimin e barazisë gjinore dhe luftën kundër diskriminimit të bazuar në orientimin seksual, aftësinë e kufizuar, përkatësinë etnike dhe pakicën.

Shërbimi Social Shtetëror është një agjenci qeveritare nën MSHMS. Shërbimi Social Shtetëror është përgjegjës për zbatimin e programeve të ndihmës ekonomike dhe të ndihmës për aftësinë e kufizuar në 61 bashkitë e vendit. Shërbimi Social Shtetëror është i organizuar në një Zyrë Qendrore me 12 drejtori rajonale dhe 29 institucione rezidenciale. Ai punon në bashkëpunim të ngushtë me punonjësit socialë të njësive të ndihmës sociale dhe të shërbimeve sociale të krijuara në çdo bashki. Inspektorët e Ndihmës Ekonomike pranë Shërbimit Social Shtetëror në nivel qendror dhe rajonal janë përgjegjës për monitorimin e programeve të ndihmës ekonomike dhe të ndihmës për aftësinë e kufizuar.

Fusha e mbështetjes 2: Arsimi dhe formimi profesional i të rinjve

Sistemi i AFP-së drejtohet kryesisht nga MEKI, agjencitë kombëtare dhe ofruesit publikë të AFP-së. MEKI është përgjegjës për formulimin e politikave kombëtare, zhvillimin e kuadrit ligjor dhe monitorimin e zbatimit. Ai është gjithashtu përgjegjës për miratimin e kualifikimeve kombëtare të AFP-së, hapjen dhe mbylljen e ofruesve të AFP-së dhe ofrimin e infrastrukturës dhe burimeve njerëzore të AFP-së. Përveç kësaj, MEKI vendos kornizën e sigurimit të cilësisë dhe zhvillimit dhe kryen inspektime të ofruesve publikë dhe privatë të AFP-së. Ministria bashkëpunon ngushtë me institucione të tjera në nivel qendror, duke përfshirë Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS), Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore, për çështje të ndryshme si rekrutimi dhe zhvillimi i mësuesve të lëndëve të përgjithshme dhe organizimi i Provimeve të Maturës për nxënësit e shkollave të mesme AFP. Figura[1] më poshtë jep një pasqyrë të administrimit të sistemit të AFP-së në Shqipëri (përpara transferimit të portofolit të AFP-së nga ish-MFE në MEKI):

[1] Vlerësimi i Sistemit të Arsimit dhe Formimit profesional në Shqipëri. 2020. UNDP, e gjeni në: https://www.undp.org/albania/publications/review-albanias-vet-system



Këshilli Kombëtar i Punës (KKP) është organi më i lartë konsultativ trepalësh i krijuar nga Kodi i Punës[1], që përfshin organizatat e punëdhënësve dhe të punëmarrësve. Ndryshimet në Kodin e Punës në vitin 2015 ristrukturuan KKP-në me qëllim forcimin e dialogut social trepalësh. KKP përbëhet nga 10 anëtarë përfaqësues të organizatave të punëdhënësve dhe 10 anëtarë përfaqësues nga sindikatat, ndërsa Qeveria përfaqësohet nga 7 ministra. KKP i jep rekomandime Këshillit të Ministrave për çështje të punësimit dhe trajnimit.

Këshilli Kombëtar i Arsimit dhe Formimit Profesional (KKAFP) është një organ këshillues i Ministrisë përgjegjëse për politikën e AFP-së. Ai kryesohet nga ministri përgjegjës për AFP-në dhe përbëhet nga përfaqësues të ministrive të tjera të linjës, përfaqësues të shoqatave të bashkive, përfaqësues të organizatave të punëdhënësve, përfaqësues të sindikatave dhe përfaqësues të ofruesve jopublikë të AFP-së.

Zhvillimi, menaxhimi, monitorimi dhe sigurimi i cilësisë së AFP-së mbikëqyret nga dy agjenci kombëtare që janë në varësi të MEKI. Agjencia e parë, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK), u krijua në vitin 2006 me mandat për të krijuar një sistem të unifikuar kombëtar të kualifikimeve profesionale bazuar në KSHK. E riorganizuar rishtazi, që nga tetori 2019, AKAFPK është përgjegjëse për zhvillimin dhe rishikimin e Klasifikimit Kombëtar të Profesioneve (bazuar në ISCO-08), standardet e profesionit dhe vlerësimin, kurrikulën e kornizës kombëtare për nivelet 2-5 të KSHK, akreditimin e Ofruesit e AFP-së dhe organizimin e zhvillimit të vazhdueshëm profesional për mësuesit dhe instruktorët e AFP-së. Numri i stafit është rritur nga 16 në 30. Struktura e saj përfshin Drejtorinë e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale, e organizuar në dy sektorë; Drejtoria e programeve të AFP-së dhe Kualifikimeve të Mësuesve të organizuar në dy sektorë; dhe dy sektorë shtesë, përkatësisht Sektori për Akreditimin e Ofruesve të AFP-së dhe Sektori për Projekte dhe Shërbime Mbështetëse. AKAFPK ofron Sekretariatin Teknik për KSA, i cili u mundëson punëdhënësve të punojnë drejtpërdrejt me AKAFPK dhe ofruesit e trajnimit për të hartuar kurrikulat, aftësitë dhe standardet profesionale, dhe programet e mësimit të dyfishtë që plotësojnë nevojat e tregut të punës. Në këtë mënyrë, punëdhënësit, duke përfshirë bizneset e vogla, mund të luajnë një rol kritik në adresimin e mungesës së aftësive dhe nxitjen e kapitalit njerëzor elastik në sektor dhe vend. Deri më tani janë krijuar dhe funksionojnë dy KSA, në hoteleri dhe turizëm[2] dhe TIK. Ligji për AFP-së parashikon ngritjen e deri në 10 KSA në Shqipëri[3].

Agjencisë së dytë, AKPA, i është besuar përgjegjësia e zgjeruar e mbikëqyrjes dhe mbështetjes së menaxhimit të të gjithë 45 ofruesve publikë të AFP-së (35 shkolla të AFP-së dhe 10 Qendra të Formimit Profesional - QFP) për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve të tyre

[1] Neni 200 i Kodit të Punës

[2] Fletore zyrtare, VKM nr. 163, 06.06.2022, Për ngritjen dhe përbërjen e Komitetit Sektorial të Mikpritjes dhe Turizmit.

[3] Fletore zyrtare, VKM nr. 426, 26.06.2019, për mënyrën e organizimit, funksionimit si dhe kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të komiteteve sektoriale dhe mënyrën e shpërblimit të tyre. Luteni t'i referoheni edhe VKM nr.332, 2.6.2021 për shumën e shpërblimit për anëtarët e komiteteve

përmes monitorimit të rregullt dhe menaxhimit të bazuar në rezultate. Kjo përfshin menaxhimin e certifikatave të AFP-së dhe ndjekjen e të diplomuarve të AFP-së. AKPA ka luajtur më parë një rol të rëndësishëm në sistemin e AFP-së duke menaxhuar 10 QFP publike që ofrojnë trajnime profesionale afatshkurtra. AKPA ka qenë përgjegjëse për kryerjen e Analizës së Nevojave të Aftësive, çdo dy vjet, që nga viti 2010.

Trajnimi zhvillohet kryesisht nga ofruesit publikë të AFP-së (shkollat dhe QFP-të e AFP-së) për të cilët ligji i ri për AFP-së siguron një pjesë më të madhe të autonomisë në drejtim të bashkëpunimit me kompanitë dhe aktiviteteve që gjenerojnë të ardhura. Në vitin shkollor 2022-2023, 35 shkollat profesionale publike, me 1671 staf, ofruan 26 kualifikime të gjera profesionale dhe shumë specializime të tjera (të ashtuquajtura "profile"), duke bërë gjithsej 87 kualifikime profesionale. QFP-të ofrojnë gjithashtu një gamë të gjerë trajnimesh profesionale afatshkurtra. Në vitin 2022, 10 QFP-të publike, të cilat punësojnë 95 punonjës, ofruan 74 programe profesionale afatshkurtra. Edukimi për karrierë është një komponent thelbësor i ofruesve të AFP-së, i plotësuar me aktivitete jashtëshkollore, shpesh në bashkëpunim me kompani, si vizitat në biznese, panairet e punës dhe praktikat. Objektivi është përgatitja e studentëve për jetën e punës duke përmirësuar aftësitë e tyre të menaxhimit të karrierës dhe aftësinë për të kërkuar dhe përdorur informacionin për të marrë vendime. Çdo institucion i AFP-së ka një njësi zhvillimi brenda strukturës së tij të brendshme përgjegjëse për ofrimin e orientimeve në karrierë. Sistemi i AFP-së gjithashtu u ofron nxënësve edukim për karrierë, këshillim dhe orientim për të lehtësuar kalimin e tyre në punësim ose arsimim të mëtejshëm. Numri total i orëve të punës në javë nga anëtarët e njësisë së zhvillimit ndryshon në varësi të numrit të studentëve dhe drejtimeve të ofruara. AKAFPK ofron mjetet dhe trajnimet e nevojshme për stafin e njësisë së zhvillimit të ofruesve të AFP-së, duke përfshirë aspektet e orientimit dhe këshillimit në karrierë.

Oferta private e AFP-së së mesëm të lartë (AFP fillestare) është e kufizuar në një pjesë të vogël të shkollave që ofrojnë programe të ngjashme me ofertën publike. Megjithatë, ofrimi privat i trajnimeve afatshkurtra (C-AFP), duke përfshirë trajnimin profesional, ka përparuar dhe ka hapur mundësi, veçanërisht në sektorët prioritarë, si turizmi dhe TIK, duke u përgatitur më mirë për tranzicionin e gjelbër dhe atë dixhital. Mund të shfrytëzohet bashkëpunimi me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, si një lojtar aktiv i strategjisë dhe planeve të Shqipërisë për Ndryshimet Klimatike.

Organizatave përfaqësuese të sektorit privat dhe partnerëve socialë (p.sh. Dhomat, Shoqatat e Biznesit dhe Sindikatat) nuk u është ngarkuar me ligj një rol specifik në sistemin shqiptar të AFP-së. Kontributi i tyre është kryesisht vullnetar dhe këshillues dhe ofrohet në një sërë komitetesh dhe bordesh si Këshilli Kombëtar i AFP-së, Komitetet e Aftësive Sektoriale dhe Bordet Drejtuese të Ofruesve të AFP-së. Ekspertët e çështjeve nga komuniteti i biznesit pritet të këshillojnë për çështje specifike të sektorit, të propozojnë/rishikojnë kualifikimet e AFP-së, të zhvillojnë dhe të certifikojnë standardet profesionale, të mbështesin nxënien gjatë shërbimit dhe të marrin pjesë në vlerësimin e kompetencave profesionale.

Bordi Drejtues i Ofruesit të AFP-së është një organ kolegjial i krijuar me ligj që merr vendime për drejtimin e përgjithshëm strategjik, planifikimin dhe përdorimin e burimeve njerëzore, financiare dhe infrastrukturore të ofruesit të AFP-së. Bordi drejtues i çdo ofruesi të AFP-së kryesohet nga një përfaqësues i sektorit privat dhe përbëhet nga dy përfaqësues të sektorit privat; një përfaqësues i autoritetit arsimor lokal/rajonal; një përfaqësues i këshillit të rrethit; një përfaqësues i zyrës rajonale/lokale të punësimit; një përfaqësues i studentëve të AFP-së dhe një përfaqësues i stafit mësimor të ofruesit të AFP-së.

Gjithashtu, në vitin 2018, Ministria e Arsimit dhe Sportit nxori urdhrin nr.17, i cili përcakton procedurat për të rriturit që nuk kanë përfunduar arsimin bazë me kohë të plotë për pjesëmarrje në arsimin bazë me kohë të pjesshme, edhe nëse nuk kanë ndjekur të paktën dy klasa të arsimit bazë, të ashtuquajturat programe "Shansi i Dytë". Kjo i lejon ata të pranohen në klasa më të larta se ajo për të cilën kanë një dokument shkolle, me kusht që të miratohet nga një komision i krijuar në nivel shkolle. Megjithatë, pavarësisht këtyre lehtësirave, programi nuk ka qenë i suksesshëm në përmbushjen e nevojave të të rriturve të papunë me aftësi të ulëta, me arsim të ulët, pasi numri i pjesëmarrësve është shumë i vogël dhe programi nuk është realisht i përshtatur me rrethanat reale të këtij grupi.

Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe agjencitë në varësi të saj, dmth. Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar dhe Qendra e Shërbimeve Arsimore, kanë zhvilluar politika

dhe programe për të mbështetur shërbimet e orientimit dhe këshillimit në sistemin arsimor, veçanërisht në shkollat e mesme. Një kurrikulë e re "e bazuar në kompetenca" është futur në arsimin parauniversitar, në të cilën ofrohen module të ndryshme orientimi në karrierë si aktivitete jashtëshkollore. Institucionet e përgjithshme të shkollës së mesme ofrojnë module me zgjedhje, veçanërisht module me zgjedhje profesionale (p.sh. montimi i pajisjeve elektroshtëpiake, punimet e riparimit mekanik, veshja dhe dekorimi etik, puna si guidë turistike, kopshtaria, asistenca në zyrë, etj.) dhe module me zgjedhje lëndore (p.sh. edukimi për karrierë, edukimi financiar, pronësia intelektuale, trashëgimia kulturore, etj.). Moduli me zgjedhje i edukimit në karrierë (36 orë mësimore) synon t'u mundësojë studentëve të vitit të fundit të identifikojnë qëllimet e karrierës, të zhvillojnë aftësi kërkimore në karrierë, të planifikojnë arsimim/trajnim ose punësim të mëtejshëm dhe të kryejnë procedurat e kërkimit në karrierë. Ideja e krijimit të një qëndrimi pozitiv ndaj vetëpunësimit dhe frymës së iniciativës dhe sipërmarrjes është pjesë e të gjitha kurrikulave në arsimin e mesëm të përgjithshëm. Moduli me zgjedhje "Edukimi në karrierë" u dedikohet kryesisht atyre që nuk arrijnë të shkojnë në universitet.

Një udhëzues i fundit i ministrit për orientimin në karrierë[1] synon të ndihmojë institucionet e arsimit parauniversitar, më konkretisht, drejtuesit e shkollave, koordinatorët e orientimit në karrierë, mësuesit dhe këshilltarët e shkollave, në planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve të orientimit në karrierë. Udhëzuesi synon të forcojë bashkëpunimin me prindërit, ofruesit e AFP-së, profesionistët në fusha të ndryshme, bashkitë dhe punëdhënësit. Udhëzuesi përcakton gjithashtu rolet dhe përgjegjësitë e të gjithë aktorëve të përfshirë në proces. Udhëzuesi jep edhe shembuj të aktiviteteve të mundshme që mund të organizohen nga shkollat për të përmirësuar mundësitë e karrierës së nxënësve, si: ditë karriere, panaire karriere dhe panaire pune, takime me profesionistë të ndryshëm, takime me prindër, vizita në vende pune apo institucione arsimore, klubet shkollore të ndryshme, etj.

Të 43 universitetet (16 publike dhe 27 jopublike) kanë punësuar staf me kohë të plotë për të menaxhuar Qendrat e tyre të Karrierës dhe Alumni. Këto qendra ofrojnë udhëzime për karrierë si pjesë e angazhimit të tyre ndaj procesit të akreditimit institucional dhe rrisin ndërgjegjësimin për rëndësinë e shërbimeve të orientimit në karrierë në orientimin e studentëve në tregun e punës dhe në zhvillimin e tyre akademik dhe profesional. Qendrat e Karrierës dhe Alumni i ndihmojnë studentët dhe të diplomuarit të lidhin karrierën e tyre akademike me mundësi punësimi dhe promovime në kompani, organizata dhe shoqata të ndryshme të interesuara për të gjetur punonjës. Ato gjithashtu ndihmojnë studentët në zhvillimin e karrierës, duke vlerësuar interesat e tyre personale dhe duke i përshtatur ato me punën, pagat dhe kushtet që janë me interes për të dyja palët. Qendrat e Karrierës dhe Alumni shpërndajnë informacion në lidhje me mundësitë e tregut të punës, mundësitë e praktikës, kualifikimet, etj. Ato organizojnë takime ndërmjet të diplomuarve dhe studentëve për të shkëmbyer përvojat e punësimit dhe për të organizuar aktivitete të përbashkëta. Studentët e diplomuar ofrojnë informacion bazuar në përvojën e tyre personale dhe këshillimin e karrierës për studentët.

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët synon të forcojë përfshirjen e të rinjve në proceset vendimmarrëse politike, të mbrojë të drejtat e të rinjve, të krijojë kushtet e nevojshme për aktivizim dhe pjesëmarrje. Si institucioni përgjegjës me fokus të rinjtë dhe fëmijët, Ministri i Shtetit ndërton ura bashkëpunimi midis fëmijëve dhe të rinjve dhe në organizata në Shqipëri dhe diasporë, me përfaqësues të institucioneve publike dhe private, si dhe me organizatat e shoqërisë civile që punojnë në fushën e rinisë. Agjencia Kombëtare e Rinisë është organ në varësi të Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, të cilës i është besuar garantimi dhe promovimi i të drejtave të të rinjve nëpërmjet mbështetjes së arsimit joformal, ndërveprimit të aktivizimit të të rinjve dhe financimit të aktiviteteve rinore, bazuar dhe në zbatim të politikave shtetërore në fushën e rinisë.

Bashkitë nuk kanë asnjë rol të drejtpërdrejtë apo përgjegjësi formale për ofrimin e shërbimeve të arsimit dhe formimit profesional apo punësimit në Shqipëri. Megjithatë, ato kanë një mandat për t'u angazhuar në zhvillimin ekonomik lokal dhe mund t'i mbështesin këto shërbime në mënyrë indirekte duke punuar me institucionet e AFP-së dhe zyrat e punësimit. Përveç kësaj, bashkitë mund të koordinohen me AKPA-n për të mbështetur pjesëmarrësit në programet e nxitjes së punësimit. Një qendër karriere është krijuar nga Bashkia e Tiranës për të ofruar shërbime orientimi në karrierë si për studentët ashtu edhe për të rriturit, me staf që ka marrë trajnime të specializuara.

[1] Urdhër i ministrit nr. 246/2023, e gjeni në: https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2023/01/Udhezuesi-i-karrieres-klasa-9-Final-1.pdf

2.4 Sektori (sektorët) dhe koordinimi i donatorëve

Për politikat e përgjithshme dhe asistencën, Qeveria e Shqipërisë (QSH) ka një strukturë organizative ndërinstitucionale dhe operacionale për menaxhimin e zbatimit të një qasjeje të gjerë sektoriale dhe ndërsektoriale nëpërmjet Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI), i cili vepron si sistemi kryesor që përcakton mjetet dhe mekanizmat për planifikimin e integruar të politikave publike. Agjencia Shtetërore për Planifikimin Strategjik dhe Koordinimin e Ndihmës (SASPAC) është themeluar në tetor 2021. Detyrat kryesore të kësaj Agjencie janë koordinimi i ndihmës së huaj për programet dhe projektet e zhvillimit, koordinimi i procesit të menaxhimit të projekteve me interes kombëtar, ofrimi i mbështetjes metodologjike në hartimin e strategjive ndërsektoriale dhe sektoriale, për t'i përafruar me SKZHIE 2030 dhe për të monitoruar zbatimin e tyre. Kjo Agjenci bashkëpunon ngushtë me Sekretariatin Teknik të Donatorëve, një nismë kolektive e partnerëve të zhvillimit në Shqipëri, për të lehtësuar shkëmbimin më të madh të informacionit ndërmjet partnerëve të zhvillimit dhe qeverisë dhe në veçanti, për të forcuar dialogun e politikave mbi zhvillimet ligjore dhe institucionale, si pjesë e procesit të integrimit në BE që zhvillohet ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë, në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së.

Që nga viti 2014, janë bërë përpjekje për të përcaktuar udhëzime konkrete për procedurat e monitorimit dhe vlerësimit të strategjive sektoriale të miratuara, përkatësisht në krijimin e Grupeve Menaxhimit të Politikave të Integruara (GMPI) dhe përcaktimin e rolit të tyre koordinues të politikave. GMPI-ja e parë për "Punësimin dhe Politikat Sociale" u aktivizua në vitin 2017. Sistemi GMPI u reformua sipas një Urdhri të ri të Kryeministrit në vitin 2023, gjithashtu për të përforcuar qeverisjen në shumë nivele dhe për të integruar parimin e partneritetit; GMPI i ri "Zhvillimi i Kapitalit Njerëzor" përfshin Grupet Tematike për Punësimin, Aftësitë dhe Punën e Denjë, Mbrojtjen Sociale, Arsimin, Fëmijët, Rininë, Kulturën dhe Sportin, Barazinë Gjinore dhe grupet e Marzhinalizuara. Përveç autoriteteve dhe agjencive publike përkatëse, në GMPI përfshihen edhe përfaqësues nga Këshilli Kombëtar i Punës, sindikatat, ofruesit e shërbimeve sociale, Shoqata e Bashkive, sektori privat dhe OJQ-të.

GMPI udhëhiqet nga MEKI, më parë MFE. Donatorët kryesorë të sektorit dhe partnerët zbatues janë të ftuar në takimet e GMPI-së. Aktualisht, donatorët aktivë në këtë sektor përfshijnë BE-në, SDC-në, Ministrinë Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim të Gjermanisë (BMZ), Mbretërinë e Bashkuar (MB), Agjencinë Franceze për Zhvillim (AFD) dhe është në proces negocimi një hua me Bankën Botërore për reformimin e programeve të ndihmës ekonomike dhe riintegrimit. Ky GMPI është gjithashtu e mandatuar të koordinojë harmonizimin e politikave kombëtare me Kapitujt 2, 3, 19, 25, 26 dhe 28 të Acquis të BE-së.

GMPI funksionon mirë dhe rregullisht që nga viti 2018 dhe të gjitha takimet kanë qenë të dokumentuara saktë me axhendat dhe procesverbalet përkatëse të mbledhjes, me raportim të rregullt në drejtorinë përgjegjëse në Kryeministri fillimisht dhe më vonë në SASPAC. Është konsideruar si një praktikë më e mirë nga BE-ja dhe donatorët aktivë në sektorë. Ky GMPI shërbeu gjithashtu si Komiteti Drejtues IPA për Punësimin, AFP, Mbrojtjen Sociale dhe Arsimin, duke monitoruar dhe udhëhequr zbatimin e kontratave sektoriale buxhetore (Kontrata e Reformës Sektoriale "Punësimi dhe Aftësitë 2016-2020" dhe "BE për Përfshirjen Sociale 2019- 2024"). MFE-ja mbajti takime të veçanta konsultimi për politikat me anëtarët e OSHC-ve, që përfaqësonin zërat e grupeve të cenueshme në vend. Reforma e fundit e GMPI-ve ka zgjeruar anëtarësimin tek partnerët socialë.

Gjatë takimeve të GMPI-së dhe grupeve tematike, u diskutua ecuria e reformave të qeverisë në sektorin e punësimit dhe mbrojtjes sociale.

Grupet tematike përkatëse takohen rregullisht, katër herë në vit, dhe kanë miratuar disa dokumente strategjike të politikave, si në sektorin e punësimit ashtu edhe në atë të mbrojtjes sociale, duke përfshirë raportet vjetore të progresit mbi Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive dhe Strategjinë e Mbrojtjes Sociale, draft Planin Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025, Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026, Raportin Vjetor SKPA 2022, dhe Planin e Zbatimit të Garancisë Rinore. Përpjekje dhe koordinim i mëtejshëm nevojiten për të siguruar që çdo GMPI të mund të japë një kontribut të rëndësishëm në Sistemin e Planifikimit të Integruar.

PZGR u hartua nga dy grupe pune të krijuara me urdhër të Kryeministrit, datë 24.02.2022: (i) grupi teknik i punës; dhe (ii) grupi ndërinstitucional, i cili përfshin partnerë si Ministria e Shtetit për Rininë dhe

Fëmijët, MSHMS, MAS, Ministria e Brendshme, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe agjencitë kryesore zbatuese për punësimin, arsimin, dhe kualifikimet. Organizatat ombrellë rinore, partnerë socialë dhe ekspertë të ndryshëm janë gjithashtu aktivë në këto dy grupe. I njëjti plan më pas u konsultua në një takim të GMPI-së dhe u konsultua veçmas me organizatat e shoqërisë civile. Grupi ndërinstitucional do të vazhdojë të funksionojë dhe do të shërbejë si komitet monitorues i PZGR dhe do të përmirësohet dhe forcohet për të zbatuar Kodin Evropian të Sjelljes për Partneritetin.

2.5 Perspektivat buxhetore afatmesme

Siç përshkruhet në Ligjin për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor[1], klasifikimi i buxhetit të Shqipërisë është në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe përfshin klasifikime administrative, ekonomike, funksionale, të bazuara në programe dhe burime financimi. Menaxhimi i buxhetit bazohet kryesisht në institucione dhe fusha të politikave dhe jo në sektorë. Programet buxhetore janë të lidhura drejtpërdrejt me qëllimet dhe objektivat e politikave që janë në përputhje me politikat dhe strategjitë sektoriale.

Raportet e monitorimit për këto programe buxhetore përmbajnë informacion të detajuar mbi shpenzimet përkatëse, progresin e bërë drejt arritjes së secilit objektiv programi, produktet përkatëse dhe objektivat. Megjithëse raportohet informacion i pakët për progresin vjetor, informacioni për numrin e përfituesve nuk jepet gjithmonë. MFE gjithashtu ka identifikuar probleme me cilësinë e raportimit[2] për programe të përzgjedhura buxhetore, shpesh raportet japin vetëm faktet, në vend që të ofrojnë një analizë të detajuar të treguesve të monitorimit dhe zërave të shpenzimeve që mund të shpjegojnë arsyet e mospërputhjes.

Në periudhën 2023-2025, niveli i Programit Buxhetor Afatmesëm për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në Shqipëri mbetet rreth 10% e totalit të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA), me një peshë prej 3.10% të PBB-së.

Tabela 1

PBA MFE 2023-2025	Buxheti 2023	PBA 2024	PBA 2025
Në milion lek	65.992	72.781	74.383
% e PBB	3.03%	3.18%	3.10%
% e PBA total	9.45%	10.44%	10.18%

Dy programet kryesore buxhetore që trajtojnë tipologjinë e shpenzimeve në kuadër të këtij programi janë Tregu i Punës dhe Arsimi dhe Formimi Profesional, të cilat ishin pjesë e PBA-së të MFE-it, por që janë transferuar dhe menaxhohen nga MEKI pas ristrukturimit. Siç analizohet në tabelën 2, buxheti vjetor për tregun e punës është rritur me 20%, ndërsa buxheti për arsimin dhe formimin profesional është rritur me 30%. Këto rritje tregojnë përkushtimin e qeverisë për të adresuar sfidat e tregut të punës dhe për të përmirësuar aftësitë e fuqisë punëtore. Perspektivat buxhetore për 2024 dhe 2025 janë pothuajse identike me buxhetin e vitit 2023, duke treguar një fokus të vazhdueshëm në këto fusha kritike. Në PBA 2025-2027, e cila është në përgatitje e sipër që nga qershori 2024, pjesa e planifikimit të buxhetit për tregun e punës dhe formimin profesional do të mbetet nën MEKI.

Tabela 2

PBA MEKI 2023-2025	Buxheti 2023 (LEK)	PBA 2024 (LEK)	PBA 2025 (LEK)
10550 Tregu i punës	2,434,006 (+20%)	2,601,000 (+7%)	2,651,000 (+2%)
09240 Arsimi dhe formimi profesional i të rinjve	3,394,159 (+30%)	3,338,469 (-2%)	3,318,469 (-1%)

[1] Fletore zyrtare, Ligji nr. 9936, 26.6.2008, Ligji për Menaxhimin e Sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë. Rishikimi i fundit më 22.10.2021.

[2] Jorgoni, Elira dhe Sorensen, Dajna (2022). ESPN Thematic Report on National monitoring frameworks for public social spending – Albania, European Social Policy Network (ESPN), Brussels: Komisioni Europian.

Llogaritja e kostos së SKPA 2023-2030 vlerëson një hendek të përgjithshëm financimi prej 23%, me hendekun më të madh të llogaritur për objektivin specifik 1.2: përmirësimin e aftësive të të gjitha grave dhe burrave në moshë pune (43%) dhe objektivin 2.1: ndërmjetësim më gjithëpërfshirës për punëkërkuesit vulnerabil (34%).

Zbatimi i PZGR do të kërkojë një shumë të konsiderueshme fondesh për shkak të objektivave dhe masave ambicioze të propozuara. Tabela më poshtë përmbledh kostot totale të PZGR siç përshkruhet në SKPA 2023-2030. Megjithatë, disa aktivitete për të cilat nuk tregohen kosto janë përfshirë në masat e tjera të politikave brenda SKPA 2023-2030, në veçanti objektivat e politikave 1.1 dhe 1.2.

Tabela 3

Pasqyra e buxhetit të PZGR në kostot e planit të veprimit të SKPA 2023-2030[1]				
2.1.2. Tranzicion i mbështetur dhe gjithëpërfshirës nga shkolla në punë për të rinjtë (NEET) nëpërmjet zbatimit të skemës së Garancisë Rinore	**Kosto Indikative 2023-2030 (LEK)**	**Buxheti i shtetit (LEK)**	**Financim i huaj (LEK)**	**Hendeku financiar (LEK)**
Kryerja vlerësimit (vjetor) të profilit NEET në Shqipëri	2.105.100.000	392.481.517	1.032.150.000	680.468.483
Zhvillimi i Portalit Kombëtar për Garancinë Rinore				-
Zgjerimi i sistemit të paralajmërimit të hershëm të zhvilluar dhe testuar tashmë, i cili do të lejojë të vlerësohet rreziku i braktisjes pas arsimit të detyrueshëm				-
Ofrimi i mbështetjes mësimore në ndihmë të nxënësve që rrezikohen nga braktisja				-
Vlerësimi i zbatimit të masave të mbështetjes sociale për të reduktuar disavantazhet për akses në sistemin e arsimit dhe trajnimit	-			-
Zhvillimi dhe zbatimi i fushata informuese të bazuara në komunitet dhe fushata duke përdorur metoda inovatore angazhimi në rrjete sociale në bashkëpunim me partnerë dhe grupe interesi	371.400.000	84.899.129	159.450.000	127.050.871
Organizimi i trajnimeve për zyrat e punës dhe partnerë të tjerë për realizimin e shërbimeve më të specializuara për NEET	92.400.000	-	33.000.000	59.400.000
Përforcimi i shërbimeve të këshillimit dhe udhëzimit brenda sistemit të arsimit dhe trajnimit	-			-
Ofrimi i mbështetjes së personave NEET me aftësitë e kërkimit të punës, aftësitë e buta të tregut të punës, aftësitë dixhitale etj. sipas nevojave të tyre	10.873.356.000	805.080.660	4.764.756.000	5.303.519.340
Përshtatja dhe zgjerimi i programit për nxitjen e punësimit dhe trajnimit siç janë programe që mbështesin punësimin, programe që ofrojnë arsim të mesëm profesional, pas të mesëm dhe arsim me kohë të pjesshëm dhe programe për trajnim të vazhduar dhe praktika profesionale për rritje të aftësive bazë dhe atyre profesionale	-			-
Zgjerimi i sistemit të menaxhimit të informacionit të tregut të punës për të gjurmuar rrugëtimin e të rinjve NEET para, gjatë dhe pas përfshirjes në skemën e Garancisë Rinore	-			-

<u>Fusha e mbështetjes 1: Punësimi i të rinjve</u>

Financimi i politikave publike të punësimit rregullohet nga Ligji për Nxitjen e Punësimit (Nr. 15, 2019) i cili përcakton se politikat e punësimit financohen kryesisht nga buxheti i shtetit, donatorët dhe sektori privat. Buxheti i shtetit është burimi kryesor i financimit për zyrat rajonale të AKPA-s dhe zyrat e punësimit për financimin e ofrimit të shërbimeve të punësimit dhe programeve të nxitjes së punësimit. Në vitin 2023, për ofrimin e shërbimeve të punësimit është akorduar një buxhet prej 445 367 500 lekësh, i cili mbulon kostot e personelit të strukturave të AKPA-s. Kjo përfshin fondet për udhëtimin dhe jetesën e personelit të zyrës së punësimit që ofron shërbime për punëkërkuesit dhe punëdhënësit jashtë ambienteve të Zyrave të Punësimit. Parashikohet të përmirësohet sistemi IT i shërbimeve të punësimit dhe parashikohen rreth 60 000 000 lekë në vit.

[1] Fletore zyrtare, VKM nr. 173, 24.03.2023; për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësim, planin e saj të zbatimit 2023-2030 dhe Planin e Zbatimit të Garancisë Rinore 2023-2024.

Buxheti për zbatimin e MATP-ve në vitin 2023 është 550 000 000 lekë dhe parashikon zbatimin e llojeve të ndryshme të PNP-ve të miratuara. Subvencionet e financimit të ofruara nga AKPA përfshijnë subvencionet e pagave për punëdhënësit, grantet për organizatat e shoqërisë civile (OSHC-të), grantet e vetëpunësimit, kostot e transportit, kostot e kujdesit për fëmijët, kostot e arsyeshme të akomodimit për personat e punësuar me aftësi të kufizuara dhe kostot materiale për trajnimin në vendin e punës.

Tabela 4

PBA 2023-2025, 10550 Tregu i punës (LEK)	2023	2024	2025
Strukturat e punësimit (zyra qendrore, 12 zyra rajonale dhe 40 zyra punësimi)	445.367.500	537.667.500	587.667.500
Programe të Nxitjes së Punësimit	550.000.000	550.000.000	550.000.000
Pagesa e papunësisë	900.000.000	900.000.000	950.000.000
QFP (trajnim afatshkurtër)	264.881.000	271.875.000	271.875.000
Sistem IT	66.000.000	60.000.000	60.000.000
Kampus i aftësive	50.000.000	120.000.000	70.000.000

Fusha e mbështetjes 2: Arsimi dhe formimi profesional i të rinjve

Financimi i Arsimit dhe Formimit Profesional Publik rregullohet nga Ligji për AFP (Nr. 15/2017), kreu VI, neni 30, 31 dhe 32, i cili identifikon katër burime financimi: Buxheti i Shtetit, të ardhurat e krijuara nga ofruesit publikë të AFP-së, kontributet nga donatorët dhe sponsorizimi.

Buxheti i Shtetit është burimi kryesor i financimit për AFP-në publike që ndahet si për shkollat e mesme të AFP-së ashtu edhe për QFP-të. Bashkitë janë përgjegjëse për mirëmbajtjen e konvikteve. Financimi nga donatorët është thelbësor për funksionimin e sistemit, duke tejkaluar burimet kombëtare të financimit për AFP-në. Megjithëse nuk ka asnjë detyrim ligjor për punëdhënësit që të kontribuojnë në financimin e AFP-së fillestare, ndodh zakonisht që kompanitë bashkëpunuese që ofrojnë praktika të ofrojnë mbështetje në natyrë, si mentorim, ushqim ose transport për praktikantët.

Alokimi i Buxhetit të Shtetit për ofruesit publikë të AFP-së bazohet në parashikime të rregullta për shpenzime të ndryshme, duke përfshirë personelin (pagat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), shpërblimet për performancë të mirë dhe zhvillim të vazhdueshëm profesional, shpenzimet operacionale (të konsumueshme, riparime, zhvillimi i praktikës dhe teorisë profesionale, aktivitetet jashtëshkollore), dhe investimet (ndërtimi, mirëmbajtja e ndërtesave, infrastrukturës dhe pajisjeve). Planifikimi i shpenzimeve kryhet në nivel qendror nga MEKI, më parë MFE, dhe bazohet në të dhëna historike, duke marrë parasysh numrin e stafit të punësuar dhe studentëve të regjistruar, por jo kostot aktuale për programet specifike të AFP-së.

Dy tabelat e mëposhtme japin një pasqyrë të planeve të financimit për shkollat e AFP-së dhe Qendrat e Formimit Profesional.

Tabela 5

PBA 2023-2025, Produkt – shkollat AFP (09240)	2023 (LEK)	2024 (LEK)	2025 (LEK)
Shkollat AFP (pagat, shpenzimet operative/korrente, materialet për WBL në shkolla)	1.861.213.000	1.859.463.000	1.955.345.000
Bursa për studentët	275.252.000	277.411.000	294.520.000
Tekste shkollore për nxënësit vulnerabil	13.500.000	13.500.000	14.500.000
Infrastruktura e shkollës, rinovimi	790.469.000	868.469.000	748.469.000

Tabela 6

PBA 2023-2025, Produkt – QFP-të (10550)	2023 (LEK)	2024 (LEK)	2025 (LEK)
QFP-të (pagat, shpenzimet operative/korrente, materialet për trajnimin praktik)	264.881.000	271.875.000	271.875.000
Infrastruktura e shkollës, rinovimi	15.000.000	9.000.000	
Krijimi i kampusit të aftësive	50.000.000	120.000.000	70.000.000

Gjithashtu, buxheti i Agjencisë Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Kualifikimeve përfshin shpenzime që lidhen me zbatimin e kuadrit të sigurimit të cilësisë, si akreditimi i ofruesve të AFP-së, rekrutimi i vlerësuesve të jashtëm, shpenzimet e udhëtimit dhe të personelit për vizitat monitoruese dhe përgatitjen e raporteve të akreditimit. Ky buxhet llogaritet të jetë afërsisht 10 000 000 lekë në vit. Gjithashtu, buxheti i akorduar për trajnimin e stafit pedagogjik është afërsisht 6 000 000 lekë në vit dhe pritet të rritet në 8 000 000 lekë në vitin 2025. Një buxhet prej 12 000 000 lekësh është caktuar për rishikimin e standardeve të kualifikimit dhe profesioneve, i cili pritet të rritet në 19 500 000 lekë në 2025. Gjithashtu, zhvillimi i kurrikulave kuadër dhe materialeve të tjera shkollore ka një buxhet prej 13 000 000 lekë në 2023, 16 000 000 lekë në 2024 dhe 22 000 000 lekë në 2025,

2.6 Kuadri i vlerësimit të performancës

Përgjegjësia për monitorimin dhe vlerësimin e punësimit dhe AFP i takon kryesisht AKPA-s dhe AKAFPK, me një njësi të dedikuar brenda AKPA-së përgjegjëse për monitorimin e AFP-së. Një sistem inteligjent i aftësive është duke u përgatitur për të ofruar analiza të përditësuara të tregut të punës bazuar në të dhënat administrative dhe statistikore. Sistemet e menaxhimit të informacionit dixhital do të zhvillohen gjithashtu për administrimin e shkollave AFP. MEKI synon të përmirësojë përgjegjshmërinë dhe të ofrojë informacion më cilësor për palët e interesuara përmes vlerësimeve të progresit dhe performancës, megjithëse kompletimi i sistemit të monitorimit dhe vlerësimit varet nga përdorimi i rregullt i mjeteve dhe integrimi në kulturën dhe rutinën institucionale.

Instituti i Statistikave të Republikës së Shqipërisë (INSTAT) është institucioni kombëtar përgjegjës për mbledhjen dhe certifikimin e të dhënave kombëtare për tregun e punës dhe arsimin. AKPA mbledh dhe raporton të dhëna administrative mbi statistikat kryesore të politikave të tregut të punës, të tilla si të dhënat për papunësinë e regjistruar, shërbimet, masat dhe programet e ofruara nga përfituesi, tipologjinë, etj, dhe të dhëna administrative për vendet e lira të punës. AKPA mbledh gjithashtu të dhëna administrative për sistemin e AFP-së, duke përfshirë të dhëna nga shkollat e AFP-së dhe Qendrat e Formimit Profesional (QFP). AKPA kryen studime për gjurmimin e përfituesve të programeve të Nxitjes së Punësimit, të diplomuarve të shkollave AFP dhe përfituesve të trajnimeve afatshkurtra të ofruara nga QFP-të. INSTAT vazhdon të kryejë Anketën e Fuqisë Punëtore (AFP) dhe Anketën e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës (AANJ), dy anketa të rëndësishme për të kuptuar dinamikën e tregut të punës dhe cenueshmërinë e familjeve.

Kuadri i monitorimit për kuadrin strategjik të punësimit dhe aftësive është aktualisht në fuqi, dhe jep një afat kohor të qartë për raportimin e progresit të përfshirë në planin e veprimit të SKPA 2023-2030. Strategjitë e ciklit të mëparshëm u vlerësuan përmes Raporteve Vjetore që ofronin informacion dhe analizë të përditësuar mbi zbatimin e politikave dhe sfidat e hasura. SKPA 2014-2020 iu nënshtrua një rishikimi afatmesëm në vitin 2019, i cili rezultoi në një rishikim të masave prioritare dhe një zgjatje të Planit të Veprimit deri në vitin 2022. Kuadri i monitorimit ka ndikuar gjithashtu në hartimin e strategjisë së re të SKPA për 2023-2030.

MEKI, më parë MFE, ka identifikuar nevojën për mjete dhe metoda për të vlerësuar lidhjet ndërmjet rezultateve të ofrimit të shërbimeve dhe qëllimit të politikës për të ofruar vende pune cilësore dhe mundësi punësimi për të rinjtë dhe të rriturit. Kuadri i monitorimit dhe vlerësimit për AKAFPK dhe AKPA, duke përfshirë Zyrat e Punësimit, Qendrat e Formimit Profesional dhe shkollat e AFP-së, është zhvilluar me mbështetjen e programeve të jashtme të zhvillimit ndërkombëtar. Ky sistem lejon një përmbledhje dhe sigurim sistematik, të qëndrueshëm dhe lehtësisht të aksesueshëm të informacionit për vendimmarrësit, i cili mund të përdoret për të monitoruar nga afër ofrimin e shërbimeve publike si AFP dhe shërbimeve të punësimit. Sistemi është gjithashtu në gjendje të masë ndikimin e shërbimeve publike, si pjesë e SKPA 2023-2030. Sistemi ende duhet të përfshihet në kuadrin institucional për sa i përket përcaktimit të roleve dhe përgjegjësive dhe mjeteve të nevojshme për vënien e tij plotësisht në funksion.

2.7 Analiza socio-ekonomike (përfshirë analizën SWOT)

<u>Fusha e mbështetjes 1: Punësimi i të rinjve</u>

Rezultatet e tregut të punës për të rinjtë në Shqipëri janë përmirësuar vitet e fundit, por janë ende nën mesataren për vendet e BE-së dhe nën rezultatet për popullsinë në tërësi. Shkalla e

punësimit për grupmoshën 15+ është rritur nga 50.3% në 52.9%. Pavarësisht përmirësimit të shkallës së punësimit të të rinjve (15-29 vjeç), nga 33,8% në 2017 në 41,5% në 2021, hendeku gjinor mbetet i pandryshuar në 10.2 pp. Shkalla e papunësisë për grupmoshën 15+ ka treguar në tendencë pozitive duke u ulur me 2.2 pikë përqindje (pp.) ndërmjet 2017 dhe 2021, deri në 11.5%. Në grupmoshën e të rinjve (15-29) është ulur me 5 pp nga 25.9 në 2017 në 20.9 në 2021.

Shkalla e NEET u ul nga 29.7% në 2017 në 26.1% në 2021. Në këtë grup, 37.3% janë të papunë dhe të tjerët janë jashtë fuqisë punëtore sepse janë punëtorë të dekurajuar (15.4%), që kryejnë detyra shtëpiake dhe familjare (17.5 %) ose për arsye të tjera (29.8%).

Një analizë e detajuar e popullsisë NEET është kryer nga projekti SREPVET[1] bazuar në të dhënat e Anketës së Fuqisë Punëtore dhe të dhënat administrative të AKPA-s për periudhën 2017-2020. Raporti vuri re se më shumë se dy të tretat e NEET (65%) janë ekonomikisht joaktive, ku 60% e këtij grupi janë gra të reja. Përveç ndjenjës së dekurajimit, një nga arsyet e pasivitetit është përgjegjësia për punët e shtëpisë. Gratë përbëjnë 98% të të rinjve NEET që japin këtë arsye për pasivitetin e tyre. Mes të papunësuarve NEE, të papunët afatgjatë përbëjnë shumicën (58.2%) e të papunëve NEET, me meshkujt NEET që janë më të përfaqësuar në këtë kategori. Vetëm 25.6% e numrit të përgjithshëm të NEET-ve janë të regjistruar në shërbimet e punësimit të AKPA-s. Për rrjedhojë, 74% janë 'të panjohur' për shërbimet publike.

I njëjti raport gjeti se **shpërndarja rajonale e NEET** në vitin 2020 tregoi dallime të konsiderueshme.

- Tirana, Durrësi dhe Elbasani përbëjnë një popullsi më urbane në qendër të vendit dhe kanë 51.7% të NEET-ve në shkallë vendi. Këtu përfshihen tre qarqe të nivelit 3[2]: Tiranë (35.1%), Elbasan (8.9%) dhe Durrës (7.7%).

- Zona bregdetare e Shqipërisë, që përfshin të gjitha qarqet bregdetare me përjashtim të Durrësit, kanë 26.9% të NEET-ve. Këtu përfshihen katër qarqe: Vlorë (4.6%), Fier (8.1%), Lezhë (7.4%) dhe Shkodër (6.8%).

- Zonat më në brendësi, të cila përfshijnë pesë qarqet e mbetura, ka 21.5% të NEET-ve. Kjo kategori përfshin qarqet e Dibrës (5.8%), Kukësit (1.2%), Korçës (6.9%), Gjirokastrës (1.4%) dhe Beratit (4.4%).

Qarqet me shkallën më të lartë të të rinjve që janë NEET janë Dibra (49.2%) dhe Lezha (43.2%) – këto ishin të vetmet qarqe me një normë NEET mbi 40% në 2021. Të gjitha qarqet e tjera kanë një normë NEET nën 30 %. Këto ishin edhe qarqet ku situata u përkeqësua ndjeshëm në pesëvjeçarin 2017-2021. Nga ana tjetër, Gjirokastra dhe Fieri shënuan uljen më të madhe të normës NEET gjatë të njëjtës periudhë. Edhe pse numri i NEET-ve është shumë më i lartë – siç u përmend më lart – incidenca është më e ulët në zonat urbane të Durrësit, Elbasanit dhe Tiranës, si dhe në Kukës.

I njëjti raport i prodhuar nga SREPVET identifikoi pesë profile NEET (nën-kategori):

1. Të rinj NEET me përgjegjësi të kujdesit familjar: ato janë pothuajse të gjitha gra me nivele arsimore të ulëta dhe, në një masë më të vogël, mesatare – edhe pse një pjesë e vogël e tyre kanë pasur arsim të lartë. Mungesa e punësueshmërisë së tyre, kryesisht si rezultat i nivelit të ulët mesatar të arsimimit, e kombinuar me një situatë ekonomike të pafavorizuar dhe të pambrojtur sociale, i largon ato nga hyrja në fuqinë punëtore dhe gjetja e një pune. Shumica dërrmuese janë të martuara. Ato përfaqësojnë rreth 17% të totalit (30,716). Kërkesa më e rëndësishme për këtë grup duket se është mbështetja sociale dhe ekonomike për të plotësuar arsimin dhe trajnimin. Përveç kësaj, ato kanë nevojë për akses të garantuar në edukimin dhe kujdesin në fëmijërinë e hershme (ECEC) edhe për fëmijët e tyre.

2. NEET të dekurajuar: janë të rinjtë në grupet më të reja që nuk janë të punësuar dhe nuk kanë pasur kurrë përvojë pune, nuk kanë asnjë perspektivë për të gjetur një punë dhe zakonisht kanë një nivel të ulët ose mesatar kualifikimi për shkak të dështimit në shkollë dhe braktisjes së hershme të shkollës. Këta të rinj nuk kanë aftësitë e duhura për kërkim aktiv të suksesshëm të punës. Ata zënë rreth 15% të totalit (28101). Zhvillimi i aftësive sociale, mentorimi dhe mundësia e një shansi të dytë duket se janë ato që ky grup ka shumë nevojë. NEET me aftësi të kufizuara janë një pakicë në mesin e të rinjve që janë joaktivë. Inaktiviteti i tyre është kryesisht për shkak të aftësisë së tyre të kufizuar. Të dhënat në

[1] Asistencë Teknike për mbështetjen e reformës së politikave të punësimit dhe Projekt për Arsimin dhe formimin profesional 2020-2022, Program Veprimi IPA 2015 për Shqipërinë.

[2] Shqipëria i raporton Eurostat-it tp dhëna të ndara për 3 rajone statistikore niveli 2 (Veri, Qendër dhe Jug) dhe 12 rajone niveli 3, e gjeni në: Maps - Eurostat (europa.eu)

dispozicion nuk lejojnë një karakterizim më të saktë të këtij grupi. Ato përfaqësojnë rreth 4% të totalit (7191). Është një grup i vogël që ka nevojë për mbështetje shumë specifike.

3. NEET të tjerë joaktivë: përfaqësojnë kategorinë më të madhe të të rinjve joaktivë. Një nga prioritetet kryesore për një strategji zbatimi efektive është karakterizimi i këtij grupi. Ai përfshin të rinjtë joaktivë që nuk kanë marrë arsim dhe trajnim në katër muajt e fundit. Supozohet se këta janë të rinj ende jo aktivë në tregun e punës, por ka mungesë informacioni për t'i karakterizuar më mirë. Strategjia e regjistrimit të të rinjve NEET që do të zhvillohet nën PZGR mund të adresojë këtë mungesë të të dhënave. Grupi përfaqëson rreth 29% të totalit (53,848). Hapi i parë në përmbushjen e nevojave të këtyre NEET-ve është arritja, identifikimi dhe regjistrimi i tyre dhe më pas të kuptuarit më mirë të profilit dhe arsyeve të tyre për të qenë NEET.

4. Të rinj NEET, të papunë afatgjatë: këta janë të rinj të papunë që kanë qenë të papunë për më shumë se 12 muaj, me një përqindje më të lartë të niveleve arsimore më të ulëta dhe më të larta sesa mes të rinjve aktivë. Ata janë kryesisht meshkuj, janë më të moshuar dhe shfaqin një mospërputhje më të madhe ndërmjet profileve të tyre të aftësive dhe pritshmërive profesionale krahasuar me dinamikën e kërkesës së tregut të punës. Ato përfaqësojnë rreth 20% të totalit (37.623). Për të promovuar punësueshmërinë e këtyre NEET, zhvillimi i aftësive sociale dhe transversale duhet të kombinohet me ato profesionale. Të rinjtë e këtij grupi mund të kenë nevojë për përgatitje më të gjatë përpara se të hyjnë në skemën e Garancisë Rinore.

5. NEET aktivë: janë të rinj të papunë që janë ende në kërkim aktiv të një pune; kanë më pak se një vit të papunë; ata janë mesatarisht të arsimuar më mirë dhe kanë kryesisht një nivel arsimor mesatar. Vështirësia e tyre kryesore qëndron në pengesat ekzistuese për tranzicionin në tregun e punës. Këto pengesa mund të rezultojnë nga mungesa e mundësive të punësimit që kërkojnë aftësitë e këtyre të rinjve dhe/ose mospërputhja midis aftësive të tyre dhe dinamikës së kërkesës dhe mundësive në tregun e punës. Ata përfaqësojnë rreth 15% të totalit (27.061). Strategjitë e (ri) aftësimit duhet të jenë në thelb të strategjisë për të përmbushur nevojat e këtyre NEET.

Në analizën e kontekstit të SKPA 2023-2030, Shqipëria pranon se mekanizmi i tregut të punës në Shqipëri ka ende nevojë për përmirësime për sa i përket ndërmjetësimit efikas dhe gjithëpërfshirës dhe përputhjes më të mirë të ofertës dhe kërkesës për punë. Sipas **Anketës së Aftësive për Punësim dhe Produktivitet të Bankës Botërore, në vitin 2018**[1] rrugët joformale (kontaktet personale, rekomandimet nga të tjerët) ishin rrugët më të rëndësishme dhe më të përdorura për rekrutim. I njëjti raport theksoi se kompanitë e mëdha dhe kompanitë me pronësi të huaj janë më të prirura të përdorin rrugë joformale për punësimin e punonjësve. Mbizotërimi i rrugëve joformale dhe ofrimi i vendeve të punës për të punësuarit tashmë në biznese të tjera, tregojnë vështirësitë që hasin punëdhënësit në identifikimin e punonjësve me aftësitë e duhura, si dhe në gjetjen e punonjësve përmes rrugëve formale dhe shërbimeve profesionale.

I njëjti raport vlerëson se 7.4% e punëdhënësve të sektorit privat kanë përdorur shërbimet publike të punësimit për të rekrutuar staf. Po kështu, përdorimi i shërbimeve private të punësimit është gjithashtu i ulët (më pak se 10 përqind). Këto gjetje konfirmohen pjesërisht nga një sondazh i kryer nga **Këshilli Shqiptar i Investimeve** në vitin 2022[2], i cili zbuloi se vetëm 15% e 253 kompanive të anketuara përdorën zyrat e punësimit për të siguruar punëtorë. Nevojitet komunikim i vazhdueshëm nga shteti me sektorin privat, veçanërisht në nivele operacionale. Vlerësimi i Nevojave të Aftësive (VNA) është vetëm një nga kanalet e shumta dhe të ndryshme që shteti duhet të hapë. VNA është një metodologji standarde e miratuar që është realizuar në vitin 2017.

Përdorimi i shërbimeve të punësimit nga punëkërkuesit mbetet ende sfidë. Rreth 50% e të papunëve janë të regjistruar në SHPP. Në fund të vitit 2022, në zyrat e punësimit në shkallë vendi ishin 76,879 punëkërkues të papunë.

---

[1] Honorati, Maddalena; Johansson De Silva,Sara; Kupets,Olga; Inoue,Keiko; Kelmendi,Flora; Miyamoto,Koji; Santillana Farakos, Ana María; Valerio, Alexandra. *Western Balkans - Demand for skills in Albania : an analysis of the skills towards employment and productivity survey (English).* Washington, D.C. World Bank Group.

[2] Albanian Investment Council, Findings of the IC Survey 'On the workforce challenges', 2022. E gjeni në: https://www.investment.com.al/wp-content/uploads/2022/12/EN_AIC-Surveys-Findings-On-the-Workforce-Challenges-2022.pdf?fbclid=IwAR213ij_w50QDvVsXUeF0BhdCA2TlLv-_mrieqSUWpPROphV9CjyLER4_4k

Tabela 7

Papunësimi i regjistruar (numri mesatar) (Burimi: Të dhëna administrative AKPA)	2020	2021	2022	2023 (Jan-Shk)
Gjithsej punëkërkues të papunë	82.921	87.419	76.879	76.063
Femra	43.647	45.125	40.620	42.199
Pagesa e papunësisë	4.745	4.679	2.586	2.510
NEET 15-29 vjeç	18.561	20.155	17.598	18.225
Me ndihmë ekonomike	26.633	27.576	27.451	24.680
Punëkërkues të papunë afatgjatë	37.788	43.902	35.530	---
Nga komuniteti rom dhe egjiptian	7.570	7.671	7.198	7.039
Persona me aftësi të kufizuara	604	475	237	487
Imigrantët e kthyer	572	567	360	375

AKPA ka rikrijuar së fundmi **sistemin e profilizimit për punëkërkuesit e papunë të regjistruar dhe përgatitjen e Planit Individual të Punësimit (PIP), shoqëruar me një mjet të ri për qasjen e orientimit dhe këshillimit.** Megjithatë, vlera e PIP ende nuk është shfrytëzuar plotësisht, dhe procesi i përputhjes është ende kryesisht mekanik. PIP duhet të përdoret gjithashtu për planifikimin dhe buxhetimin përmes sistemit të TI-së të shërbimeve të punësimit, ku grupet kryesore të synuara janë punëkërkuesit e papunë, veçanërisht ata nga kategoritë vulnerabil. Ekziston gjithashtu nevoja për të krijuar kapacitete për të reduktuar ngarkesën e agjentëve të punësimit dhe për t'u mundësuar atyre që të kalojnë kohë të mjaftueshme me punëkërkuesit e regjistruar të papunë duke përdorur më shumë PIP, duke kuptuar nevojat dhe dobësitë e punëkërkuesve dhe duke iu përgjigjur nevojave të tyre me shërbime të përshtatura. Për më tepër, ekziston një nevojë e madhe për mekanizma të standardizuar referimi midis strukturave shtetërore dhe vendore për të mbështetur më mirë nevojat e punëkërkuesve të papunë të regjistruar. Ecuria e shërbimeve të punësimit në drejtim të ndërmjetësimit të drejtpërdrejtë në punë është përshkruar më poshtë.

Tabela 8

Numri i personave të punësuar përmes SHPP (Burimi: Të dhëna administrative AKPA)	2020	2021	2022	2023 (Jan-Shk)
Gjithsej	23.118	24.158	26.808	4963
Gra	13.531	11.677	13.044	2666
Kryefamiljarë	6.306	7.699	7.898	1479
Me pagesë papunësie	2.728	2.212	893	48
Me ndihmë ekonomike	1.374	972	1.785	376
Punëkërkues të papunë afatgjatë	2.636	2.974	4.152	---
Nga komuniteti rom dhe egjiptian	738	513	497	136
Persona me aftësi të kufizuara	50	32	18	13
Imigrantët e kthyer	67	28	2	21

Instrumenti kryesor për të adresuar disbalancat në tregun shqiptar të punës janë MATP. MATP janë krijuar nga MEKI, më parë MFE, dhe zbatohen nga AKPA. Portofoli i MATP të miratuara përfshin gjashtë lloje të ndryshme të MATP. Kohët e fundit, në maj 2023, u miratua nga Këshilli i Ministrave një MATP e re për praktikën. Për zbatimin e programeve të planifikuara të MATP sigurohen çdo vit rreth 4.5 milionë Euro, me një rritje në vitin 2022 prej 1 milionë Eurosh për zbatimin e projektit pilot Garancia Rinore. Burimet e financimit përfshijnë vetëm buxhetin e AKPA-s. Pjesa më e madhe e buxhetit të AKPA-s ndahet për përfitimin e papunësisë (rreth dy herë më shumë se në programet aktive të tregut të punës).

Tabela 9

Numri i pjesëmarrësve sipas llojit të Programit të Nxitjes së Punësimit (Burimi: Të dhëna administrative AKPA)	2020	2021	2022	2023 (Jan-Shk)
VKM 17 (punësimi i subvencionuar, trajnimi në detyrë, praktikat)	1.105	1.896	1.790	807
VKM 535 (Punësimi në komunitet)	0	207	1.267	995
VKM 348 (Vetë-punësimi)	0	44	286	235
VKM 608 (Punësimi gjatë COVID)	1.722	2.687	1.001	184
VKM e vjetër (e përfunduar në 2020)	1.319	0	0	0
Gjithsej	4.146	4.834	4.344	2.221

Kohët e fundit, një vlerësim i procesit të PNP-ve i kryer nga UNDP-ja (që do të publikohet) zbuloi se portofoli i sapo miratuar i PNP-ve (të gjitha të miratuara pas vitit 2020) është pritur shumë mirë nga këshilltarët e punësimit dhe ofron fleksibilitet si për punëdhënësit ashtu edhe për punëkërkuesit. Për më tepër, punëkërkuesi i papunë është tashmë në fokus të programeve të rikrijuara, por ky ndryshim nuk ka qenë i lehtë dhe zbatimi i procesit të rikrijimit të PNP-ve është ende në fazat fillestare. Prandaj, ekziston ende nevoja për shënjestrim specifik dhe mekanizma të shënjestrimit për t'u fokusuar te punëkërkuesit e papunë dhe për të zbatuar aktivitete informuese për punëkërkuesit e papunë.

Ekziston një nevojë e shtuar për të ofruar MATP dhe shërbime punësimi në bashkëpunim me aktorë jopublikë dhe ofrues të tjerë të shërbimeve publike në bashki. Zhvillimi dhe realizimi i këtyre mekanizmave kërkon përpjekje të mirëkoordinuara, që shkojnë përtej memorandumeve të nënshkruara.

AKPA po ndjek një politikë 'dixhitali i pari', që lejon Zyrat e Punësimit të fokusohen në ofrimin e shërbimeve për grupet më sfiduese të klientëve dhe për këtë qëllim po punon drejt dixhitalizimit të të gjitha shërbimeve të saj për punëkërkuesit dhe punëdhënësit, duke përdorur Sistemin e Shërbimit të Punësimit (SSHP). SSHP u rikrijua plotësisht në vitin 2020 dhe tashmë është plotësisht funksional në të 40 zyrat e punësimit në vend. Shërbimet e regjistrimit dhe procesi i profilizimit janë thjeshtuar duke pasur parasysh se një informacion i konsiderueshëm plotësohet automatikisht duke komunikuar në kohë reale me baza të ndryshme të dhënash të tjera, si: gjendja civile, administrata tatimore, ndihma ekonomike, etj. Qasja e orientimit dhe këshillimit për menaxhimin e rastit dhe fazat e progresit janë zbatuar në sistem.

Qasjet shumëdimensionale dhe modelet shtesë të ofrimit të shërbimeve janë duke u zhvilluar. Kohët e fundit, fokusi është zhvendosur gjithashtu në përdorimin e partneriteteve lokale për të mundësuar ofrimin e shërbimeve të punësimit në më shumë vendndodhje. Shërbimet e punësimit online ofrohen aktualisht nëpërmjet platformës online puna.gov.al. Shërbimet përfshijnë regjistrimin, përgatitjen e CV-së, aplikimet për vende të lira pune etj. Shërbime të tjera online u ofrohen punëdhënësve nëpërmjet portalit e-Albania. Shumë punëkërkues të rinj janë regjistruar përmes platformës online dhe po përdorin shërbimet online. Shërbimet e lëvizshme janë vendosur gjithashtu kohët e fundit.

Gjithashtu AKPA ka krijuar dhe testuar së fundmi një veçori të re të shërbimit të punësimit në internet, që përdor përmbajtje të krijuar nga inteligjenca artificiale (AI) për të përgatitur CV-të dhe për të ofruar këshilla për karrierë/punësim për punëkërkuesit. AKPA po punon gjithashtu për zhvillimin e modulit të Formimit Profesional, i cili do të lidhet gjithashtu me SSHP. Zhvillime të mëtejshme po ndodhin për të përmirësuar përputhjen automatike të punëkërkuesve me vendet e punës. Modalitetet e Planit Individual të Punësimit gjithashtu mund të rikonceptohen, pasi ai nuk përdoret gjithmonë në mënyrë optimale nga këshilltarët dhe duhet të plotësohet me më shumë të dhëna.

Pikat e forta	Pikat e dobëta
• Politika e Punësimit ka një kuadër strategjik, ligjor dhe operacionale të zhvilluar dhe të miratuar dhe është e përditësuar me udhëzimet e BE-së. • Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023-2030 u miratua në mars 2023 (cikli i dytë i reformës në sektor pas 2014-2022) • Shërbimi Publik i Punësimit ka 41 zyra vendore dhe pika shërbimi, me koordinim ndërinstitucional në të gjitha nivelet. • Një gamë e gjerë PNP-sh janë krijuar, të reformuara plotësisht në vitin 2019.	• Mungesa e informacionit dhe analizës së thellë mbi statusin aktual të NEET-ve në Shqipëri. • Shkëmbim i pamjaftueshëm ndërmjet aktorëve të tregut të punës dhe Shërbimit Publik të Punësimit. • Mangësitë në akses dhe cilësi në ofrimin e shërbimeve të punësimit bazuar në nevojat individuale të punëkërkuesve. • Buxheti i PNP-ve mbulon vetëm 6% (me përjashtim të trajnimeve të ofruara nga QFP-të) të punëkërkuesve të regjistruar dhe ka sfida në përthithjen financiare. • Njohuri të kufizuara mbi tregun e punës dhe mjetet e orientimit në karrierë
Mundësitë	Kërcënimet
• Garancia Rinore është një mundësi për të përmirësuar Shërbimin Publik të Punësimit.	• Vetëm 17,000 NEET janë të regjistruar si punëkërkues të papunë.

• Kushtet e punës po përmirësohen dhe po zhvillohen politika të reja pagash. • Mundësi për të përdorur shërbimet inovative online të prezantuara së fundmi nga AKPA për një angazhim më efektiv të të rinjve.	• Ndryshime të larta rajonale në rezultatet e tregut të punës për NEET. • Stereotipet, paragjykimet dhe diskriminimi janë barriera për integrimin efektiv të grupeve vulnerabil.

Fusha e mbështetjes 2: Arsimi dhe formimi profesional i të rinjve

Shqipëria po përballet aktualisht me dy sfida të mëdha që lidhen me mospërputhjen e aftësive, të cilat i referohen boshllëqeve dhe disbalancave të aftësive në tregun e punës për shkak të nivelit të kualifikimit apo aftësive. Sfida e parë është niveli i ulët i aftësive të popullsisë në moshë pune në tregun shqiptar të punës. Sipas Anketës së Fuqisë Punëtore 2021, 41,6% e fuqisë punëtore dhe 48,3% e popullsisë në moshë pune në Shqipëri kanë arsim bazë (arsim 8–9-vjeçar) ose më pak. Kjo është më e lartë se mesatarja për vendet e Ballkanit Perëndimor, e cila është 31%. Gjithashtu, segmente të caktuara të shoqërisë shqiptare, si 45.28% e punëkërkuesve të papunë romë dhe 13.9% e punëkërkuesve të papunë egjiptianë të regjistruar në zyrat e punësimit, nuk kanë përfunduar arsimin fillor. Për më tepër, shumica e përfituesve të ndihmës ekonomike kanë përfunduar vetëm arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar.

Sfida e dytë me të cilën përballet Shqipëria ka të bëjë me zotërimin e aftësive të nevojshme në tregun e punës, pasi mungesa e këtyre aftësive mund të pengojë krijimin e më shumë vendeve të punës dhe më cilësore. Një studim i fundit nga Fondacioni Evropian i Trajnimit (ETF)[1] mbi aftësitë në vendet partnere të ETF u përpoq të masë mospërputhjen e aftësive vertikale dhe horizontale. Sipas studimit, të paktën një në pesë të diplomuar universitar kishte një punë që kërkonte një nivel më të ulët të kualifikimeve formale, që ishte një tendencë në shumicën e vendeve partnere të ETF, përfshirë Shqipërinë. Në vitin 2019, rreth 40% e të punësuarve në Shqipëri ishin ose të mbiarsimuar ose të paarsimuar, gjë që është e ngjashme me situatën në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Të diplomuarit e universitetit kishin më shumë gjasa të ishin të mbikualifikuar sesa të diplomuarit e shkollave të mesme. Ndërkohë, pesha e mospërputhjes horizontale (mospërputhja mes fushës së studimeve dhe profesionit) ishte më shumë se 66% në vitin 2019, që ishte 6% më e lartë se mesatarja për vendet e Ballkanit Perëndimor.

Këto sfida që lidhen me mungesën e aftësive, apo mospërputhjen e tyre, lidhen me sasinë, cilësinë ose rëndësinë e pamjaftueshme të arsimit dhe trajnimit të ofruar. Një tregues i cilësisë së pamjaftueshme të sistemit arsimor të Shqipërisë janë rezultatet e PISA-s, të cilat tregojnë se të rinjtë shqiptarë të moshës 15 vjeç performojnë nën mesataren e OECD-së në lexim, matematikë dhe shkencë (PISA 2018). Pjesëmarrja e të rriturve (25-64 vjeç) në arsimin dhe trajnimin formal dhe joformal në vitin 2017 ishte 9.2 për qind, me një hendek të konsiderueshëm midis Shqipërisë dhe mesatares së BE-së, e cila ishte 43.7% për të njëjtin vit, sipas rezultatet e anketës për arsimin e të rriturve të kryer nga INSTAT në vitin 2017. Sipas AFP 2020 të kryer nga INSTAT, më pak se 1% e të rriturve të moshës 25-64 vjeç u angazhuan në një lloj aktiviteti të të mësuarit gjatë gjithë jetës në periudhën katër javë para anketës. E njëjta anketë tregon se 9.5% e femrave dhe 8.8% e meshkujve të moshës 25-64 vjeç kanë marrë pjesë në arsim dhe trajnim formal dhe joformal.

Mesatarisht, më pak se 15% e bizneseve kanë ofruar trajnime të brendshme ose në punë për fuqinë e tyre punëtore dhe më pak se 5% kanë ofruar trajnime të jashtme, sipas një sondazhi të kryer nga Banka Botërore[2]. Punëtorët potencialë zakonisht kanë mundësi të kufizuara për të mësuar në punë, gjë që nga ana tjetër kufizon zhvillimin e aftësive dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës së fuqisë punëtore dhe pengon rritjen e produktivitetit të ndërmarrjeve. I njëjti studim [3] tregon se gati 51% e ndërmarrjeve që janë përpjekur të punësojnë punëtorë në tre vitet e fundit janë përballur me vështirësi në punësim për shkak të mungesës së aftësive dhe përvojës në punë ose kërkesave të pamjaftueshme. Këto ndërmarrje

[1] ETF. Matja e mospërputhjes së aftësive në vendet partnere ETF. 2019, e gjeni në https://www.etf.europa.eu/sites/default/files/2019-05/Skills%20mismatch%20measurement_ETF%20partner%20countries.pdf

[2] Banka Botërore (2018). Demand for skills in Albania, an analysis of the skills towards employment and productivity survey, e gjeni në: https://documents1.worldbank.org/curated/en/262231529562176390/pdf/ALB-STEP-Report-Final-with-Cover-Page-June-15.pdf

[3] Ibid.

deklaruan se aplikantëve u mungonin aftësitë e nevojshme teknike dhe specifike të punës, si dhe aftësitë e nevojshme për të qenë efikas në punë, veçanërisht për profesionet që kërkojnë aftësi më të larta. Sektorët e ndërtimit, industrisë dhe turizmit janë veçanërisht të kufizuar kur punësojnë individë për punë me kualifikim të ulët dhe mesatar, ndërsa ndërmarrjet në agro-përpunim dhe industri janë më të kufizuara kur punësojnë punëtorë me kualifikim të lartë. Punëdhënësit gjithashtu perceptojnë se problemet që lidhen me aftësitë prekin kryesisht të rinjtë dhe ata që hyjnë në tregun e punës për herë të parë, duke nënvizuar rëndësinë e arsimit dhe sistemit cilësor të AFP-së.

Komiteti i Monitorimit Sektorial do të përfshijë përfaqësues nga partnerët në përputhje me Kodin Evropian të Sjelljes së Partneritetit [Rregullorja e deleguar e Komisionit (BE) Nr. 240/2014 e 7 janarit 2014 mbi kodin Evropian të sjelljes për partneritetin në kuadrin e Fondeve Evropiane Strukturore dhe të Investimeve] në bazë të metodologjisë për zbatimin e parimit të partneritetit dhe përzgjedhjes së partnerëve të zhvilluar për Programet Operacionale 2024-2027 në Republikën e Shqipërisë në kuadër të IPA III.

Partneriteti për Programin Operacional përbëhet nga përfaqësuesit:

- Autoritetet publike përkatëse duke përfshirë përfaqësuesit rajonal dhe kombëtar të bashkive
- Autoritetet publike kombëtare përgjegjëse për zbatimin e parimeve horizontale
- Partnerët ekonomikë dhe socialë
- Organet përfaqësuese të shoqërisë civile

Sipas rastit, organizatat ombrellë u përfshinë në partneritet.

Autoriteti Menaxhues do të veprojë si Sekretariat për Komitetin e Monitorimit Sektorial të PO.

Pjesëmarrja aktive dhe domethënëse e palëve të interesuara do të sigurohet nëpërmjet:

- Kanaleve për angazhimin e palëve të interesuara të identifikuara sipas fushës së mbështetjes dhe sipas rastit të ë zyrtarizuara.
- Pjesëmarrjes së palëve të interesuara në Komitetet e Monitorimit.
- Pjesëmarrjes së palëve të interesuara në vizitat në terren.
- Sigurimit të rregullt të informacionit për palët e interesuara.
- Në rast të investimit të lokalizuar, do të përfshihen përfituesit vendorë.

Për sa i përket **mekanizmave të llogaridhënies**, do të krijohet Mekanizmi i korrigjimit të ankesave (nëse nuk është krijuar tashmë) dhe do të ofrojë informacion mbi:

- Aksesueshmërinë e kanaleve për të paraqitur ankesa.
- Publikimin e mekanizmit të ankesave.
- Mënyrën e trajtimit të çdo ankese.
- Monitorimin e rasteve dhe efektivitetin e mekanizmit të zgjidhjes së ankesave.
- Mbështetjen e funksionimit të mekanizmave të zgjidhjes së ankesave.

Ekziston një mekanizëm për monitorimin dhe raportimin mbi objektivat gjinore. Statistikat e ndara sipas gjinisë do të mblidhen në kuadër të aktiviteteve ku kjo është e mundur.

Në bazë të raporteve të dhëna nga Autoriteti Menaxhues përpara mbledhjeve, ai në veçanti:

- vlerëson efektivitetin, efikasitetin, cilësinë, koordinimin dhe përputhshmërinë e zbatimit të programeve.
- vlerëson progresin drejt përmbushjes së objektivave, arritjes së produkteve dhe rezultateve të planifikuara, dhe vlerësimit të ndikimit dhe qëndrueshmërisë së asistencës IPA III, duke siguruar koherencë me dialogun e politikave, strategjitë përkatëse të sektorit qendror dhe rajonal ose aktivitetet rajonale dhe shumë-palëshe në Përfituesin IPA III.
- vlerëson raportet vjetore të zbatimit, duke përfshirë ekzekutimin financiar të programeve.

- shqyrton gjetjet dhe konkluzionet përkatëse, si dhe propozimet për masat vijuese korrigjuese që rrjedhin nga kontrollet, monitorimi, vlerësimet dhe auditimet në vend, nëse ka.
- diskuton çdo aspekt përkatës të funksionimit të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit.
- diskuton për çdo çështje dhe veprim problematik.
- nëse është e nevojshme, vlerëson ose bën propozime për të ndryshuar programet dhe për të ndërmarrë çdo veprim tjetër korrigjues për të garantuar arritjen e objektivave dhe për të rritur efikasitetin, efektivitetin, ndikimin dhe qëndrueshmërinë e asistencës IPA III.
- vlerëson masat e marra të informimit, publicitetit, transparencës, komunikimit dhe vizibilitetit.

8.2. Vlerësimi

Duke pasur parasysh rëndësinë e programit, do të kryhet një vlerësim afatmesëm dhe përfundimtar për fushat e mbështetjes që përfshihen në këtë Program Operacional të kontraktuar nga përfituesi i IPA III dhe duhet të përfshihet në fushën e mbështetjes "Mbështetje tjetër". siç tregohet në pjesën 4.2.2.

Vlerësimi do të kryhet nga ekspertë ose organe, të brendshme ose të jashtme, funksionalisht të pavarura nga sistemi i menaxhimit dhe kontrollit.

Vlerësimi afatmesëm do të kryhet veçanërisht në lidhje me modelin e Ofrimit të Garancisë Rinore, në funksion të treguesve EMCO dhe në funksion të ofrimit për të rinjtë NEET të një oferte cilësore punësimi, trajnimi ose arsimimi brenda 4 muajve nga identifikimi. Ai gjithashtu do të shqyrtojë shtrirjen, efektivitetin dhe cilësinë e aktiviteteve informuese të zbatuara nga organizatat rinore, duke përfshirë metodat e përdorura, angazhimin e grupeve të synuara dhe rezultatet e arritura.

Vlerësimi përfundimtar do të kryhet për qëllime të llogaridhënies dhe mësimore në nivele të ndryshme, sidomos për vlerësimin e politikave, veçanërisht duke marrë parasysh faktin se PO synon të arrijë rritjen e punësueshmërisë dhe integrimin e NEET në tregun e punës, duke rritur të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe duke arritur qëndrueshmërinë dhe shkallëzimin e rezultateve

Raporti i vlerësimit do të ndahet me të gjitha palët përkatëse. Përfituesi i IPA III dhe Komisioni do të analizojnë konkluzionet dhe rekomandimet e vlerësimeve dhe do të vendosin së bashku mbi masat vijuese që do të ndërmerren dhe çdo rregullim të nevojshëm, duke përfshirë, nëse tregohet, riorientimin e mbështetjes.

Afati kohor tregues për vlerësimet afatmesme dhe përfundimtare:

Vlerësimi afatmesëm do të kryhet në vitin 2027.

Vlerësimi përfundimtar do të bëhet në vitin 2030.

8.3. Auditi dhe verifikimet

Auditimet teknike për projektet madhore janë të detyrueshme gjatë zbatimit.

Dispozitat financiare në lidhje me auditimin dhe verifikimet, duke përfshirë auditimet teknike nëse aplikohen, të kryera nga Përfituesi IPA III duhet të përfshihen në fushën e mbështetjes "Mbështetje tjetër", siç tregohet në pjesën 4.2.2.

Pa cenuar detyrimet e zbatueshme për kontratat e lidhura për zbatimin e këtij programi, Komisioni, në bazë të një vlerësimi risku, mund të kontraktojë detyra të pavarura auditimi ose verifikimi për një ose disa kontrata ose marrëveshje.

9 Komunikimi strategjik dhe diplomacia publike

Të gjitha subjektet që zbatojnë veprime të jashtme të financuara nga BE-ja kanë detyrimin kontraktual të informojnë grupet përkatëse për mbështetjen e Bashkimit për punën e tyre duke treguar logon e BE-së dhe një deklaratë të shkurtër financimi sipas rastit në të gjitha materialet e komunikimit që lidhen me projektet në fjalë. Për këtë qëllim, ata duhet të zbatojnë udhëzimet e dhëna në dokumentin udhëzues 2022 *Komunikimi dhe rritja e vizibilitetit të BE-së:Udhëzues për veprimet e jashtme* (ose ndonjë dokument pasues).

Në veçanti, përfituesit e fondeve të BE-së duhet të njohin origjinën e financimit të BE-së dhe të sigurojnë fizibilitetin e duhur të tij duke:

- dhënë një deklaratë që thekson mbështetjen e marrë nga BE-ja në mënyrë të dukshme për të gjitha dokumentet dhe materialin e komunikimit në lidhje me zbatimin e fondeve, duke përfshirë në faqen zyrtare të internetit dhe llogaritë e mediave sociale, ku këto ekzistojnë; dhe

- promovuar veprimet dhe rezultatet e tyre me anë të informacionit të synuar koherent, efektiv dhe proporcional për audienca të shumta, përfshirë median.

Masat e vizibilitetit dhe komunikimit do të zbatohen, sipas rastit, nga subjektet e besuara të administratës kombëtare, kontraktorët dhe përfituesit e granteve. Detyrimet e duhura kontraktuale do të përfshihen, përkatësisht, në marrëveshjet e financimit, marrëveshjet e delegimit dhe kontratat e prokurimit dhe grantit.

Masat specifike të vizibilitetit dhe komunikimit për këtë program do të jenë plotësuese të aktiviteteve më të gjera të komunikimit të zbatuara drejtpërdrejt nga shërbimet e Komisionit Evropian dhe/ose Delegacionet dhe Zyrat e BE-së. Komisioni Evropian dhe Delegacionet dhe Zyrat e BE-së duhet të informohen plotësisht për planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve specifike të vizibilitetit dhe komunikimit, veçanërisht në lidhje me narrativën e komunikimit dhe mesazhet kryesore.

Një plan strategjik komunikimi i Programit Operacional do të përgatitet dhe do të miratohet me Delegacionin e BE-së në përputhje me Udhëzimet e Komisionit për veprimet e jashtme për Komunikimin dhe rritjen e vizibilitetit të BE-së. Ai do të përcaktojë përgjegjësitë e organeve zbatuese të Programit Operacional dhe NIPAC për sa i përket komunikimit.

Plani strategjik i komunikimit i Programit Operacional do të identifikojë mesazhet kryesore, objektivat e komunikimit, audiencat e komunikimit (përfshirë shumëfishuesit), qasjen, aktivitetet e parashikuara të komunikimit, treguesit dhe objektivat kyçe të komunikimit treguesit dhe objektivat e komunikimit kyç RACER, risqet dhe buxhetin e parashikuar. Planet vjetore të komunikimit do të hartohen dhe diskutohen me Delegacionin e BE-së paraprakisht për të koordinuar aktivitetet dhe për të maksimizuar shtrirjen.

NIPAC dhe Autoriteti Menaxhues do të jenë përgjegjës për angazhimin e shtypit dhe menaxhimin e kontakteve me shtypin dhe median.

Në përputhje me planin strategjik të komunikimit të Programit Operacional, do të krijohet një faqe interneti e dedikuar dhe kanale të mediave sociale. Standardet për përdorimin dhe menaxhimin e mediave sociale dhe plani i mediave sociale do të koordinohen ndërmjet organeve zbatuese dhe NIPAC.

10 Qendrueshmëria

Qëndrueshmëria në nivel programi.

Programi Operacional është hartuar për të siguruar qëndrueshmërinë e përfitimeve/rezultateve të arritura përtej zbatimit të tij. Faktorët kryesorë që ndikojnë në qëndrueshmëri janë niveli i pronësisë së përfituesve fundorë, kapacitetet e tyre institucionale dhe operacionale dhe burimet e tyre financiare dhe njerëzore për funksionimin dhe mirëmbajtjen e rezultateve. Autoriteti Menaxhues do të krijojë një sistem për të monitoruar qëndrueshmërinë e asistencës në kuadër të Programit Operacional gjatë periudhës së qëndrueshmërisë të përcaktuar si periudha ndërmjet përfundimit të periudhës së zbatimit të një veprimi dhe datës përfundimtare për zbatimin e Marrëveshjes përkatëse të Financimit. NIPAC dhe Autoriteti Menaxhues do të monitorojnë qëndrueshmërinë brenda fushës së tyre përkatëse të përgjegjësisë përmes Komitetit të Monitorimit Sektorial (FFPA neni 53(4)(b)) dhe së bashku me Komisionin brenda Komitetit të Monitorimit të IPA (FFPA neni 52(3)). Vlerësimi i qëndrueshmërisë së PO do të jetë një pikë standarde e rendit të ditës në mbledhjet e Komitetit të Monitorimit Sektorial/PO dhe do të përfshihet në vlerësimet e PO-së.

Qëndrueshmëria e Operacioneve.

Përfituesit përfundimtarë duhet të garantojnë që kontratat të zbatohen në përputhje me objektivat e përcaktuara për projektet/kontratat dhe që rezultatet të maten duke përdorur treguesit e zbatueshëm për projektet/kontratat siç përcaktohen në dokumentet përkatëse. Për të siguruar që rezultatet e krijuara nga projektet/kontratat e financuara në kuadër të Programit Operacional të

zgjasin pas përfundimit të periudhës së zbatimit të projekteve/kontratave, Autoriteti Menaxhues së bashku me Organin e Ndërmjetëm për Menaxhimin e Politikave dhe Organin e Ndërmjetëm për Menaxhimin Financiar, do të vendosë kushtet e qëndrueshmërisë të zbatueshme për rezultatet e prekshme dhe jomateriale sipas rastit.

Në rastin e punëve dhe furnizimeve të kontraktuara drejtpërdrejt, do të krijohen mekanizma bashkëpunimi midis Autoritetit Menaxhues dhe përfituesve përfundimtarë për planifikimin dhe zbatimin e veprimeve të parashikuara, si dhe përgjegjësitë e përfituesve përfundimtarë për të siguruar qëndrueshmërinë e asistencës IPA III. Kalimi i pronësisë do të vendoset në një marrëveshje formale e cila gjithashtu do të sigurojë angazhimin e tyre për të siguruar burimet financiare dhe njerëzore për funksionimin dhe mirëmbajtjen e rezultateve pas përfundimit. Në rastin e organeve publike, qëndrueshmëria e operacioneve të financuara do të sigurohet nëpërmjet përfshirjes në programin buxhetor afatmesëm. Në rastin e skemave të granteve, qëndrueshmëria do të jetë një parim udhëzues për përzgjedhjen e operacioneve. Kontrata e grantit do të përfshijë dispozita specifike për të garantuar qëndrueshmëri.

Autoriteti Menaxhues do të kryejë kontrolle të qëndrueshmërisë për operacionet e përfunduara në përputhje me procedurat e tij.

Përfituesit përfundimtarë janë të detyruar të garantojnë përdorimin e qëndrueshëm të rezultateve në përputhje me Programin Operacional, kontratën ose ekuivalentin. Përfituesit përfundimtarë janë të detyruar të ndajnë buxhet për të siguruar funksionimin dhe mirëmbajtjen e produkteve dhe të mbulojnë kostot e funksionimit dhe mirëmbajtjes së tyre. Marrësit përfundimtarë duhet t'i rikthejnë rezultatet në gjendjen e tyre fillestare në rast të dëmtimit të tyre ose të zëvendësojnë rezultatet me ato të cilësisë dhe funksionalitetit minimal të barabartë në rast të shkatërrimit të tyre.

Shkelja e kushteve për qëndrueshmëri mund të çojë në rimbursim të kontributit të BE-së, në rast se përfituesit përfundimtarë nuk marrin masat e nevojshme korrigjuese për eliminimin e mangësive të ndodhura.

Aneksi 1: Lista e palëve të interesuara që morën pjesë në takimet e konsultimit për Programin Operacional mbi BE-në për Punësimin e të Rinjve 2024-2027

Data: 8 qershor 2023

Ora: 9:30 paradite

Nr.	Emri	Mbiemri	Organizata
1.	Ana	Mullanji	Organizata Përtej Barrierave
2.	Mirsida	Skenderas	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
3.	Gerry	Mcweeney	OBSH
4.	Elsa	Dervishi	Forumi i Grave Elbasan
5.	Edisona	Xhani	Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim Shqipëri
6.	Mariza	Rama	Kongresi Rinor Kombëtar i Shqipërisë
7.	Ana	Zacharian	Albanian Skills
8.	Entela	Gjyla	Albanian Skills
9.	Alma	Uku	Caritas Albania
10.	Enkeleda	Ndoj	Caritas Albania
11.	Mirela	Arqimandriti	Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim
12.	Jehona	Varfi	SEKTRA
13.	Juliana	Hoxha	Partners Albania
14.	Besnik	Alku	Fondacioni Shqiptar për Zhvillimin e Kapaciteteve Lokale
15.	Lindita	Manga	Fondacioni Shqiptar për Zhvillimin e Kapaciteteve Lokale
16.	Myftar	Doçi	Qendra Kombëtare Burimore e Trajnimit dhe Asistencës Teknike
17.	Ariana	Haxhiu	Qendra Kombëtare Burimore e Trajnimit dhe Asistencës Teknike
18.	Andi	Allko	NAO OS Ministria e Financave dhe Ekonomisë
19.	Aisela	Beqiraga	OKB- FAO
20.	Dritan	Nelaj	Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë
21.	Juela	Shamku	Agjencia Kombëtare e Rinisë

22.	Lira	Spiro	Agjencia Kombëtare e Rinisë
23.	Genc	Myftiu	Agjencia për Zhvillimin e Qëndrueshëm Ekonomik
24.	Klaudio	Pulaha	Qendra për të Drejtat e Fëmijës Shqipëri
25.	Dritan	Ziu	Roma Active Shqipëri
26.	Aldiona	Gjikondi	Agjencia e Zhvillimit Ekonomik Lokal
27.	Nikolla	Pulla	Agjencia e Zhvillimit Ekonomik Lokal
28.	Uenda	Aruçi	Shoqata Ndërkombëtare për Solidaritet
29.	Roberta	Profka	Shoqata Ndërkombëtare për Solidaritet
30.	Manjola	Stefani	Sot për të Ardhmen
31.	Migena	Nako	Shoqata Ndërkombëtare për Solidaritet
32.	Lorena	Zajmi	Ministri i Shtetit për rininë dhe fëmijët
33	Eno	Ngjela	UNDP
34.	Mirlinda	Bushati	UNICEF
35.	Anita	Lushi	Rrjeti Shqiptar i Fuqizimit të Grave
36.	Renis	Meta	Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza
37.	Enkelejda	Kallçiu	Terre des hommes Shqipëri
38.	Besnik	Kadesha	Save the Children
39.	Endri	Teta	World Vision
40.	Etleva	Martiri	DBE
41.	Edison	Hoxha	Qendra për të Drejtat e Punës
42.	Ilir	Xhemalaj	Sindikata Kombëtare e Operatorëve Telefonikë
43.	Sajmira	Kopani	ILO

Aneksi 2: Lista e akronimeve

AFD	Agjencia Franceze e Zhvillimit
AI	Inteligjenca Artificiale
LEK	Leku shqiptar
MATP	Masat Aktive të Tregut të Punës
KSHK	Korniza Shqiptare e Kualifikimeve
BMZ	Ministria Federale e Gjermanisë për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Zhvillimin
CFCU	Njësia Qendrore e Kontraktimit dhe Financimit
OSHC	Organizata e Shoqërisë Civile
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
NJZH	Njësi Zhvillimi
ECEC	Edukimi dhe kujdesi në fëmijërinë e hershme
PEI	Plani Ekonomik dhe i Investimeve për Ballkanin Perëndimor dhe Axhenda e Gjelbër
EMCO	Kuadri i Treguesve për Komitetin e Punësimit
EMIS	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit për Arsimin
ZP	Zyrë Punësimi
PNP	Programe të Nxitjes së Punësimit
KEK	Korniza Evropiane e Kualifikimeve
PRE	Programi i Reformës Ekonomike
ESCO	Aftësitë, Kompetencat, Kualifikimet dhe Profesionet Evropiane
FSE	Fondi Social Evropian
FET	Fondacioni Evropian i Trajnimeve
BE	Bashkimi Evropian
EURES	Shërbimi Evropian i Punësimit
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
GIZ	Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
QSH	Qeveria e Shqipërisë
SMIAL	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Arsimit të Lartë
ONMP	Organi i Ndërmjetëm për Menaxhimin e Politikave
ONMF	Organi i Ndërmjetëm për Menaxhimin Financiar
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
PIP	Plani Individual i Punësimit.
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
INSTAT	Instituti i Statistikave i Republikës së Shqipërisë
IPA	Instrumenti për Ndihmë Para-Aderimit

GMPI	Grupi për Menaxhimin e Politikave të Integruara
IPS	Sistem i integruar planifikimi
ISCO	Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Profesioneve
Anketa e Fuqisë Punëtore	Anketa e Fuqisë Punëtore
LGBTIQ	Lezbike, homoseksualë, biseksualë, transgjinorë, interseks dhe queer
LLL	Të mësuarit gjatë gjithë jetës
OITP	Observatori i Informacionit të Tregut të Punës
AM	Autoriteti menaxhues
MEKI	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Novacionit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MSHMS	Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
AKPA	Agjencia Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë
AKAFPK	Agjencia Kombëtare për Arsimin dhe Formimin Profesional
AKR	Agjencia Kombëtare për Rininë
NEET	Jo në punësim, arsim ose trajnim
SKPA	Strategjia Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë
SKA	Strategjia Kombëtare për Arsimin
OJQ	Organizatë jo-qeveritare
KKP	Këshilli Kombëtar i Punës
SKZHIE	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian
SKMS	Strategjia Kombëtare për Mbrojtje Sociale
KKAFP	Këshilli Kombëtar i Arsimit dhe Formimit Profesional
SKR	Strategjia Kombëtare për Rininë
OECD	Organizata për Zhvillim dhe Bashkëpunim
PO	Program Operacional
SHSHP	Shërbimi Shtetëror i Punësimit
PISA	Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Studentëve
SMIP	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar
RCF	Fondi Rajonal i Sfidës
RPL	Njohja e të nxënit të mëparshëm
SASPAC	Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës
SDC	Bashkëpunimi zvicerian për zhvillim
OZHQ	Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm
SSHP	Sistemi i Shërbimit të Punësimit
AANJ	Anketa e të ardhurave dhe nivelit të jetesës
VNA	Vlerësimi i Nevojave të Aftësive
KSA	Komiteti Sektorial i Aftësive
STEM	Shkencë, Teknologji, Inxhinieri, Matematikë
SWOT	Pikat e forta, Pikat e dobëta, Mundësitë dhe Kërcënimet
AT	Asistencë Teknike
UK	Mbretëri e Bashkuar
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNICEF	Fondi i OKB-së për Fëmijët
AFP	Arsimi dhe formimi profesional
QFP	Qendra të formimit profesional
WBL	Nxënia në punë
GR	Garancia Rinore
PZGR	Plani i zbatimit të Garancisë Rinore

ANEKSI II - KUSHTE TË PËRGJITHSHME

Përmbajtja

Pjesa e parë: Dispozitat e zbatueshme për Aktivitetet për të cilat Përfituesi i IPA III është Autoriteti Kontraktues sipas IMBC-së

Neni 1- Parime të përgjithshme
Neni 2- Shpallja e kontratave fituese të prokurimit dhe grantit
Neni 2a - Përjashtimi dhe masat administrative
Neni 3 - Komunikimi dhe vizibiliteti
Neni 4 – Kontrollet ex-ante dhe ex-post për procedurat e granteve dhe prokurimit dhe kontrollet ex-post për kontratat dhe grantet që do të kryhen nga Komisioni
Neni 5 - Llogaritë bankare, sistemet e kontabilitetiti dhe shpenzimet e pranuara
Neni 6 - Dispozitat mbi pagesat e bëra nga Komisioni për përfituesin e IPA III
Neni 7 – Ndërprerja e pagesave 7
Neni 8 – Rikuperimi i fondeve 8
Neni 8a – Korrigjimet financiare dhe mbyllja
Neni 9 - Parimet e përgjithshme për përzgjedhjen e veprimeve
Neni 10 - Model për Dokumentet e Identifikimit të Veprimeve
Neni 11 - Projekti madhor dhe marrëveshja dypalëshe
Pjesa e dytë: Dispozitat e Zbatueshme për këtë Marrëveshje Financimi në tërësi, pavarësisht nga mënyra e menaxhimit
Neni 12- Periudha e pranueshmërisë
Neni 13- Lejet dhe autorizimi
Neni 14- Kërkesat e raportimit
Neni 15- Të drejtat e pronësisë intelektuale
Neni 16 – Konsultimi ndërmjet përfituesit IPA III dhe Komisionit
Neni 17 – Ndryshimi i Marrëveshjes së Financimit
Neni 18 – Pezullimi i kësaj Marrëveshjeje Financimi
Neni 19 – Ndërprerja e kësaj Marrëveshjeje Financimi
Neni 20 - Ligji i zbatueshëm, zgjidhja e mosmarrëveshjeve
Neni 21 – Masat kufizuese të BE-së 15

Pjesa e parë: Dispozitat e zbatueshme të Aktiviteteve për të cilat Përfituesi i IPA III është Autoriteti Kontraktues sipas IMBC-së

Neni 1
Parime të përgjithshme

1. Qëllimi i Pjesës së Parë është caktimi i rregullave për realizimin e detyrave të besuara për zbatimin e buxhetit të parashikuara në Aneksin I dhe caktimi i të drejtave dhe detyrimeve përkatësisht të përfituesit të IPA III dhe Komisionit në kryerjen e këtyre detyrave.

Pjesa e Parë do të zbatohet për detyrat e realizimit të buxhetit që i besohen përfituesit të IPA III vetëm në lidhje me kontributet e Bashkimit, ose të kombinuara me fondet e përfituesit të IPA III apo të një pale të tretë, në rast se këto fonde zbatohen në një bashkëfinancim.

2. Përfituesi IPA III mbetet përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë Marrëveshje Financimi dhe në Marrëveshjen Kuadër të Partneritetit Financiar (FFPA). Në përputhje me nenin 7, nenin 18, nenin 19 dhe nenin 21, Komisioni rezervon të drejtën të ndërpresë pagesat, dhe të pezullojë dhe/ose përfundojë këtë Marrëveshje Financimi.

3. Përfituesi i IPA III duhet të respektojë normën minimale të kontributeve të tij të përcaktuara në Aneksin I. Në rastin kur kontributet jepen si nga përfituesi i IPA III edhe nga Bashkimi EvropianEvropian, kontributi i përfituesit të IPA III do të vihet në dispozicion të paktën në fund të periudhës së pranueshmërisë së programit.

4. Masa e kontributit të BE-së e specifikuar në Aneksin I dhe shuma maksimale e ndihmës IPA III bazohet në shumën e shpenzimeve publike të pranueshme. Shpenzim publik i pranueshëm është çdo kontribut publik për financimin e operacioneve, burimi i të cilit është buxheti i autoriteteve publike kombëtare, rajonale ose vendore të përfituesit të IPA III, buxheti i Bashkimit,

buxheti i organeve të së drejtës publike ose buxheti i shoqatave të autoriteteve publike ose të organeve të së drejtës publike. Financimi i kredisë, aty ku përdoret, i jepet organit përgjegjës për të shlyer kredinë, publik kombëtar ose privat kombëtar. Shpenzimet private kombëtare nuk mund të konsiderohen si shpenzime të pranueshme.

5. Për qëllim të zbatimit të nenit 25 të FFPA për mbrojtjen e të dhënave, të dhënat personale:

- përpunohen në mënyrë të ligjshme, të drejtë dhe transparente në lidhje me subjektin e të dhënave;
- mblidhen për qëllime të përcaktuara, të qarta dhe legjitime dhe nuk përpunohen më tej në një mënyrë që është e papajtueshme me ato qëllime;
- janë të përshtatshme, relevante dhe të kufizuara në çka është e nevojshme në lidhje me qëllimet për të cilat përpunohen;
- janë të sakta dhe, kur është e nevojshme, përditësohen;
- përpunohen në një mënyrë që garanton sigurinë e duhur të të dhënave personale dhe
- mbahen në një formë që lejon identifikimin e subjekteve të të dhënave për jo më shumë sesa është e nevojshme për qëllimet për të cilat përpunohen të dhënat personale.

Të dhënat personale të përfshira në dokumentet që duhen mbajtur nga përfituesi i IPA III, në përputhje me paragrafin 2 të nenit 2, duhet të fshihen pasi të kenë mbaruar afatet e përcaktuara në atë paragraf.

Neni 2

Shpallja e kontratave fituese të prokurimit dhe grantit

1. Pa. cenuar nenin 18(5) të FFPA, detyrat e referuara në paragrafin 1 të nenit 1 kryhen nga përfituesi i IPA III në përputhje me procedurat dhe dokumentet standarde të përcaktuara dhe të publikuara nga Komisioni për shpalljen e kontratave fituese të prokurimit dhe grantit në veprimet e jashtme, veçanërisht udhëzuesi praktik për procedurat e kontratave për veprimin e jashtëm të Bashkimit Evropian (PRAG), në fuqi në kohën e fillimit të procedurës në fjalë, si edhe në përputhje me standardet e kërkuara për vizibilitetin dhe komunikimin, të përmendura në Nenin 3(2).

Përfituesi i IPA III kryen procedurat e shpalljes fituese të kontratave të prokurimit dhe dhënies së granteve, lidh kontratat përkatëse, dhe garanton që të gjitha dokumentet përkatëse për gjurmën e auditit të jenë në gjuhën e kësaj Marrëveshjeje Financimi. Për qëllimin e Pjesës së Parë të kësaj Marrëveshjeje Financimi, çdo referencë për kontratat e grantit do të interpretohet gjithashtu si referencë për marrëveshjet e kontributit dhe çdo referencë për përfituesit e grantit do të interpretohet gjithashtu si organizata që kanë nënshkruar marrëveshje kontributi.

2. Pa cenuar nenin 49 të FFPA, përfituesi i IPA III do të mbajë të gjitha dokumentet përkatëse financiare dhe kontraktuale mbështetëse nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi ose nga një datë më e hershme në rast se procedura e prokurimit, thirrja për propozime ose procedura e drejtpërdrejtë e dhënies së grantit fillon përpara hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi, për pesë vjet nga data e mbylljes së një programi. Përfituesi i IPA III do të mbajë në veçanti, sa më poshtë:

a) Procedurat e prokurimit:

i) Njoftimin e parashikimit me dëshminë e publikimit të njoftimit të prokurimit dhe çdo korrigjim të gabimeve;

ii) Caktimin e panelit të listës përfundimtare;

iii) Raportin e listës përfundimtare (përfshirë anekset) dhe kërkesave;

iv) Dëshminë e publikimit të njoftimit të listës përfundimtare;

v) Shkresat për kandidatët që nuk bëjnë pjesë në listën përfundimtare;

vi) Ftesën për tender ose ekuivalente;

vii) Dosjen e tenderit, përfshirë anekset, sqarimet, procesverbalet e mbledhjeve, dëshminë e publikimit;

viii) Caktimin e komisionit të vlerësimit;

ix) Raportin për hapjen e tenderit, përfshirë anekset;

x) Raportin e vlerësimit/negocimit, përfshirë anekset dhe ofertat e pranuara;[1]
xi) Letërnjoftimin;
xii) Shkresën përcjellëse për dorëzimin e kontratës;
xiii) Shkresat për kandidatët që nuk kanë fituar;
xiv) Njoftimin për dhënien/anulimin e kontratës fituese, përfshirë dëshminë e publikimit;
xv) Kontratat e nënshkruara, ndryshimet, klauzolat shtesë, raportet e zbatimit dhe korrespondencën përkatëse.
b) Thirrjet për propozime dhe procedurat direkte për dhënien e granteve:
i) Caktimin e komisionit të vlerësimit;
ii) Raportin e hapjes dhe raportin administrativ, përfshirë anekset dhe kërkesat e pranuara;[2]
iii) Shkresat për aplikantët e suksesshëm dhe të pasuksesshëm pas vlerësimit të dokumentit konceptual;
iv) Raportin e vlerësimit të dokumentit konceptual;
v) Raportin e vlerësimit të kërkesës së plotë ose raportin e negocimit me anekset përkatëse;
vi) Kontrollin e përshtatshmërisë dhe dokumentet mbështetëse;
vii) Shkresat për aplikantët e suksesshëm dhe të pasuksesshëm, së bashku me listën e miratuar rezervë pas vlerësimit të aplikimit të plotë;
viii) Shkresën përcjellëse për dorëzimin e kontratës së grantit;
ix) Njoftimin e shpalljes/anulimit me dëshminë e publikimit;
x) Kontratat e nënshkruara, ndryshimet, kushtet dhe korrespondencën përkatëse.
Gjithashtu, dokumentet financiare dhe kontraktuale të përmendura në paragrafin 6(a) dhe (b) të këtij neni do të plotësohen me të gjitha dokumentet mbështetëse përkatëse, siç kërkohet nga procedurat e përmendura në paragrafin 1, si edhe i gjithë dokumentacioni përkatës në lidhje me pagesat, rikuperimet dhe shpenzimet operacionale, për shembull raporti i projektit dhe kontrolleve në terren, pranimi i furnizimeve dhe punimeve, garancitë, raportet e inxhinierëve të mbikëqyrjes.
(3) Operacionet e bashkëfinancuara nga Bashkimit sipas Programit mund të marrin fonde edhe nga donatorë të tjerë siç janë organizatat ndërkombëtare, Shtet Anëtar, vend i tretë ose organizatë rajonale.

Neni 2a
Përjashtimi dhe masat administrative

1. Gjatë zbatimit të procedurave dhe dokumenteve standarde të përcaktuara dhe të publikuara nga Komisioni për shpalljen e kontratave fituese të prokurimit dhe grantit, përfituesi i IPA III duhet të sigurohet, në përputhje me rrethanat, që asnjë kontratë prokurimi ose granti e financuar nga BE-ja të mos i jepet një operatori ekonomik ose aplikanti për grante, nëse operatori ose aplikanti për grante, ose vetë, ose nëpërmjet një personi me kompetenca përfaqësimi, vendimmarrëse ose kontrolli mbi të, është në një nga situatat e përjashtimit të parashikuara në procedurat përkatëse dhe dokumentet standarde të Komisionit.
2. Përfituesi i IPA III duhet të informojë Komisionin menjëherë kur një kandidat, ofertues ose aplikant ndodhet në një situatë përjashtimi të përmendur në paragrafin 1, ose ka kryer parregullsi dhe mashtrim siç përcaktohet në nenin 51 (5) të FFPA, ose ka shfaqur mangësi në përmbushjen e detyrimeve të tij kryespre për zbatimin e një angazhimi ligjor të financuar nga buxheti i Bashkimit.
3. Përfituesi i IPA III duhet të marrë parasysh informacionet që gjenden në Sistemin e Komisionit për Zbulim të Hershëm dhe Përjashtim (EDES) kur akordon kontratat e prokurimit dhe granteve. Njohja me informacionin mund të bëhet nëpërmjet pikës (pikave) të ndërlidhjes ose nëpërmjet konsultimeve duke përdorur mënyrat e mëposhtme: (Komisioni Evropian, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Kontabilisti i Komisionit, BRE2-13/505, B-1049 Bruksel, Belgjikë dhe

[1] Eliminimi i ofertave të pasukseshme pesë vjet pas mbylljes së procedurës së prokurimit.
[2] Eliminimi i ofertave të pasuksesshme tre vjet pas mbylljes së procedurës së grantit.

nëpërmjet e-mailit BUDG-C01-EXCL- DB@ec.europa.eu, ku një kopje i drejtohet Komisionit të përcaktuar në nenin 3 të Kushteve të Veçanta). Çdo kontratë ose grant i lidhur me një kontraktor ose përfitues granti që ndodhet në një situatë përjashtimi në kohën e lidhjes së kontratës, do të përjashtohet nga financimi i Bashkimit dhe mund të zbatohet mekanizmi i korrigjimeve financiare në përputhje me nenin 8a.

4. Kur përfituesi i IPA III merr dijeni për një situatë përjashtimi të përmendur në paragrafin (1) në zbatim të detyrave të përshkruara në Aneksin I, përfituesi i IPA III, sipas kushteve të legjislacionit të tij kombëtar, vendos ndaj operatorit ekonomik ose aplikantit të grantit refuzim nga procedura e dhënë dhe përjashtim nga procedurat e ardhshme të prokurimit ose dhënies së grantit. Përfituesi i IPA III mund të vendosë gjithashtu një gjobë financiare në përpjesëtim me vlerën e kontratës në fjalë. Refuzimet, përjashtimet dhe/ose gjobat financiare do të vendosen pas një procedure kundërshtuese që siguron të drejtën e mbrojtjes së personit në fjalë. Përfituesi i IPA III do të njoftojë Komisionin në përputhje me paragrafin (2).

Neni 3
Komunikimi dhe vizibiliteti

1. Në përputhje me Nenin 24 të FFPA, përfituesi i IPA III merr masa të nevojshme për të garantuar vizibilitetin e financimit të BE-së për aktivitetet që i janë besuar, dhe përgatit një plan koherent aktivitetesh vizibiliteti dhe komunikimi i cili duhet t'i paraqitet Komisionit për miratim brenda 2 muajve nga data e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Financimit.

2. Këto aktivitete komunikimi dhe vizibiliteti duhet të jenë në përputhje me udhëzimin për veprimin e jashtëm mbi komunikimin dhe rritjen e vizibilitetit të BE-së të përcaktuar dhe të publikuar nga Komisioni, në fuqi në kohën e aktiviteteve.

Neni 4
Kontrollet ex-ante dhe ex-post për procedurat e granteve dhe prokurimit dhe kontrollet ex-post për kontratat dhe grantet që do të kryhen nga Komisioni

1. Komisioni ushtron kontrolle *ex-post* mbi procedurat e shpalljes së fituesve për prokurimin dhe grantet për fazat e mëposhtme:

(a) njoftimi kontratës për prokurim, thirrjet për propozime dhe çdo korrigjim të tyre;
(b) dosje të tenderit dhe udhëzime për aplikantët për grantet;
(c) përbërja e Komisioneve të Vlerësimit;
(d) raporte të vlerësimit, vendim refuzimi dhe shpallje fituesi;[1]
(e) dosje të kontratave dhe shtesave të kontratave.

2. Lidhur me kontrollet *ex-post* Komisioni mund të vendosë pas vlerësimit të riskut:

(a) të kryejë kontrolle *ex-post* për të gjitha dosjet, ose
(b) të kryejë kontrolle *ex-post* mbi një përzgjedhje të këtyre dosjeve, ose
(c) të heqë dorë plotësisht nga kontrollet *ex-post*.

3. Nëse Komisioni vendos të kryejë kontrolle *ex-post*, në përputhje me paragrafin 2(a) pse (b), ai do të njoftojë përfituesin e IPA III për dosjet e përzgjedhura për kontrolle *ex-post*. Përfituesi i IPA III duhet t'i paraqesë Komisionit të gjithë dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm për dosjen e përzgjedhur për kontroll *ex-post* brenda një muaji nga nënshkrimi i kontratës ose shtesës së kontratës.

4. Komisioni mund të kryejë kontrolle *ex-ante* për miratimin e secilës prej fazave të përmendura në paragrafin 1 për procedurat e dhënies së kontratës që nuk janë përzgjedhur për kontroll *ex-post*. Përfituesi i IPA III do t'i japë Komisionit të gjithë dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm pasi të jetë informuar se një dosje është përzgjedhur për kontroll *ex-ante*, të paktën në momentin e dorëzimit të njoftimit të kontratës ose udhëzimeve për aplikantët për publikim.

[1] Për kontratat e shërbimit ky hap përfshin kontrolle *ex ante* në lidhje me miratimin e listës së përzgjedhur.

5. Komisioni mund të vendosë të kryejë kontrolle *ex-post*, duke përfshirë auditimet dhe kontrollet në terren, në çdo kohë gjatë ose pas zbatimit të çdo kontrate ose granti të dhënë nga përfituesi i IPA III që rrjedh nga kjo Marrëveshje Financimi. Përfituesi i IPA III do t'i vendosë në dispozicion Komisionit të gjithë dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm pasi të jetë informuar se një dosje është përzgjedhur për kontroll *ex-post*. Komisioni mund të autorizojë një person ose subjekt që të kryejë kontrolle *ex-post në emër të tij*.

Neni 5

Llogaritë bankare, sistemet e kontabilitetiti dhe shpenzimet e pranuara

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi, Organi i Kontabilitetit dhe Organi i Ndërmjetëm për Menaxhimin Financiar (IBFM) i përfituesit të IPA III që është autoriteti kontraktues për Programin, hap të paktën një llogari financiare në Euro dhe i paraqet Komisionit Formularin (Formularët) e Identifikimit Financiar së bashku me mandatet përkatëse bankare. Bilanci i përgjithshëm bankar për Programin do të jetë shuma e bilanceve për të gjitha llogaritë bankare të Programit të mbajtura nga Organi i Kontabilitetit dhe të gjitha IBFM pjesëmarrëse në përfituesin IPA III. Raportimi për të gjitha llogaritë bankare të lidhura me çdo program regjistrohet nëpërmjet IPA-APP[1].

2. Përfituesi IPA III duhet të përgatisë dhe t'i paraqesë Komisionit planet e parashikimit të disbursimit për kohëzgjatjen e Programit sipas modelit në pikën (d) të Aneksit IV. Këto parashikime duhet të përditësohen dhe të paraqiten me çdo kërkesë për fonde të përmendur në nenin 6(2) dhe 6(3) me raportin vjetor financiar të përmendur në nenin 14(4) dhe me parashikimin e kërkesave të mundshme për pagesë të përmendura në nenin 33(3) FFPA. Planet e parashikimit të disbursimit duhet të bazohen në nevojat reale dhe aktuale dhe të mbështeten nga analiza e hollësishme e dokumentuar (duke përfshirë kontraktimin e planifikuar dhe planifikimin e pagesës për kontratë) e cila do të vihet në dispozicion të Komisionit, nëse kërkohet.

3. Planet fillestare për parashikimin e disbursimit duhet të përmbajnë një përmbledhje të parashikimeve vjetore të disbursimit për të gjithë periudhën e pranueshmërisë dhe parashikimet mujore të disbursimit për dymbëdhjetë muajt e parë të Programit. Planet e mëvonshme do të përmbajnë përmbledhje të parashikimeve vjetore të disbursimit për bilancin e periudhës së zbatimit të Programit dhe parashikimet mujore të disbursimit për katërmbëdhjetë muajt e tjerë.

4. Kërkohet që përfituesi IPA III të krijojë dhe të ruajë një sistem kontabiliteti në përputhje me Klauzolën 4(3)(a) të Aneksit A të FFPA i cili do të mbajë të paktën informacionin për kontratat e menaxhuara në kuadrin e Programit të specifikuara në Aneksin V.

5. Sipas nenit 57(2) të FFPA, shpenzimet e pranuara në sistemin e kontabilitetit të parashikuar sipas paragrafit 4 duhet të jenë bërë (nga një marrës), pranuar (nga Organi i Ndërmjetëm për Menaxhimin financiar) dhe paguar (nga Organi i Ndërmjetëm për Menaxhimin financiar) dhe të korrespondojnë me shpenzimet aktuale të provuara me dokumente mbështetëse dhe duhet të përdoren kur është e nevojshme për të likuiduar parafinancimin e paguar nga përfituesi i IPA III sipas kontratave lokale.

Neni 6

Dispozitat mbi pagesat e kryera nga Komisioni për përfituesin e IPA III

1. Çdo kërkesë për parafinancim do të përmbajë një pasqyrë të shpenzimeve për Programin, duke përfshirë shumat e kontraktuara, të disbursuara dhe shpenzimet e njohura.

2. Përfituesi i IPA III duhet të paraqesë parashikimet e tij fillestare të disbursimit, të përgatitura sipas nenit 5(2), së bashku me kërkesën e pagesës së parë të parafinancimit. Pagesa e parë e

[1] IPA-APP është një aplikacion i dedikuar IT i zhvilluar nga DG NEAR për të zëvendësuar iPerseus që ishte instrumenti i përdorur për të monitoruar zbatimin e fondeve të para-aderimit nën menaxhimin indirekt nga vendet përfituese (IMBC).

parafinancimit duhet të jetë për 100% të disbursimeve të parashikuara për vitin e parë të planit të parashikimit për disbursimet. Parafinancimi do të mbështetet nga mandatet bankare për të gjitha llogaritë bankare të Programit, nëse është e zbatueshme.

3. Përfituesi i IPA III duhet të paraqesë kërkesat e pagesave vijuese të parafinancimit kur bilanci i përgjithshëm bankar për Programin bie nën nivelin e parashikimeve të disbursimit për pesë muajt e ardhshëm të Programit.

4. Çdo kërkesë për parafinancim shtesë duhet të përmbajë:

a) Bilancet bankare për Programin në datën përfundimtare së kërkesës;

b) Mandatet bankare të përditësuara për të gjitha llogaritë bankare të Programit, nëse ka;

c) Një plan parashikimi të disbursimeve për Programin për katërmbëdhjetë muajt e ardhshëm që nga dita e fundit e kërkesës të përmendur në nenin 5(2).

d) Raportimi i përditësuar në IPA-APP.

5. Përfituesi i IPA III mund të kërkojë, për çdo financim të mëvonshëm, shumën e disbursimeve totale të parashikuara për katërmbëdhjetë muaj që nga data e kërkesës, pa bilancet e përmendura në paragrafin 4(a) në datën e fundit të kërkesës për fonde, të shtuar me çdo shumë të financuar nga përfituesi i IPA III sipas paragrafit 6 dhe që nuk është rimbursuar ende. Periudha prej katërmbëdhjetë muajsh e parashikimit të disbursimit mund të shtyhet, nëse specifikohet në Kushtet e Veçanta.

Komisioni rezervon të drejtën të zbresë çdo pagesë të mëvonshme parafinancimi nëse bilancet e përgjithshme bankare të mbajtura nga përfituesi IPA III në kuadrin e këtij Programi tejkalojnë parashikimin e disbursimit për katërmbëdhjetë muajt e ardhshëm.

6. Kur pagesa reduktohet sipas paragrafit 5, përfituesi i IPA III duhet të financojë Programin me burimet e veta deri në shumën e reduktimit. Përfituesi i IPA III mund të kërkojë më pas rimbursimin e financimit si pjesë e kërkesës së radhës për fonde siç specifikohet në paragrafin 5.

7. Sipas nenit 33(1) të FFPA, Komisioni rezervon të drejtën të përpunojë pagesa të pjesshme brenda kufijve të fondeve në dispozicion. Pasi fondet janë vënë sërish në dispozicion, Komisioni do të përpunojë menjëherë pagesën e shumës së mbetur.

8. Komisioni ka të drejtë të rikuperojë bilancet e tepërta bankare që kanë mbetur pa u përdorur për më shumë se dymbëdhjetë muaj. Para ushtrimit të kësaj të drejte, Komisioni fton përfituesin IPA III që të japë arsyet e vonesës në disbursimin e fondeve dhe të demonstrojë nevojën e vazhdueshme për to gjatë dy muajve të ardhshëm.

6. Interesat e gjeneruara nga llogaritë bankare të përdorura për këtë Program, nuk do t'i ngarkohen Komisionit.

7. Sipas nenit 33(4) të FFPA, nëse afati kohor për kërkesën e pagesës ndërpritet nga Komisioni për më shumë se dy muaj, përfituesi IPA III mund të kërkojë një vendim nga Komisioni nëse duhet të vazhdojë ndërprerja e afatit kohor.

8. Deklarata përfundimtare e certifikuar, e përmendur në Nenin 36(1) (a) të FFPA-së, i paraqitet NAO-s jo më vonë se gjashtëmbëdhjetë muaj pas përfundimit të periudhës së pranueshmërisë.

Neni 7

Ndërprerja e pagesave

1. Pa cenuar pezullimin ose përfundimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi në përputhje përkatësisht me nenet 18 dhe 19, si dhe pa cenuar nenin 38 të FFPA, Komisioni mund të ndërpresë pagesat pjesërisht ose plotësisht, nëse:

a) Komisioni ka konstatuar ose ka shqetësime serioze se përfituesi i IPA III ka kryer gabime të konsiderueshme, parregullsi apo mashtrime që vënë në dyshim ligjshmërinë ose rregullsinë e transaksioneve të veçanta të rëndësishme në zbatimin e Programit, ose nuk ka përmbushur detyrimet e tij në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje Financimi, duke përfshirë detyrimet në lidhje Komunikimin Strategjik dhe Diplomacinë Publike;

b) Komisioni ka konstatuar ose ka shqetësime serioze në lidhje se përfituesi i IPA III ka kryer gabime sistematike ose të përsëritura, parregullsi, mashtrime ose shkelje të detyrimeve në kuadrin

e kësaj Marrëveshjeje Financimi apo të tjerave si kjo, me kusht që këto gabime, parregullsi, mashtrime ose shkelje të detyrimeve të kenë ndikim material në zbatimin e Marrëveshjes së Financimit apo të vënë në dyshim besueshmërinë e sistemit të brendshëm të kontrollit të përfituesit IPA III ose ligjshmërinë dhe rregullsinë e shpenzimeve kryesore.

Neni 8
Rikuperimi i fondeve

1. Përveç rasteve të përmendura në Nenin 40 të FFPA, Komisioni mund të rikuperojë fondet nga përfituesi i IPA III, siç parashikohet në Rregulloren e Financimit, veçanërisht në rastet e mëposhtme:

(a) mosrealizimi i arritjes së objektivave dhe rezultateve të Programit të përcaktuara në Aneksin I;

(b) mos-garantimi i përdorimit të aseteve dhe produkteve për qëllimet e synuara të përcaktuara në Aneksin I;

(c) shpenzime të papranueshme;

(d) mosrespektimi i normës së bashkëfinancimit, siç parashikohet në Aneksin I;

(e) shpenzime të krijuara si rezultat i gabimeve, parregullsive, mashtrimeve ose shkeljes së detyrimeve në zbatimin e Programit, veçanërisht në procedurën e prokurimit dhe dhënies së granteve.

(f) dobësi ose mangësi në menaxhim dhe sisteme kontrolli të përfituesit të IPA III që çojnë në aplikimin e korrigjimeve financiare,

2. Në përputhje me të drejtën kombëtare, NAO rikuperon kontributin e Bashkimit që i paguhet përfituesit IPA III nga marrësit të cilët ishin në secilën nga situatat e përcaktuara në paragrafin 1 pikat b) ose d) të këtij Neni ose të përmendur në nenin 40 të FFPA-s. Fakti që NAO nuk arrin të rikuperojë një pjesë apo të gjitha fondet, nuk e pengon Komisionin të rikuperojë fondet nga përfituesi i IPA III.

3. Shumat e paguara në mënyrë të parregullt ose të rikuperuara nga përfituesi i IPA III, shumat nga garancitë financiare, të performancës dhe parafinancimit të paraqitura mbi bazën e procedurave të prokurimit dhe dhënies së granteve, shumat nga gjobat financiare të vendosura nga përfituesi IPA III ndaj kandidatëve, ofertuesve, aplikantëve, kontraktuesve ose përfituesve të granteve për përfituesin IPA III ose do të përdoren sërish për Programin ose do t'i kthehen Komisionit.

Neni 8a
Korrigjimet financiare dhe mbyllja

Sipas neneve 42, 43 dhe 47 të FFPA-së, Komisioni jep udhëzime plotësuese për procedurën e ekzainimit dhe pranimit të llogarive, duke përfshirë korrigjimet financiare dhe mbylljen.

Neni 9
Parimet e përgjithshme për përzgjedhjen e veprimeve

1) Procedurat e përzgjedhjes duhet të plotësojnë parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit. Ato do të parandalojnë çdo konflikt interesi dhe do të garantojnë përfshirjen e palëve të interesuara dhe njohjen e publikut me informacion.

2) Komiteti Sektorial i Monitorimit do të shqyrtojë dhe miratojë kriteret e përgjithshme për përzgjedhjen e veprimeve të përmendura në nenin 10 brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje Financimi dhe do të miratojë çdo rishikim të këtyre kritereve në përputhje me nevojat e programimit.

3) Në bazë të nenit 53(7) të FFPA, Komisioni mund të bashkëkryesojë mbledhjet e Komiteteve Sektoriale të Monitorimit.

4) Përfituesi i IPA III do të garantojë që veprimet të përzgjidhen për financim dhe të miratohen në përputhje me kriteret dhe mekanizmat e zbatueshëm për programin, duke përfshirë programin përkatës operacional, dhe që ato të jenë në përputhje me rregullat përkatëse të Bashkimit dhe ato kombëtare.

Neni 10
Modeli për Dokumentet e Identifikimit të Veprimeve

1. Për çdo veprim që nuk bie nën përkufizimin e projektit madhor të përmendur në nenin 3(f) dhe nenin 16(6) të FFPA-së, përfituesi i IPA III do të hartojë një fletë identifikuese për çdo veprim të përzgjedhur për bashkëfinancim të Bashkimit sipas Programit.

2. Modeli për Dokumentet e Identifikimit të Veprimeve duhet të përmbajë, ndër të tjera, elementët e mëposhtëm:

a) identifikimin e veprimit dhe institucionit përgjegjës për zbatimin e tij;

b) një përshkrim përmbledhës të veprimit dhe demonstrimin e përputhshmërisë së tij me programin;

c) rregullimet e zbatimit, risqet dhe supozimet;

d) produktet e pritshme, rezultatet dhe ndikimi, duke përfshirë kontributet në temat horizontale;

e) lidhjet me programet e tjera IPA, IPA II dhe IPA III;

f) marrëveshjet e financimit dhe buxhetin e parashikuar; dhe

g) procedurat e parashikuara për tenderët dhe kontratat.

Modeli i Fletës Identifikuese të Veprimit paraqitet në Aneksin VII.

3. Përfituesi i IPA III do t'i transmetojë një kopje të fletës identifikuese të veprimit Delegacionit të BE-së, i cili pas konsultimit me DG NEAR, do të dërgojë opinionin e tij. Pasi të jetë dhënë një opinion pozitiv mbi fletën identifikuese të veprimit, projekti mund të miratohet nga përfituesi IPA III.

4. Kur natyra e veprimit e justifikon, Komisioni mund të vendosë t'i kërkojë përfituesit të IPA III që të zbatojë nenin 11 për një veprim të caktuar dhe të përgatisë një formular aplikimi, në përputhje me formatet e përcaktuara në Aneksin VI të kësaj Marrëveshjeje Financimi.

Neni 11
Projekti madhor dhe marrëveshja dypalëshe

1).Në përputhje me nenin 16(6) të FFPA, aplikimet për projekte madhore do t'i dorëzohen Komisionit për vlerësim, duke përdorur modelin e Aplikimit për Projekt Madhor (Aneksi VI).

2. Vlerësimi i Komisionit përcakton objektin fizik dhe shpenzimet e pranueshme. Vlerësimi i Komisionit do të përmbyllet ose me një shkëmbim notash (përkatësisht me paraqitjen e aplikimit për projektin madhor nga përfituesi IPA III dhe përgjigjen nga Komisioni që e miraton atë) ose me nënshkrimin e një Marrëveshjeje Dypalëshe me përfituesin e IPA III që përcakton elementët individualë dhe kërkesat specifike për projektin.

3. Marrëveshja dypalëshe ose shkëmbimi i notave, të paktën, do të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

a) emri i projektit;

b) identifikimi i vendndodhjes së projektit;

c) një përshkrim konciz të projektit, i ndarë, sipas nevojës, në komponentë individualë;

d) detajet e autoritetit përgjegjës për aplikimin e projektit, organit përgjegjës për zbatimin, autoritetit kontraktues dhe marrësit;

e) detajet e çdo institucioni financiar ndërkombëtar (IFI) ose donatorëve të tjerë të përfshirë në projekt;

f) objektivat specifikë të projektit;

g) një përmbledhje të rezultateve kryesore të analizës socio-ekonomike të kosto-përfitimit;

h) një përmbledhje të analizës financiare;
i) një përmbledhje të gjetjeve kryesore të vlerësimit të ndikimit në mjedis;
j) vlerën totale të parashikuar të projektit, si dhe një zbërthim indikativ të vlerës së elementeve individuale të projektit;
k) kostot totale të parashikuara të projektit, të pranueshme dhe jo të pranueshme, shpenzimet totale publike, kontributin financiar të Bashkimit dhe normën e bashkëfinancimit, të zbatueshme për shpenzimet e pranueshme;
l) çdo kusht specifik në lidhje me projektin;
m) një plan prokurimi indikativ që tregon llojet specifike dhe vlerat e parashikuara të kontratave që do të tenderohen dhe në rast të bashkëfinancimit paralel me IFI-të, identifikimin e kontratave që do të financohen nga IFI-të, si dhe një të dhënë për datën e fillimit të procedurës së tenderimit;
n) një plan indikativ të zbatimit;
o) një listë indikative të treguesve kryesorë që do të përdoren për të demonstruar arritjen e qëllimeve të projektit;
p) datën nga e cila shpenzimet janë të pranueshme.
4. Procedura e prokurimit për një projekt madhor mund të iniciohet nga përfituesi IPA III pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi. Asnjë kontratë prokurimi për një projekt madhor nuk mund të nënshkruhet para hyrjes në fuqi të Marrëveshjes Dypalëshe ose përfundimit të shkëmbimit të notave që miratojnë aplikimin e projektit madhor.
5. Modifikimet e projekteve madhore të miratuara i nënshtrohen kufizimeve dhe kushteve të përcaktuara në Marrëveshjen Dypalëshe ose në shkëmbimin e notave.

Pjesa e dytë:
Dispozitat e Zbatueshme për këtë Marrëveshje Financimi në tërësi, pavarësisht nga mënyra e menaxhimit

Neni 12
Periudha e pranueshmërisë

1. Periudha e pranueshmërisë është periudha ku përfundojnë të gjitha aktivitetet operacionale të Programit. Kohëzgjatja e kësaj periudhe është përcaktuar në nenin 2(2) të Kushteve të Veçanta.
Kjo periudhë do të tregohet në marrëveshjet që do të lidhen nga përfituesi i IPA III dhe nga Komisioni në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi, veçanërisht në marrëveshjet e kontributit, kontratat e prokurimit dhe kontratat e granteve.
2. Nëse nuk parashikohet ndryshe në nenin 7 të Kushteve të Veçanta, kontratat dhe shtesat e nënshkruara, shpenzimet e kryera, pagesat e bëra nga autoritetet kombëtare si dhe çdo kosto tjetër që lidhet me aktivitetet e Programit, do të jenë të pranueshme për financim nga BE-ja vetëm nëse janë kryer gjatë periudhës së pranueshmërisë, pa cenuar paragrafin (3) të këtij neni.
3. Në rastin e projekteve madhore, data e fillimit të periudhës së pranueshmërisë është data e miratimit të projektit madhor nga Komisioni, siç përcaktohet në një marrëveshje dypalëshe ose shkëmbim notash.
4. Sipas nenit 29(3)(b) të FFPA-së dhe pa cenuar nenin 28 të tij dhe nenin 7 të Kushteve të Veçanta, shpenzimet e mëposhtme të kryera nga përfituesi i IPA III nuk do të jenë të pranueshme për financim sipas kësaj marrëveshjeje financimi:
a) tarifat bankare, kostot e garancive dhe tarifat e ngjashme;
b) gjobat dhe gjobat financiare;
c) shpenzimet e proceseve gjyqësore;
d) luhatjet e këmbimit valutor;
e) borxhet dhe detyrimet për kamatëvonesën e borxhit (interesin);
f) provizionet për humbjet, borxhet ose detyrimet e ardhshme të mundshme;
g) kreditë ndaj palëve të treta, nëse nuk specifikohet ndryshe në kushtet e veçanta;

h) interesin negativ të vendosur nga bankat ose institucionet e tjera financiare.

5. Kontrata e prokurimit, kontrata e grantit ose marrëveshja e kontributit e cila nuk ka shkaktuar asnjë pagesë, brenda dy viteve nga nënshkrimi i saj, do të ndërpritet automatikisht dhe financimi i saj do të likuidohet, me përjashtim të rasteve të çështjeve gjyqësore para gjykatave ose organeve të arbitrazhit.

Neni 13
Lejet dhe autorizimi

Pa cenuar nenin 27 të FFPA-së, çdo lloj leje dhe/ose autorizimi i kërkuar për zbatimin e Programit duhet të sigurohet në kohën e duhur nga autoritetet kompetente të përfituesit IPA III, në përputhje me të drejtën kombëtare.

Neni 14
Kërkesat e raportimit

1. Për qëllimin e kërkesave të përgjithshme të raportimit në Komision , të përcaktuara në Nenin 59 të FFPA-së mbi raportin vjetor për zbatimin e ndihmës IPA III, NIPAC do të përdorë modelin e dhënë në Aneksin III.

2. Për qëllimin e nenit 60 të FFPA-së, NIPAC dorëzon tek Komisioni një raport për realizimin e aktiviteteve nën menaxhimin indirekt nga përfituesi i IPA III të këtij Programi, të paktën gjashtëmbëdhjetë muaj pas mbarimit të periudhës së pranueshmërisë. NIPAC do të përdorë modelin e dhënë nga Komisioni.

3. Për qëllimet e nenit 61(4) të FFPA, NAO duhet të paraqesë në format elektronik një kopje të të dhënave në sistemin e kontabilitetit të krijuar sipas nenit 4(4), deri më 15 janar të vitit të ardhshëm fiskal. Kjo duhet të mbështetet nga një raport përmbledhës i pa-audituar financiar i nënshkruar, në përputhje me pikën c të Aneksit III.

4. Për qëllimin e kërkesave specifike të raportimit nën menaxhimin indirekt të përcaktuara në nenin 61 (2) (a) dhe 61 (3) të FFPA, NAO në përfituesin e IPA III përdor modelet e dhëna në pikat (a) dhe (b) të Aneksit IV.

Neni 15
Të drejtat e pronësisë intelektuale

1. Kontratat e financuara në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje Financimi duhet të sigurojnë që përfituesi IPA III të fitojë të gjitha të drejtat e nevojshme të pronësisë intelektuale në lidhje me teknologjinë e informacionit, studimet, skicat, planet, publicitetin dhe çdo material tjetër të përgatitur për qëllime planifikimi, zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi.

2. Përfituesi IPA III duhet të garantojë që Komisioni ose çdo organ apo person tjetër i autorizuar nga Komisioni, të ketë akses dhe të drejtën që të përdorë këtë material. Komisioni do të përdorë këtë material vetëm për qëllimet e veta.

Neni 16
Konsultimi ndërmjet Përfituesit IPA III dhe Komisionit

1. Përfituesi IPA III dhe Komisioni konsultohen me njëri-tjetrin para shkaktimit të ndonjë mosmarrëveshjeje në lidhje me zbatimin ose interpretimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi më tej në zbatim të nenit 20.

2. Nëse Komisioni vihet në dijeni të problemeve për kryerjen e procedurave në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshje Financimi, ai vendos të gjitha kontaktet e nevojshme me përfituesin IPA III për të rregulluar dhe ndërmarrë çdo hap të nevojshëm.

3. Konsultimi mund të çojë në një ndryshim, pezullim ose ndërprerjen e kësaj Marrëveshje Financimi.

4. Komisioni vë në dijeni rregullisht Përfituesin IPA III mbi zbatimin e aktiviteteve të përshkruara në Aneksin I të cilat nuk përfshihen në Pjesën e Parë të Kushteve të Përgjithshme.

Neni 17

Ndryshimi i Marrëveshjes së Financimit

1. Çdo ndryshim i kësaj Marrëveshjeje Financimi bëhet me shkrim, duke përfshirë shkëmbimin e notave.

2. Nëse Përfituesi i IPA III kërkon një ndryshim, kërkesa duhet t'i paraqitet Komisionit të paktën tre muaj para se ky ndryshim të synohet të hyjë në fuqi, përveç në raste të justifikuara sipas rregullave.

3. Komisioni mund të ndryshojë Dokumentet në Anekset III – VII, pa nevojën për ndryshimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi. Përfituesi i IPA III informohet me shkrim për çdo ndryshim të tillë dhe hyrjen e tij në fuqi.

Neni 18

Pezullimi i kësaj Marrëveshjeje Financimi

1. Marrëveshja e Financimit mund të pezullohet në rastet e mëposhtme:

a) Komisioni mund të pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi, nëse përfituesi i IPA III shkel një detyrim sipas kësaj Marrëveshjeje Financimi;

b) Komisioni mund të pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi, nëse përfituesi i IPA III shkel ndonjë detyrim të përcaktuar sipas procedurave dhe dokumenteve standarde të përmendura në nenin 18(2) të FFPA-së;

c) Komisioni mund të pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi, nëse përfituesi i IPA III nuk përmbush kërkesat për t'i besuar detyrat e zbatimit të buxhetit;

d) Komisioni mund të pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi, nëse përfituesi i IPA III vendos të pezullojë ose të pushojë procesin e anëtarësimit në BE;

e) Komisioni mund të pezullojë këtë Marrëveshje Financimi, nëse përfituesi i IPA III shkel detyrimin në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut, parimet demokratike dhe shtetit ligjor, si dhe në rastet e rënda të korrupsionit ose nëse përfituesi i IPA III është fajtor për shkelje të rëndë profesionale të provuar me çdo mjet të justifikuar. Shkelje e rëndë profesionale duhet të kuptohet si një nga sa vijon:

-shkelje e ligjeve ose rregulloreve në fuqi ose standardeve etike të profesionit të cilit i përket një person ose subjekt, ose

- çdo sjellje e gabuar e një personi ose subjekti që ka ndikim në besueshmërinë e tij profesionale, kur kjo sjellje tregon qëllim të gabuar ose pakujdesi të rëndë.

f) Marrëveshja e Financimit mund të pezullohet në rastet e forcës madhore, siç përcaktohet më poshtë. "Forcë madhore" është çdo situatë ose ngjarje e paparashikueshme dhe e jashtëzakonshme përtej kontrollit të palëve që pengon secilën prej tyre në përmbushjen e detyrimeve të tyre, që nuk i atribuohet një gabimi apo pakujdesie nga ana e tyre (ose nga ana e kontraktorëve, agjentëve apo të punësuarve të tyre) dhe që rezulton e pakapërcyeshme, pavarësisht kujdesit të duhur. Defektet në pajisje ose materiale apo vonesat në vënien e tyre në dispozicion, mosmarrëveshjet në punë, grevat ose vështirësitë financiare nuk mund të përdoren si forcë madhore.

Një palë nuk mund të shpallet në shkelje të detyrimeve të saj, nëse pengohet t'i përmbushë nga një rast i forcës madhore për të cilin pala tjetër është informuar në mënyrën e duhur. Një palë që përballet me forcë madhore duhet të informojë palën tjetër pa vonesë, duke deklaruar natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektet e parashikueshme të problemit, dhe ndonjë masë për minimizimin e dëmit të mundshëm. Nëse forca madhore ndikon vetëm në një pjesë të Programit,

pezullimi i Marrëveshjes së Financimit mund të jetë i pjesshëm. Asnjë nga Palët nuk mund të shpallet përgjegjëse për shkelje të detyrimeve të saj sipas kësaj Marrëveshjeje Financimi, nëse pengohet në përmbushjen e tyre për shkak të një force madhore, me kusht që të marrë masat për të minimizuar çdo dëm të mundshëm.

2. Komisioni mund të pezullojë këtë Marrëveshje Financimi pa njoftim paraprak.

3. Komisioni mund të marrë të gjitha masat e nevojshme paraprake para se të ndodhë pezullimi.

4. Në rastin kur njoftohet pezullimi, duhet të specifikohen pasojat për kontratat e prokurimit në vijim apo që do të nënshkruhen dhe kontratat e granteve, si dhe marrëveshjet e kontributit.

5. Pezullimi i Marrëveshjes së Financimit bëhet pa cenuar ndërprerjen e pagesave dhe mbarimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi nga Komisioni, në përputhje me nenin 7 dhe nenin 19.

6. Palët e përfshira fillojnë zbatimin e Marrëveshjes së Financimit menjëherë sapo ta lejojnë kushtet me miratimin paraprak me shkrim të Komisionit. Kjo bëhet pa cenuar ndonjë ndryshim të kësaj Marrëveshjeje Financimi që mund të jetë i nevojshëm për të përshtatur Programin me kushtet e reja të zbatimit, duke përfshirë, nëse është e mundur, zgjatjen e periudhës së pranueshmërisë, ose ndërprerjen e kësaj Marrëveshjeje Financimi në përputhje me nenin 19.

Neni 19

Ndërprerja e kësaj Marrëveshjeje Financimi

1. Nëse çështjet që çuan në pezullimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi nuk janë zgjidhur brenda një periudhe maksimale prej 180 ditësh, secila palë mund ta ndërpresë këtë Marrëveshje Financimi pas një njoftimi brenda 30 ditëve.

2. Në rastin kur njoftohet ndërprerja, duhet të specifikohen pasojat për kontratat e prokurimit dhe granteve, marrëveshjet e kontributit në proces dhe këto kontrata ose grante dhe marrëveshjet e kontributit që do të nënshkruhen.

3. Ndërprerja e Marrëveshjes së Financimit nuk përjashton mundësinë që Komisioni të bëjë korrigjime financiare në përputhje me nenet 43 dhe 44 të FFPA-së.

Neni 20

Ligji i zbatueshëm, zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Kjo Marrëveshje rregullohet nga ligji i BE-së.

2. Nëse një mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin, zbatimin ose vlefshmërinë e Marrëveshjes nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim, ajo do të zgjidhet me arbitrazh në përputhje me Rregullat e Arbitrazhit të PCA të vitit 2012, sipas sa vijon:

a) Përbërja e panelit

Për pretendimet prej 500 000 Euro ose më shumë: paneli do të përbëhet nga tre arbitra. Secila palë do të caktojë një arbitër brenda 40 ditëve kalendarike pas dërgimit të njoftimit të arbitrazhit. Dy arbitrat e emëruar nga palët do të caktojnë nga ana e tyre një arbitër të tretë për të vepruar si arbitër kryesues.

Për pretendimet nën 500 000 Euro: paneli do të përbëhet nga një arbitër, përveç kur palët bien dakord ndryshe.

Nëse trupi gjykues nuk formohet, brenda 80 ditëve kalendarike pas dërgimit të njoftimit të arbitrazhit, secila palë mund t'i kërkojë Sekretariatit të PCA-së ose autoritetit tjetër të paanshëm të pranueshëm reciprokisht që të caktojë arbitrin(at) e nevojshëm.

b) Selia

Selia e panelit të arbitrazhit do të jetë Hagë, Holandë.

c) Gjuha

Gjuha e proceseve do të jetë gjuha angleze ose një gjuhë tjetër zyrtare e pranueshme reciprokisht e Bashkimit Evropian. Provat mund të paraqiten në gjuhë të tjera, nëse palët bien dakord.

d) Procedura

Përjashtohet përdorimi i masave të sigurimit, ndërhyrjet e palëve të treta dhe ndërhyrjet amicus curiae.

Nëse një palë i kërkon panelit që të trajtojë informacionin ose materialin në mënyrë konfidenciale, vendimi do të merret në formë të një urdhri të arsyetuar dhe pas dëgjimit të palës tjetër (10 ditë kalendarike për të paraqitur parashtrimet). Paneli do të vlerësojë arsyet e kërkesës, natyrën e informacionit dhe të drejtën për mbrojtje efektive gjyqësore. Paneli në veçanti:

- mund t'ia nënshtrojë dhënien e informacionit masave specifike ose
- mund të vendosë kundër nxjerrjes së informacionit, por të urdhërojë prodhimin e një versioni jo-konfidencial ose përmbledhje të informacionit ose materialit që përmban informacion të mjaftueshëm për t'i mundësuar palës tjetër të shprehë pikëpamjet e saj në një mënyrë të kuptueshme.

Nëse panelit i kërkohet të shqyrtojë çështjen me dyer të mbyllura, vendimi merret pasi të dëgjojë palën tjetër (10 ditë kalendarike për të paraqitur parashtrimet). Paneli do të marrë parasysh arsyet e kërkesës dhe kundërshtimet e palës tjetër (nëse ka).

Nëse panelit i kërkohet të interpretojë ose zbatojë ligjin e Bashkimit Evropian, ai do të pezullojë procedurën dhe do t'i kërkojë 'Kryetarit të Gjykatës së Lartë të Parisit' (Président du Tribunal de grande instance de Paris, 'juge d'appui'), në përputhje me nenet 1460 dhe 1505 të Kodit të Procedurës Civile Franceze, që të kërkojë një vendim paraprak nga Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian në përputhje me nenin 267 TFBE. Proceset para tribunalit të arbitrazhit do të rifillojnë pasi të merret vendimi nga juge d'appui. Vendimi i Gjykatës së Drejtësisë dhe i juge d'appui është i detyrueshëm për panelin.

Vendimi i arbitrazhit do të jetë i formës së prerë dhe detyrues për palët dhe do të zbatohet prej tyre pa vonesë.

Megjithatë, secila palë mund të kërkojë që vendimi të rishikohet nga Gjykata e Apelit të Hagës (Gerechtshof Den Haag) në bazë të së drejtës kombëtare të zbatueshme. Në këtë rast, vendimi nuk do të konsiderohet i formës së prerë deri në përfundimin e kësaj procedure. Vendimi i gjykatës rishikuese është i detyrueshëm për panelin.

e) Shpenzime

Shpenzimet e arbitrazhit do të përbëhen nga:

- tarifat dhe shpenzimet e arsyeshme të arbitrave
- shpenzimet e arsyeshme të ekspertëve dhe dëshmitarëve të miratuar nga paneli dhe
- tarifat dhe shpenzimet e Sekretariatit të PCA-së për procedurat e arbitrazhit (p.sh. ushqimi, sigurimi i nëpunësve, sallës, përkthimit).

Tarifat e arbitrave nuk duhet të kalojnë:

- 30 000 Euro për arbitër, nëse shuma e kontestuar është nën 1 000 000 Euro
- 15% të shumës së kontestuar, nëse kjo shumë është mbi 1 000 000 Euro. Në çdo rast, tarifat e arbitrave nuk duhet të kalojnë 300 000 Euro.

Shpenzimet e arbitrazhit do të mbulohen nga palët në pjesë të barabarta, përveç nëse është rënë dakord ndryshe.

Palët do të mbulojnë shpenzimet e tyre të përfaqësimit ligjor dhe shpenzimet e tjera të kryera prej tyre në lidhje me arbitrazhin.

f) Privilegjet dhe imunitetet

Marrëveshja për të ushtruar arbitrazhin sipas Rregullave të Arbitrazhit të PCA-së të vitit 2012 nuk përbën dhe nuk mund të interpretohet si heqje dorë nga privilegjet ose imunitetet e ndonjërës prej palëve, për të cilat ato kanë të drejtë.

Neni 21
Masat kufizuese të BE-së

1. Përkufizime

a) "Masa kufizuese të BE-së" janë masa kufizuese të miratuara në bazë të Traktatit të Bashkimit Evropian (TEU) ose të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFBE).

b) "Person i kufizuar" është çdo subjekt, individ ose grup individësh të përcaktuar nga BE-ja si subjekt i Masave Kufizuese të BE-së[1].

2. Në të gjitha marrëdhëniet e tyre, Palët pranojnë se sipas të drejtës së BE-së, asnjë fond ose burim ekonomik i BE-së nuk duhet të vihet në dispozicion të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të Personave të Kufizuar ose në dobi të tyre.

3. Përfituesi i IPA III do të sigurojë që asnjë transaksion që i nënshtrohet një identifikimi të verifikuar kundrejt listës së sanksioneve të BE-së, të mos përfitojë drejtpërdrejt ose tërthorazi nga financimi i BE-së. Përfituesi i IPA III angazhohet të sigurojë këtë detyrim:

a) duke kontrolluar për identifikim kundrejt listës së sanksioneve të BE-së, përpara se të lidhë dhe para se të kryejë pagesa sipas marrëveshjeve përkatëse, çdo kontraktor, përfitues granti dhe marrës përfundimtar me të cilin Përfituesi i IPA III ka ose pritet të ketë një marrëdhënie të drejtpërdrejtë kontraktuale (marrësi i drejtpërdrejtë), në mënyrë që të vlerësohet nëse ky marrës është një person i kufizuar.

b) duke kontrolluar ose nëpërmjet mjeteve të tjera të përshtatshme (që mund të përfshijnë një verifikim ex-post) mbi bazën e një qasjeje të bazuar në risk, që asnjë subjekt që do të merrte indirekt financimin e BE-së nuk është person i kufizuar.

4. Në rast se Përfituesi i IPA III çmon se ndonjë nga përfituesit (direkt ose indirekt) e fondeve të BE-së është një person i kufizuar, përfituesi i IPA III duhet të informojë menjëherë Komisionin.

5. Pa cenuar detyrimin në pikën 3 më sipër, nëse Komisioni çmon se përdorimi i ndihmës financiare të Bashkimit sipas IPA III rezulton ose ka rezultuar në shkelje të masave kufizuese të BE-së, shumat përkatëse nuk do të jenë të pranueshme për ndihmën financiare të Bashkimit sipas IPA III. Kjo nuk cenon të drejtën që mund të ketë Komisioni për të pezulluar ose ndërprerë veprimin e prekur nga një shkelje e tillë, për të rikuperuar çdo financim të BE-së të kontribuuar nga Komisioni, ose për të pezulluar ose ndërprerë këtë marrëveshje financimi.

6. Përcaktimi i masave korrigjuese do të bëhet në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Masat korrigjuese do të zbatohen vetëm për fondet e BE-së të vëna në dispozicion, ose në dobi të një përfituesi për periudhën gjatë së cilës ai ka mbetur person i kufizuar.

7. Kjo klauzolë nuk cenon përjashtimet e përfshira në Masat Kufizuese të BE-së.

Format i raportit vjetor për zbatimin e Instrumentit të Ndihmës Para-Aderimit, i paraqitur nga Koordinatori Kombëtar për IPA-n
(në përputhje me nenin 59 të Marrëveshjes Kuadër të Partneritetit Financiar)

Periudha që mbulon raportimi: 01/01/20XX-31/12/20XX
Raporti i nxjerrë më XX/XX/20XX

Raporti Vjetor për Zbatimin e Instrumentit për Ndihmën Para-Aderimit në menaxhim direkt dhe indirekt nga <*përfituesi i IPA-s*>

I. Përmbledhje ekzekutive

Kjo pjesë duhet të identifikojë gjetjet kryesore të përgjithshme siç raportohen në Pjesën II, duke u fokusuar në:

- Progresin në arritjen e objektivave të dokumenteve strategjike gjithëpërfshirëse të IPA-s (Dokumentet Strategjike të vendit sipas IPA II dhe Kuadri i Programimit IPA III)

[1] www.sanctionsmap.eu. Harta e sanksioneve është një mjet IT për identifikimin e regjimeve të sanksioneve. Burimi i sanksioneve rrjedh nga aktet ligjore të publikuara në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian (OJ). Në rast mospërputhjeje ndërmjet akteve ligjore të publikuara dhe përditësimeve në faqen e internetit, versioni i OJ-së do të ketë përparësi.

- Arritjet dhe sfidat kryesore në programimin dhe zbatimin dhe masat korrigjuese të ndërmarra, duke përfshirë ndjekjen e rekomandimeve më të rëndësishme të monitorimit, vlerësimit dhe/ose auditimit
- Plotësimin me veprimet e shumë vendeve dhe mbështetjen nga donatorë të tjerë (përfshirë Team Europe, nëse është e nevojshme)
- Arritjet kryesore me aktivitetet e komunikimit dhe vizibilitetit
- Rekomandimet kryesore të Koordinatorit Kombëtar për IPA-n për periudhën e ardhshme

II. Zbatimi i ndihmës IPA për Dritaren/Prioritetin Tematik IPA dhe Sektorin IPA II

Informacioni i dhënë në këtë pjesë duhet të bazohet/lidhet me informacionin e dhënë në tabelën 1 më poshtë.

Kjo pjesë duhet të përfshijë një përmbledhje për dritare/prioritet tematik (ndihma IPA III) dhe për sektor (ndihma IPA II) të organizuar si më poshtë:

Sektori IPA II: <emri(emrat) e sektorit[1]>

Dritare IPA III: <numri dhe emri i dritares>/Prioriteti tematik:<emri (emrat) e prioritetit tematik[2]>

Duhet të jepet informacioni i mëposhtëm:

1. Përfshirja e përfituesit të IPA-s në programim
2. Progresi i bërë në zbatim për të arritur objektivat e përshkruara në dokumentet kyçe strategjike dhe të programimit (treguesit përkatës të rezultateve/produkteve duhet të jepen në Aneksin 1)
3. Problemet e hasura në zbatim dhe masat korrigjuese të marra dhe/ose të planifikuara, dhe rekomandimet për veprime të mëtejshme, në mënyrë që të garantohet qëndrueshmëria[3]
4. Gjetjet kryesore të monitorimit, vlerësimeve dhe/ose auditim dhe vijueshmëria e tyre
5. Plotësimi me instrumente të tjera dhe koordinimi me donatorët e tjerë/IFI, brenda dritares/prioritetit tematik (IPA III) ose sektorit (IPA II) (p.sh. nëpërmjet Team Europe)
6. Vlerësimi i ndikimit të ndihmës IPA në përmirësimin e qasjes sektoriale, duke përfshirë strategjitë sektoriale, kapacitetet institucionale dhe buxhetimin dhe shtrirjes së sigurimit të koherencës së tyre me planifikimin e politikave strategjike kombëtare dhe kuadrit buxhetor.
7. Veprimtari komunikimi dhe vizibiliteti

Në rast të **menaxhimit indirekt nga vendi përfitues (IMBC)**, duhet të përfshihet gjithashtu informacioni i mëposhtëm:

8. Informacion për realizimin e veprimeve
9. Vlerësim i shkurtër mbi funksionimin e strukturave zbatuese dhe çdo çështje kritike që haset në zbatimin e detyrave të besuara p.sh. vonesat në kontraktim dhe masat vijuese të marra/planifikuara.
10. Aktivitetet e zbatuara të monitorimit, vlerësimit dhe/ose auditimit, gjetjet kryesore të auditit dhe mësimet e nxjerra, rekomandimet, masat vijuese dhe korrigjuese të ndërmarra

Programet IPA për Zhvillimin Rural (IPARD) duhet të mbulohen si një pjesë e veçantë nën Dritaren 4 IPA III / Sektori IPA II për bujqësinë dhe zhvillimin rural. Meqë programet IPARD i nënshtrohen raportimit të veçantë, pjesa duhet të përfshijë vetëm një përmbledhje të progresit të përgjithshëm me zbatimin dhe të identifikojë çështjet më të rëndësishme. Informacioni kryesor duhet të theksohet gjithashtu në përmbledhjen ekzekutive (sipas rastit).

Programet operacionale IPA II duhet të mbulohen nga sektori përkatës që ofron informacion mbi pikat 1-10 (sipas rastit). **Programet operacionale IPA III** duhet të mbulohen në dritaren përkatëse tematike dhe të përfshijnë vetëm një përmbledhje të progresit të përgjithshëm për zbatimin dhe të theksojnë çështjet më të rëndësishme. Informacioni kryesor duhet gjithashtu të

[1] Sipas sektorëve në Dokumentin e Projektit, p.sh. Sundimi i Ligjit, Transporti, Energjia etj.
[2] Sipas Kuadrit të Programimit IPA III
[3] Qëndrueshmëria i referohet masës në të cilën përfitimet/rezultatet (produktet dhe rezultatet) e arritura mund të vazhdojnë përtej periudhës së zbatimit të tij. Në veçanti, faktorët kyç që ndikojnë në qëndrueshmëri janë pronësia nga përfituesit, kapacitetet e menaxhimit institucional dhe burimet e angazhuara për të garantuar funksionimin dhe ruajtjen e rezultateve.

theksohet në përmbledhjen ekzekutive sipas rëndësisë. Programet operacionale IPA III do t'i nënshtrohen një raportimi më të detajuar sipas një modeli raportimi që do t'i bashkëlidhet Marrëveshjeve të Financimit.

Programet e bashkëpunimit territorial duhet të mbulohen nga Dritarja 5 IPA III / Sektori IPA II për bashkëpunimin territorial dhe rajonal. Kjo pjesë duhet të paraqesë një pasqyrë mjaft të shkurtër të programeve të bashkëpunimit territorial ku merr pjesë përfituesi IPA:

– Për **programet e bashkëpunimit ndërkufitar Interreg (CBC) me Shtetet Anëtare dhe programet e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ndërrajonal**, maksimumi një paragraf për program që tregon progresin e përgjithshëm me zbatimin (p.sh. programi i miratuar/i pamiratuar, thirrjet e planifikuara et.) dhe thekson kryesisht çështjet e rëndësime në zbatim.

– Për **programet CBC ndërmjet përfituesve të IPA-s**, një përmbledhje maksimumi gjysmë faqe për program, e cila jep një pasqyrë të zbatimit (p.sh. programi i miratuar/Komiteti i Përbashkët i Monitorimit i krijuar/ Takimet e JMC-së në periudhën e raportimit, thirrje për propozime të mbyllura/në proces/të planifikuara dhe projekte strategjike (nëse ka). Përmbledhja duhet të fokusohet në problemet e hasura gjatë zbatimit dhe masat korrigjuese të marra dhe/ose të planifikuara, si dhe rekomandimet për veprime të mëtejshme. Raportet vjetore të zbatimit për CBC-në (siç përmendet në nenin 80 të Marrëveshjes Kuadër të Partneritetit Financiar) duhet të përfshihen si aneks.

Në rastin e **IMBC-së**, informacioni i mëposhtëm duhet të përfshihet gjithashtu nga Shteti kryesor:

1. Vlerësim i shkurtër mbi funksionimin e strukturave zbatuese dhe çdo problem domethënës që haset në zbatimin e detyrave të besuara p.sh. vonesat në kontraktim dhe masat vijuese të marra/planifikuara.

2. Rekomandime për masa të mëtejshme

Tabela 1. Vështrim i përgjithshëm i zbatimit në nivel mase

[Marrëveshje Financimi] *p.sh. plani një-vjeçar i veprimit 20xx*	
[Titulli i projektit dhe referenca] *p.sh. Elektrifikimi i linjës hekurudhore nga xxx ne kufirin me xxx*	
Statusi/Progresi për projektin e veçantë (p.sh Termat e Referencës që janë duke u përgatitur, tenderi i shpallur, i kontraktuar, në zbatim, i përfunduar)	*Jepni një vlerësim të zbatimit të aktiviteteve në kuadër të projektit,* *p.sh. u nënshkrua dhe është duke u zbatuar kontrata e shërbimit për përgatitjen e Termave të Referencës për kontratën e punimeve, tenderi për kontratën e punimeve do të hapet në tremujorin e dytë të vitit 2015 etj.* *<u>Për IMBC-në</u>: Bëni një krahasim me parashikimin e paraqitur me Kërkesën për Fonde dhe një analizë mbi ritmin e zbatimit. Kryeni një vlerësim të zbatimit të planit të prokurimit në krahasim me versionin fillestar*
Arritjet kryesore dhe vlerësimi i tyre	*Përshkruani përfitimet e ndihmës IPA dhe kontributit për reforma,* *p.sh. u miratua një ligj i ri për [xx], i cili u ofron qytetarëve akses me të shpejtë në shërbimet publike*
Probleme të theksuara të hasura dhe masat e marra/planifikuara për kapërcimin e tyre	*Përshkruani çdo problem të mundshëm për të përmbushur kushtet e Marrëveshjes së Financimit dhe masat korrigjuese për t'i adresuar,* *p.sh. Kontrata e shërbimit për përgatitjen e Termave të Referencës për kontratën e punimeve, u vonua sepse procedura e negociuar deshtoi dhe duhet të rihapej.* *<u>Për IMBC-në</u>: Kryeni një vlerësim të plotë të arsyeve të vonesave së bashku me një analizë nëse problemet janë të përsëritura (krahasuar me veprimet dhe masat e tjera të marra për të kapërcyer një situatë të ngjashme). Përshkruani gjetjet e audimit dhe/ose parregullsitë e identifikuara dhe masat e marra për adresimin e tyre.*
Zhvillimet dhe/ose rreziqet e identifikuara që ndikojnë në zbatimin e ardhshëm dhe arritjen e objektivave	*P.sh ndryshimi i një ligji për ta përafruar me paketën e katërt për Hekurudhat*
Rekomandime për masa të mëtejshme korrigjuese	

Shtoni sa tabela të jetë e nevojshme:

[Marrëveshje Financimi]	
[Titulli i projektit dhe referenca]	
Statusi/Progresi për projektin e veçantë (p.sh Termat e Referencës që po përgatiten, tenderi i	

shpallur, i kontraktuar, në zbatim, i përfunduar)	
Arritjet kryesore dhe vlerësimi i tyre	
Probleme të theksuara të hasura në realizimin e detyrave të besuara dhe masat e marra/planifikuara për kapërcimin e tyre	
Zhvillimet dhe/ose rreziqet e identifikuara që ndikojnë në zbatimin e ardhshëm dhe arritjen e objektivave	
Rekomandime për masa të mëtejshme korrigjuese	

Aneksi 1: Rezultati/treguesit e produktit për veprim IPA

Ky Aneks duhet të përfshijë një përditësim vjetor të treguesve të përfshirë në dokumentet përmbledhëse të veprimit IPA II dhe dokumentet e veprimit IPA III, duke mbuluar veprimet si në menaxhimin direkt, edhe në atë indirekt. Aneksi preferohet të përgatitet në Excel ose në një sistem të mbledhjes së të dhënave online të përdorur nga përfituesi i IPA III, me tabela të veçanta për veprimet IPA II dhe veprimet IPA III sipas modelit të mëposhtëm. Duhet theksuar se objektivat kërkohen vetëm për treguesit IPA II.

Treguesit IPA II

Program veprimi një vjeçar/shumëvjeçar	Projekti	Sektori	Treguesi	Burimi	Baza e referimit	Objektivi (20xx)	Synimi	Vlera aktuale (20xx)
Programi një vjeçar i veprimit 20xx	*Projekti 1:*	*Transporti*	*Shkurtimi i kohës mesatare të udhëtimit për pasagjerët ndërmjet qendrave kryesore urbane me anë të mjeteve të transportit*					
Programi shumëvjeçar i veprimit 20xx-20xx	*Projekti 1:*	*Mjedisi*	*Ulja e kostos së transportit për njësi të produktit*					
[Shtoni sa rreshta të jetë e nevojshme……]	……	……	……					

Treguesit IPA III

Plan Veprimi një vjeçar/shumëvjeçar	Dritare	Prioriteti tematik	Treguesi	Burimi	Baza e referimit	Synimi	Vlera aktuale (20xx)
Plani një vjeçar i veprimit 20xx							
[Shtoni sa rreshta të jetë e nevojshme……]	….	….					

Aneksi 2: Transparenca, vizibiliteti, aktivitetet e informimit dhe komunikimit

Ky Aneks (maksimumi një faqe) duhet të jepet vetëm për veprimet e menaxhuara në menaxhim indirekt, në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga Marrëveshja Kuadër IPA II dhe Marrëveshja Kuadër e Partneritetit Financiar IPA III.

Aneksi 3: Histori suksesi

Ky Aneks duhet të jepet vetëm për veprimet e menaxhuara në menaxhimin indirekt. (Vini re, kjo pjesë mund të përdoret për raportin vjetor mbi zbatimin e instrumenteve të veprimit të jashtëm të Bashkimit Europian të përgatitur nga Komisioni Europian)

Aneksi 4: Plani vjetor i prokurimit

Ky aneks duhet te jepet vetëm për veprimet e menaxhuara ne menaxhimin indirekt .

[illegible]

Aneksi IV(a): Raporti financiar - [illegible]
sipas nenit 61(2)(b) të FFPA
sipas nenit 61(2)[illegible] të FFPA

Raporti Financiar i përfituesit të IPA III (*)

Referenca e Programit	Numri referencë OPSYS i Marrëveshjes së Financimit	Buxheti i programit	Shuma totale e kontraktuar	% kontraktuar	Shuma totale e çliruar në mbyllje	% liruar	Shuma totale e disbursuar	% disbursuar	Kosto të pranuara gjithsej	% Kosto	Parafinancimi i hapur total	Parafinancimi i hapur %	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	Gjithsej	Gjithsej [illegible]	[illegible]
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20
AAP 2022	JAD.XXXXXX																		
CBC AA/BB 2021	JAD.XXXXXX																		

(*) [illegible]
(**) [illegible]

Unë, i/e nënshkruari/a ____________, NAO për përfituesin e IPA III ____________, [illegible] 61(5) të FFPA.

Aneksi IV (b): Raporti Financiar Vjetor - Kontributi i BE-së për programin individual
sipas nenit 61(2)(a) të FFPA

Raporti Financiar vjetor i përfituesit të IPA III (*)

Referenca e Programit	Numër reference OPSYS i Marrëveshjes së Financimit	Buxheti i Kontributit të BE-së për Programin	Aktivitetet e Kontratës Lokale									
			Shuma totale e kontraktuar	% kontraktuar	Shuma totale e çliruar në mbyllje	% liruar	Shuma totale e disbursuar	% disbursuar	Kosto të pranuara gjithsej	% Kosto	Parafinancimi i hapur total	Parafinanci mi i hapur %
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
				4/3*100%		6/4*100%		8/4*100%		10/4*100%		12/4*100%
AAP 2022	JAD.XXXXXX											
Projekti 1:	ACT-XXXXX											

(*) 15 shkurt

Unë, i/e nënshkruari/a ____________________________, NAO për përfituesin e IPA III ____________________, deklaroj se raporti/pasqyra financiare e mësipërme është e plotë, e saktë dhe e vërtetë në përputhje me nenin 61(5) të FFPA.

Aneksi IV(c): raport vjetor përfundimtar i kontabilitetit
sipas nenit 61(1) të FFPA

Raporti vjetor përfundimtar i kontabilitetit i përfituesit IPA III (*)

Vendimi BE-se	Kontrata BE	Titulli	Referenca e Kontratës Lokale	Formulari i Kontraktorit Subjekt Juridik (LEF)	Lloji i kontratës	Data e nënshkrimit të kontratës	Data e fillimit të zbatimit të kontratës	Data e mbarimit të zbatimit të kontratës	Statusi i kontratës	IPA BE - vlera fillestare e kontratës	IPA BE - vlera aktuale e kontratës	IPA BE - Shuma e paguar	RAL	IPA BE - Rikuperimet	IPA BE - Para-financimi i paguar	IPA BE - Para-financimi i likuiduar	IPA BE - Para-financimi i hapur	IPA BE - Kostot e pranuara	IPA BE - Kostot e kryera (ende të pranuara të papaguara)	IPA BE - Kostot në qarkullim - Shuma e faturës (përpara vlerësimit të shumës së pranueshme)
1	2	3	4	5	6	7	8	1	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	19 bis	20

(*) për t'u dorëzuar deri në 15 janar

Unë, i/e nënshkruari/a ________________________ NAO për përfituesin e IPA III ________________ deklaroj se raporti/pasqyra financiare e mësipërme është e plotë, e saktë dhe e vërtetë në përputhje me nenin 6' (5) të FFPA.

* Ky model duhet të përdoret edhe për programin IPA I dhe IPA I

Aneksi IV (d) - plani i parashikimit të disbur.
sipas nenit 4(2) të FA GC

Të dhëna që nga: ____

Plani i parashikimit të disbursimit për përfituesin IPA III

Referenca e Programit	Numër reference OPSYS i Marrëveshjes së Financimit	Plani i parashikimit të disbursimit (shtoni vitet sipas nevojës)																	
		Parashikimi mujor i disbursimit (për RfF: 12 muaj për kërkesën e parë për para-financim/ 14 muaj për para-financimin pasues; për raportin vjetor financiar dhe parashikimin e kërkesave të mundshme për pagesë: 24 muaj)																	
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Gjithsej për 12 muaj	13	14	Gjithsej për 14 muaj*	15-24	Gjithsej për 24 muaj**
AAP 2021	JAD.XXXXXX																		
CBC AA/BB (alokimi 2024)																			
MAAP Mjedisi																			

* Shtyllat O deri në Q të përdoren për para-financimin pasues
** Shtyllat O deri në S të përdoren për raportin vjetor financiar dhe parashikimin e kërkesave të mundshme për pagesë

Aneksi IV(e) - parashikimi i kërkesave të mundshme për pagesë
sipas nenit 33(3) të FFPA

Të dhëna që nga: ________________

Parashikimi i kërkesave të mundshme për pagesë i përfituesit IPA III

Numër reference OPSYS ose i ngjashëm i Marrëveshjes së Financimit	Referenca e Programit	Hyrja në fuqi e MF	Afati i kontraktimit	Afati i zbatimit operacional	Alokimi i buxhetit lokal në EUR*	Fondet e BE-së paguar nga KE në EUR	RAL në 31/12/21 në EUR	RfFs në BE në EUR	Parashikimi total	parashikimi 202X (sipas muajve)													parashikimi 202Y				
									202X-202Y	Total 202X	01-202X	02-202X	03-202X	04-202X	05-202X	06-202X	07-202X	08-202X	09-202X	10-202X	11-202X	12-202X	Total 202Y	Trm1/ 202Y	Trm2/ 202Y	Trm3/ 202Y	Trm4/ 202Y
1	2	3	4	5	6	7	8=6-7																				
	NP 2012																										
Totali i Programeve IPA I																											
	2015 AAP - Obj 1/Obj2: (IMBC)																										
	CBC 2016 AA-BB																										
	MAAP Mjedisi																										
Totali i Programeve IPA II																											
	2021 AAP (IMBC)																										
Totali i Programeve IPA III																											
Totali i Programeve IPA I, IPA II & IPA III																											

* LBA i korrespondon kontributit total të BE-së për IMBC deri në afatin e kontraktimit; pas këtij afati i korrespondon totalit të kontraktuar.

\

Të dhëna kryesore
Për çdo kontratë lokale kërkohet informacioni:

1. Vendim i BE-së
Referenca e Programit, psh Program Veprimi Vjetor 2022
2. Kontratë BE
Numër reference OPSYS i Marrëveshjes së Financimit, psh 2014/031-878
3. Titulli
Titulli e Kontratës Lokale
4. Referenca e Kontratës Lokale
5. Formulari i Kontraktorit/Subjektit Juridik (LEF)
6. Lloji i kontratës
p.sh grant, shërbim, furnizim, punime, bashkëpunim...
7. Data e nënshkrimit të kontratës
Data e nënshkrimit të kontratës nga pala e fundit
8. Data e fillimit të zbatimit të kontratës
Data e nënshkrimit për kontraktorin, data e nënshkrimit për autoritetin kontraktues, data në të cilën kontrata hyn në fuqi dhe data në të cilën fillon zbatimi i kontratës janë koncepte të ndryshme, të cilat mund të jenë të gjitha në të njëjtën ditë ose mund të jenë ditë të ndryshme.
Në veçanti, data e fillimit të zbatimit të kontratës (= dita e parë në të cilën mund të krijohen kostot e pranueshme sipas kontratës) mund të përcaktohet pasi kontrata të jetë nënshkruar përmes një klauzole përkatëse në kontratë, një urdhri administrativ, etj. Sistemi juaj mund të mbajë të gjitha këto data; por për qëllimet e raportit përfundimtar të fundvitit data kritike është data e fillimit të zbatimit.
9 Data e mbarimit të zbatimit të kontratës
Rregulluar për ndryshime aty ku është e nevojshme. Kjo zakonisht nuk është e njëjtë me datën e fundit të përfundimit, ku kjo përfshin kohën për faturimin, periudhat e garancisë, etj.
Data e përfundimit të zbatimit të kontratës është dita e fundit në të cilën mund të kryhen kostot e pranueshme sipas kontratës. Kontrata mund të lejojë kohë shtesë për finalizimin e administrimit të kontratës ose një periudhë ndërmjet pranimit të përkohshëm dhe përfundimtar të punës së kryer, por kjo kohë shtesë nuk është e rëndësishme për raportin përfundimtar të fundvitit.
10. Statusi i kontratës
HAPUR, MBYLLUR, NDËRPRERË, PA FILLUAR (nëse data e fillimit të aktiviteteve është pas datës së përfundimit)
11. IPA BE - vlera fillestare e kontratës
Shuma fillestare ligjore e angazhimit të pjesës IPA (financimi i BE-së)
12. IPA BE - vlera aktuale e kontratës
Shumat pas ndryshimeve (sipas rastit)
Vlera aktuale e kontratës do të përfshijë çdo ndryshim të shumave të kontraktuara përmes një shtese që ndryshon kontratën.
13. IPA BE - Shuma e paguar
Shuma totale e paguar sipas kontratës; d.m.th pagesat e parafinancimit + shuma e faturave të paguara drejtpërdrejt – rikuperimet).
14. RAL
"Reste à likuidues" është "angazhimi i mbetur për t'u likuiduar"
Shuma e angazhuar, por e papaguar ende për përfituesit dhe kontraktorët nga shuma e BE-së në IPA.
15. IPA BE - Rikuperimet
Vlera totale e rikuperimeve (si rikuperimet e parafinancimit dhe rikuperimet e shpenzimeve) të bëra sipas kontratës (aty ku është e nevojshme).
Rikuperimet zakonisht do të jenë të parafinancimit. Rikuperimet e parafinancimit janë thjesht transferta në para, të cilat nuk kanë ndikim në koston totale. Herë pas here, rikuperimet do të jenë kundrejt pagesave për shpenzime, të cilat fillimisht janë pranuar si të pranueshme, por më pas janë refuzuar në bazë të informacionit të ri. Rikuperimet e shpenzimeve do të zvogëlojnë koston totale të raportuar për kontratën (ju lutemi shihni pikën 19.).
16. IPA BE - Para-financimi i paguar
Vlera totale e parafinancimit të paguar sipas kontratës (aty ku është e nevojshme).
Para-financimi është një pagesë që synon t'i sigurojë përfituesit një parapagim, d.m.th. një paradhënie në para. Si i tillë, ai paguhet përpara dorëzimit të mallrave dhe shërbimeve (në rastin e kontratave të prokurimit) dhe përpara krijimit të kostove të pranueshme nga përfituesit (në rastin e kontratave të grantit). Para-financimi njihet në bilanc kur paratë i transferohen marrësit.
17. IPA BE - Para-financimi i likuiduar
Vlera totale e parafinancimit është likuiduar.
Pagesa e parafinancimit njihet si aktiv. Në përputhje me rregullin përkatës të kontabilitetit, aktivi i para-financimit në përgjithësi çregjistrohet (d.m.th. likuidohet/zbritet) si më poshtë:
• nëse shuma e një faturë të përkohshme/përfundimtare ose pretendimi për kosto, ose një pjesë e saj, justifikon përdorimin e një para-financimi, atëherë vlefësimi i këtyre shpenzimeve të pranueshme do të gjenerojë një likuidim të para-financimit;
• nëse përfituesi nuk përdor (një pjesë të) para-financimit, atëherë shuma e para-financimit do të rikuperohet pjesërisht ose tërësisht nga përfituesi.

18. IPA BE - Para-financimi i hapur
Totalet e 16 dhe 17 do të japin para-financimin total të hapur (të palikuiduar) të paguar sipas programit, d.m.th. parafinancimi i paguar - parafinancimin i likuiduar
19. IPA BE - Kostot e pranuara
Kostot totale të pranueshme të bëra, të pranuara, të paguara (pagesa direkte e kostove plus likuidimi i parafinancimit sipas kontratës) dhe të vërtetuara me dokumente mbështetëse.
Ajo llogaritet me formulën e mëposhtme: 19 = 12 (IPA BE-Vlera aktuale e kontratës) – 14 (RAL) – 18 (IPA BE-Para-financimi i hapur) – 15 (IPA BE – Rikuperimet) Ju lutemi përfshini në llogaritjen e 'IPA BE - Kostot e pranuara' vetëm rikuperimet e shpenzimeve që zbresin koston e pranuar (+19 bis (IPA BE – kosto e krijuar dhe e pranuar ende e papaguar) – VETËM nëse nuk jeni në gjendje të krijoni një shtyllë të veçantë 19 bis në raport)
Kostot do të përfaqësojnë vlerën e pranueshme të punës që:
Ø janë kryer sipas kontratës, janë pranuar, paguar nga autoriteti kontraktues (drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet parafinancimit të likuiduar) dhe janë provuar me dokumente mbështetëse,
Ø janë kryer dhe paguar nga kontraktori (aty ku është e nevojshme - nënkontraktorëve ose nga përfituesit e granteve, për shembull) dhe janë pranuar dhe paguar nga autoriteti kontraktues; Në rastin e kostove të përkohshme, pranimi përfundimtar kuptohet se varet nga rezultati përfundimtar i kontratës.
Vini re se:
** Kostot e akumuluara (vlera e parashikuar e punës së kryer, por ende të pafaturuar) nuk kërkohen.*
** Shumat e angazhuara por të papaguara nuk janë kosto për qëllimin e këtij raporti.*
** Parafinancimi i paguar ose nga autoriteti kontraktues ose nga kontraktori (ku është e nevojshme) nuk është kosto.*
19 bis. IPA BE - Kostot e kryera dhe të pranuara të papaguara
Shembuj janë:
• faturat në qarkullim që janë vërtetuar të sakta (të kryera dhe të pranuara) por që do të paguhen vetëm në periudhën e ardhshme raportuese ose
• shumat e mbajtur për garanci.
Ju lutemi vini re: Nëse ju - p.sh. për arsye teknike – nuk mund ta zbatoni këtë shtyllë në raportin tuaj, ju lutemi shtoni shumat përkatëse në mënyrë të jashtëzakonshme direkt në kolonën 19 duke njoftuar arsyen e përfshirjes së tyre psh: "Shtylla 19 përfshin koston e kryer, të pranuar por të papaguar ende, në shumën "(...)", për arsyen e mëposhtme:"(...)" ose na informoni me një shkresë shoqëruese për shumat përkatëse për kontratë.
Ju lutemi vini re më tej se shumat e hedhura në këtë shtyllë konsiderohen si kosto të kryera dhe pranohen vetëm për qëllimin e këtij raporti përfundimtar në fund të vitit, por jo për qëllimin e Raportit Vjetor Financiar ose të Kërkesës për Fonde ku duhet të konsiderohen vetëm kostot e pranuara (të kryera, të pranuara, të paguara dhe të vërtetuara me dokumente mbështetëse).
Kur kostot raportohen me faturë (zakonisht prokurime)
20. Kostot në qarkullim - Shuma e faturës (përpara vlerësimit të shumës së pranueshme)
Faturat dhe raportet e marra por akoma të pa miratuara.
Kur nuk ka faturë dhe kostot identifikohen nga një raport financiar (zakonisht grante)
20. Kostot në qarkullim - Shuma e raportit financiar (përpara vlerësimit të shumës së pranueshme)
Raportet e mara por akoma të pa miratuara.

Aneksi V i Marrëveshjes së Financimit
Specifikimet Minimale të Sistemit të Kontabilitetit me Bazë Rritëse

Sistemi i kontabilitetit i përfituesit IPA III duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

1. Të pasqyrojë strukturën organizative të vënë në funksionim për sistemet e kontrollit të brendshëm të përshtatur për kryerjen e detyrave. Në veçanti, para autorizimit të një veprimi, të gjitha aspektet (si ato operacionale dhe financiare) e veprimit duhet të verifikohen nga anëtarë të stafit dhe jo nga personi që ka filluar veprimin. Personi që merret me verifikimin nuk mund të jetë nën varësinë e iniciuesit të transaksionit.

2. Të përfshijë gjurmën e auditit për të gjitha transaksionet dhe ndryshimet.

3. Të ketë sigurinë e duhur fizike dhe elektronike, duke përfshirë sistemet mbështetëse dhe ato të rikuperimit.

4. Sistemi i kontabilitetit duhet të mbajë të paktën informacionin e mëposhtëm për kontratat lokale të menaxhuara sipas secilit program:

a) Referencën e kontratës;

b) Vlerën e kontratës, duke përfshirë çdo ndryshim;

c) Datat e nënshkrimit të kontratës (nga të dyja palët);

d) Data për fillimin e zbatimit të kontratës;

Kjo datë jepet përveç datës së nënshkrimit të kontratës dhe mund të ndryshojë prej saj, si në rastin kur data për fillimin e punimeve të kontratës jepet pas nënshkrimit të kontratës me anë të një Urdhri Administrativ.

e) Data për përfundimin e zbatimit të kontratës, duke përfshirë çdo ndryshim;

Kjo është data e fundit në të cilën mund të krijohen kosto të pranueshme. Kjo datë nuk përfshin asnjë periudhë garancie apo kohën e lejuar për përgatitjen e raportit nga kontraktuesi.

f) Totali i paguar (para të gatshme/cash) sipas kontratës;

g) Parafinancimi i paguar sipas kontratës;

Njohja shprehimisht dhe regjistrimi në pasqyrën financiare, i parafinancimit të kërkuar me kontratë.

h) Kostot e pranuara – direkte (sipas kontratës);

Njohja shprehimisht e kostos si pagesë e shpenzimeve të vitit. Disa pagesa do të mbulojnë drejtpërdrejt shpenzimet që janë kryer. Nuk përfshihet parafinancimi. Pagesat mund të jenë përfundimtare kur parafinancimi të jetë liruar ose mund të jenë pagesa të përkohshme kur parafinancimi të jetë liruar ose kur kontrata nuk përfshin dispozitën e parafinancimit.

i) Kostot e pranuara – indirekte (sipas kontratës);

Njohja shprehimisht e kostos si pagesë e shpenzimeve të vitit. Disa fatura apo pretendime për kosto të paraqitura nga kontraktuesi apo përfituesi i grantit do të kenë lidhje me kostot që janë mbuluar nga parafinancimi i paguar më parë gjatë periudhës së zbatimit të kontratës apo marrëveshjes së grantit. Në këto raste, pagesa e kryer do të jetë më e ulët sesa kostoja e raportuar. Ajo mund të jetë edhe zero, nëse e gjithë kostoja mbulohet nga parafinancimi (me siguri ajo do të jetë zero, nëse kostot e raportuara janë të pamjaftueshme për të thithur parafinancimin dhe për bilancin e pashfrytëzuar të parafinancimit nxirret një urdhër rikuperimi). Në të gjitha këto raste, sistemi duhet të regjistrojë vlerën e plotë të kostos së pranueshme të raportuar si shpenzime për vitin dhe të reduktojë bilancin e parafinancimit nga shuma e kostos së kompensuar kundrejt parafinancimit, kur përcakton shumën që do të paguhet.

j) Urdhra rikuperimi për të reduktuar parafinancimin (sipas kontratës);

Pranimi i reduktimit të parafinancimit në pasqyrën financiare pas rikuperimit të parafinancimit të pashfrytëzuar.

k) Urdhra rikuperimi për të zbritur koston (sipas kontratës);

Kur rikuperimi është bërë kundrejt kostos që është pranuar më parë – mundësisht pas një hetimi për mashtrim. Në këto raste, kostot e regjistruara për vitin duhet të zbriten nëse kostoja është pranuar në të njëjtin vit si rikuperim pasues; ose të ardhurat duhet të regjistrohen kur kostoja është pranuar në një vit më herët se ai i rikuperimit.

l) Data e faturës së furnizuesit për çdo faturë apo dokument tjetër të shoqëruar me një raport financiar që mundëson kostot e pranuara;

m) Të dhëna në kontekstin e rikuperimit për kostot e papranueshme dhe rikuperimet.

IPA III - APLIKIM PËR PROJEKT MADHOR[1]

1. INFORMACION PËRMBLEDHËS

1.1. Tabela Përmbledhëse e Programit

Titulli i projektit	[titull]
Programi Operacional Shumë-vjeçar	Program Operacional Shumë-vjeçar për [sektorin (sektorët). p.sh., mjedisi] në favor të [vendi përfitues] për [vitet]
	Miratuar me vendimin e Komisionit [# dhe data]
	Ref: OPSYS/PINTV: [# Në rast se projektet madhore do të ekzistojnë si subjekte më vete në]

[1] Si të plotësohet formulari i aplikimit:
Udhëzimi me ngjyrë të verdhë - ndiqni udhëzimin, hidhni informacionin e kërkuar ose trajtoni temën, më pas fshini udhëzimin me të verdhë brenda kllapave
Udhëzimi me gri - zgjidhni opsionin përkatës dhe fshini ato që nuk kanë lidhje

	Ref JAD: [#] Ref ACT: [#]
Akti bazë/Ref. Programit	Financuar sipas Instrumentit të Ndihmës para Aderimit (IPA III) Kuadri i Programimit IPA III
Plani Ekonomik dhe i Investimeve (PEI)	[Po/Jo]
Programi Kryesor (Pionier) PEI	<Nëse po, specifikoni prioritetin/prioritetet tematik/e[1] dhe pjesën e Fushës Prioritare (FP) (FP) %>[2] [Po/Jo] [Prioritetet: Transporti, Energjia, Mjedisi dhe Përshtatja me Klimën, Zhvillimi Dixhital, Zhvillimi Ekonomik (përfsh. sektorin privat, tregtinë dhe mbështetjen makroekonomike), Zhvillimi Njerëzor (përfsh. kapitalin njerëzor dhe rininë), Përshtatja me Sistemin Shëndetësor, Migracioni dhe Lëvizshmëria, Bujqësia, Siguria Ushqimore dhe Zhvillimi Rural, Sundimi i Ligjit, Qeverisja dhe Reforma e Administratës Publike, Tjetër. Programet Kryesore (Pioniere): "I Lidhja Lindje-Perëndim", II Lidhja Veri-Jug", "III Lidhja rajoneve bregdetare", "IV Energjia e Rinovueshme, "V Tranzicioni i Qymyrit", "VI Vala e Rinovimit", "VII Uji dhe ujërat e zeza "VIII Infrastruktura dixhitale", "IX Mbështetja e konkurrueshmërisë", "X Garancia Rinore"]
Team Europe	Po/Jo
Përfitues (it) e projektit	Projekti do të zbatohet në <Rajoni>, <Shteti>,<vendndodhja(et) nëse ka> Nëse ka, përmendni mbulimi gjeografik të zgjeruar, siç specifikohet në pjesën 1.3 më poshtë.
FUSHAT PRIORITARE:	
Dritare dhe prioritet tematik	Dritare: [#: emri i dritares] Prioriteti tematik: [emri e prioritetit tematik]
Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ)	OZHQ kryesor (vetëm 1): OZHQ (deri në 9) të tjera të rëndësishme dhe, sipas rastit, objektivat:
Kodi (et) DAC[3]	<Kodi kryesor i DAC – sektori- përqindja> <nën-kodi 1 – sektori- përqindja> <nën-kodi 2 – sektori- përqindja> etj
Mënyra kryesore e ofrimit @	<Mënyra 1><Kodi i mënyrës> *Shembull: Banka Botërore- 44001*
Synimet	<Ju lutem specifikoni (nëse ka) objektivin e shpenzimit për të cilin kontribuon ky projekt (të mundshëm) > ☐ Klima ☐ Gjinia ☐ Biodiversiteti

Markuesit[4] (nga formulari DAC)	**Objekti i përgjithshëm i politikave**	**Nuk synohet**	**Objektiv i rëndësishëm**	**Objektivi kryesor**
	Pjesëmarrje në zhvillim/qeverisja e mirë	☐	☐	☐
	Ndihma për mjedisin	☐	☐	☐

[1] Fushat prioritare: 1) Transporti (lidhur me Etiketën e IPA III "Transport i qëndrueshëm), 2) Energjia (lidhur me Etiketën e IPA III "Energjia e pastër"), 3) Mjedisi dhe përshtatja me klimën (lidhur me Etiketën e IPA III "Axhenda e gjelbër"), 4) Zhvillimi Digjital (lidhur me Etiketën e IPA III "Agjenda Digjitale"), 5) Zhvillimi ekonomik (përfsh. sektorin privat, tregtinë dhe mbështetjen makroekonomike) (lidhur me Etiketën e IPA III "Rritja e zhvillimit të sektorit privat" dhe "Integrimi ekonomik rajonal"), 6) Zhvillimi njerëzor (përfsh. kapitalin njerëzor dhe rininë) (lidhur me Etiketën e IPA III "Kapitali njerëzor" dhe "Inovacioni"), 7) Përshtatja me sistemin shëndetësor, 8) Migracioni dhe Lëvizshmëria, 9) Bujqësia, siguria ushqimore dhe zhvillimi rural, 10) Sundimi i ligjit, qeverisja dhe reforma e administratës publike (lidhur me Etiketën e IPA III "Sundimi i ligjit, qeverisja dhe RAP", 11) Tjetër.

[2] Pjesa e fushave prioritare duket të lidhet me nënetiketimet e PEI NEAR: Transporti, Energjia, Mjedisi dhe Përshtatja me Klimën, Zhvillimi Dixhital, Zhvillimi Ekonomik (përfsh. sektorin privat, tregtinë dhe mbështetjen makroekonomike), Zhvillimi Njerëzor (përfsh. kapitalin njerëzor dhe rininë), Përshtatja me Sistemin Shëndetësor, Migracioni dhe Lëvizshmëria, Bujqësia, Siguria Ushqimore dhe Zhvillimi Rural, Sundimi i Ligjit, Qeverisja dhe Reforma e Administratës Publike, Tjetër.

[3] Sektorët (kodet dhe përshkrimet) e Komitetit të Asistencës për Zhvillim (DAC) specifikohen në shtyllën e parë dhe të katërt të qelizës "Kodet dhe qëllimi" në dokumentin më poshtë: DAC and CRS code lists - OECD

[4] Për orientim shihni https://www.oecd.org/development/financing-sustainable-development/development-finance-standards/ Shkoni tek "Data collection and resources for reporters", përzgjidhni Shtojca 2, Anekset 18 (politika) dhe 19 (Rio) e direktivës së raportimit.

